Поимникот на граѓанското општество е збир на толкувања и разбирања на одредени поими на слушателите од шесте генерации на Школата за активно граѓанство на обуките во периодот од 2012 до 2014 година, организирани во рамките на Проектот на УСАИД за граѓанско општество. Ова не се конечни дефиниции за поимите, туку се размислувања на одредени теми и за конкретни поими на слушателите на Школата за активно граѓанство. Поимите наведени во поимникот се дополнети и доформулирани од страна на модераторскиот тим на Школата за активно граѓанство. Поимникот на граѓанското општество ќе се дополнува со секоја следна генерација на Школата за активно граѓанство.

Граѓанин

- Основен елемент на општеството и државата. Тој е носител на суверенитетот. За него е осмислена државата и тој го одредува начинот на управување со неа. Граѓанинот е активен чинител во општествените процеси со тоа што има право на глас и има одговорност за своите одлуки.
- Секоја индивидуа во современото општество што треба да биде корисна за истото.
- Тој е во заемен однос со државата, ги знае своите права и обврски, а истовремено бара од државата да ги почитува истите.
- Послушен граѓанин е оној што во неправична држава е само машина што слуша и се покорува.
- Непослушен граѓанин е оној што знае како да ги заштити своите права, кога доаѓа до нивно непочитување.
- Граѓанин е индивидуа што ѝ припаѓа на одредена заедница, ги исполнува своите должности спрема заедницата, ги формулира законите и дејствува за свое и за општо добро.

Граѓански сектор

- Дел од општеството во кој се организираат, обединуваат и функционираат организации што се основани и работат како непрофитни и невладини, и во кои волонтерството е еден од клучните и најшироко прифатени принципи на вклучување. Пошироко прифатен термин на ова организирање е „граѓанско општество“.
- Синоними на граѓанскиот сектор се „непрофитен сектор“ и „трет сектор“, покрај јавниот и приватниот.

Граѓанско здружување

- Поврзување на граѓаните околу една иницијатива или околу еден проблем. Може да се оствари на ниво на сродни организации или како здружување на индивидуалци.
- Граѓанското здружување, на ниво на организации или како индивидуалци, може да се остварува на долгорочна основа или краткорочно, ад-хок, до остварувањето на иницијативата што ги поврзала интересите на организациите или на поединците.

Граѓанска акција

- Со граѓанска акција, доколку имаме некоја цел и познаваме луѓе со слична идеја, можеме да реализираме одредена акција како би го подобриле нашето живеење.
- Организирана активност на група граѓани за остварување заеднички интереси.
- Со граѓанските акции се подигнува свеста на граѓаните.
- Детектирање некој проблем и изнаоѓање механизми за негово решавање.
- Акции што ги организираат и ги спроведуваат здруженија на граѓани со цел да променат некои практики во општеството.
- Дејствување на граѓаните и давање придонес за некоја промена во општеството.

Говор на омраза

- Говор на омраза е термин што означува говор чија намера е да деградира, вознемири или да предизвика насилство или активности врз основа на предрасуди против лица или групи луѓе врз основа на нивната раса, род, возраст, етничка припадност, националност, религија, сексуална ориентација, родов идентитет, хендикеп, јазична способност, морални или политички ставови, социоекономска класа, занимање или изглед (како висина, тежина и боја на коса), ментален капацитет и која било друга особина.
- Терминот се однесува и на пишана и на усна комуникација, на комуникација остварена преку медиуми, како и некои форми на однесување на јавно место.

Идентитет

- Идентитетот може да се дефинира од аспект на индивидуалците и нивните концепти за личен идентитет и заедницата со одреден систем на вредности што ја одредуваат припадноста на поединците кон таа заедница.
- Одреден збир од лични карактеристики и начини на однесување, според кои една личност се препознава како член на одредена група.
- Јасни и прецизни лични особини на некоја личност со кои се определува неговата посебност.

- Граѓански идентитет како систем од вредности што ги прифаќа еден поединец за да се дефинира себеси како припадник на една општествена, граѓанска, заедница.

Интегритет

- Корпус на вредности што едно човечко битие ги поседува, негува, дополнува и чува.
- Граѓанин без интегритет е како глина.

Човекови права

- Човекот со самото свое раѓање стекнува определени права, но треба да биде добро информиран за нив, како би знаел истите да ги ползува, а и да знае кога ќе му бидат нарушени.

Протест

- Искажување на незадоволство. Може да се изрази на неколку начини.
- Еден од најефикасните начини за да се крене гласот против некоја неправда.
- Протест е искажување незадоволство и желба и волја за промена на некој граѓански акт, некој закон или на некоја состојба во општеството.

Флеш моб

- Флеш моб е ненајавен спонтан настан, во кој учествуваат стотици млади или постари луѓе, со цел да пренесат некоја порака на општеството.
- Организирана, креативна, улична акција, најчесто проследена со музика и танц, која има за цел да анимира и да инспирира поголем број луѓе.

Петиција

- Механизам за остварување некаква цел и почетна фаза во разрешувањето на одреден проблем, а служи и за објаснување на конкретниот проблем.
- Здружени граѓани што имаат за цел нешто да променат.

Бојкот

- Бојкотот се користи за да се изрази протест и за да се изврши притисок кон некоја личност, организација, држава, настан, како би се искажало несогласување и неодобрување.

Добро управување

- Како крајна консеквенца/исход на активното граѓанство
- Транспарентност
- Почитување на законите
- Контрола/надзор на сите инволвирани страни

Добро владеење

- Почитување на Уставот и законите, подзаконските акти и меѓународните договори и работење во согласност и духот на истите.

Социјални медиуми

- Феномен на 21 век, овозможуваат брзо ширење информации, ресурси, поголема флексибилност и мобилизација, што ги прават еден од најбитните фактори за унапредување на активното граѓанство.

Дискриминација

- Секое разликување, исклучување, ограничување или нееднакво постапување или непостапување, кое има за цел или резултира со оневозможување или отежнување на признавањето, уживањето или практикувањето од страна на сите лица врз еднаква основа на сите права и слободи, односно става во понеповолен третман едно лице во однос на друго во слична ситуација.
- Секое правење разлика, искористување или ограничување на луѓето врз основа на нивните колективни идентитети (пол/род, класа, етнос, сексуален идентитет), со што се загрозува или оневозможува остварувањето или заштитата на нивните човекови права и слободи.
- Постојат различни видови дискриминација и најчесто сите се казниви со закон.

Ксенофобија

- Страв од странци, од сè што е туѓо.
- Одбојност што индивидуата ја чувствува кон странец или странци.
- Вообичаено, тоа значи општествено неприфатливо однесување спрема емигранти, сезонски работници, баратели на азил, бегалци и нивните семејства.
- Неподготвеност да се прифати нешто различно.

Предрасуди

- Ставови за луѓе, објекти или појави што немаат логична заснованост, континуирано се одржуваат, проследени се со силни емоции и предизвикуваат одредено постапување или однесување што како последица има понеповолен третман на конкретна категорија во однос на друга.
- Предрасудите се формираат без постоење знаење или претходно испитување на фактите. Тие се потпираат на претпоставки, чувства и верувања.

Сегрегација

- Издвојување.
- Разделување.
- Систем од репресивни мерки и постапки со кои се спречува, промовира или се отежнува мешање на луѓе кои се перцепираат како припадници на различни групи.

Стереотипи

- Стереотипи се релативно упростени и ригидни сфаќања за карактеристиките на припадниците на одделни групи или категории луѓе.
- Стереотипите се исклучувачки и не ја одразуваат реалноста.
- Стереотипите можат да бидат негативни или позитивни, се базираат на многу малку информации и се многу подложни на промени.

Стигма

- Стигма е поим со кој во христијанството се нарекувани Исусовите рани. Подоцна, терминот се користи за да значи обележување, жигосување на лица што се непожелни за една заедница.

Маргинализирана група

- Тоа е група од поединци што ги обединува: специфичната положба во општеството (надвор од центрите на моќта, изложени на социјална ексклузија), кои се објект на предрасуди, кои имаат посебни карактеристики што ги прават погодни за одредени видови насилство.
- Маргинализираните луѓе имаат помала можност за практикување и заштита на сопствените права или се изложени на зголемена можност за натамошна виктимизација.

Поттикнување дискриминација

- Креирање ситуации, акти, дела и настани што предизвикуваат нетрпение и омраза кон одредени лица и групи.

Толеранција

- Почитување на тугите различни ставови, кое не мора да претпоставува и да значи согласување.

Солидарност

- Солидарноста подразбира давање и делење.
- Солидарноста е емпатија (поистоветување).
- Солидарноста е суштествена на заедниците.
- Солидарноста е активизам што треба да резултира со структурни промени.

Слобода

- Постојат многу формулации што ја дефинираат слободата (политички слободи, граѓански слободи, слобода на говор и на изразување, слобода на движење, верски слободи, слобода на избор, право на изразување слободна волја...)
- Единствено кога граѓанинот е слободен, до израз може да дојдат неговата идеја и цел за каква било акција.
- Слободата е можност на граѓаните да дејствуваат во согласност со нивните желби и интереси, права и обврски, сè додека не ги загрозуваат правата на другите.
- Слободата обезбедува слободно дејствување за преземање многу активности што демократскиот систем ги нуди како инструменти.

Неформално образование

- Не сите луѓе имаат пристап до информации и формално образование. Неформалните обуки и средби, кои вклучуваат учење некаква материја, носат многу посилни впечатоци и заклучоци.



Граѓански активизам против проектот "Скопје 2014" и менување на визуелните решенија на постоечките препознатливи објекти од центарот на градот

Aktivimi qytetar kundër projektit "Shkupi 2014" dhe ndryshimit të zgjidhjeve vizuale të objekteve ekzistuese të njohura nga qendra e qytetit


Civil activism against the Project Skopje 2014, and the changes in the architectural solutions of the existing landmark buildings in the city center



Граѓански активизам против
полициска бруталност

Aktivimi qytetar kundër brutalitetit
policor

Civil activism against police brutality



Граѓански активизам против промените во законот за абортус, против неказнувањето на нападите врз ЛГБТИ заедницата и против семејното насилство

Aktivimi qytetar kundër ndryshimit të ligjit për abort, kundër mosndëshkimit të sulmeve ndaj bashkësisë LGBTI dhe kundër dhunës në familje

Civil activism against the changes to the Law on Abortion, against the failure to take action after the attacks on the LGBTI community and against family violence





Граѓански активизам против притисоци врз новинарите (преку притворањето на новинарот Кежаровски), против загадувањето на Тетово и против планираното градење брани на реката Радика

Aktivimi qytetar kundër presioneve ndaj gazetarëve (përmes paraburgimit të gazetarit Kezharovski), kundër ndotjes së Tetovës dhe kundër ndërtimit të planifikuar të pendave në lumin Radika

Civil activism against the pressure on journalists (by detaining journalist Kezharovski), against the pollution in Tetovo and against the planned construction of dams on River Radika

Qëllimi i Shkollës për Qytetari Aktive është që t'i përgatit të rinjtë për të ndërmarrë iniciativa qytetare përmes njohurive dhe shkathtësive të fituara. Tre elementet kyç të trajnimeve të kësaj shkolle janë toleranca, respekti për dallimet dhe mësimi interaktiv. Pjesëmarrësve u është dhënë mundësia të simulojnë bisedime shumëpalëshe, të mësojnë për komunikim të padhunë dhe të praktikojnë komunikimin me mediat. Shkolla nuk propagon dot përdorimin e dhunës dhe nuk përfaqëson asnjë kauzë specifike në mësimdhënie.

HYRJE

Duke filluar nga viti 2012, Shkolla për qytetari aktive për çdo vit stërvit nga 60 të rinj, përfaqësues të sektorit civil, se si të angazhohen në mënyrë thelbësore në shoqëri dhe si t'i aplikojnë përvojat e aktivistëve më të njohur civil në Maqedoni në iniciativat e tyre të ardhshme. Për çdo gjashtë muaj nga tridhjetë qytetarë të rinj, rishtarë, njihen me nocionet themelore të shoqërisë qytetare, me strukturën dhe vendin e sektorit civil në shoqëri, me metodologjinë për planifikimin dhe realizimin e aksioneve qytetare, me dallimet ndërmjet partiakes dhe politikës etj.

Kjo shkollë është e bazuar në përvojat që ka marrë Forumi QHSD gjatë shtatë viteve (2003-2010) të organizimit të Shkollës për politikë, në kuadër të së cilës janë stërvitur rreth 250 përfaqësues të partive politike, organizatave fetare, mediave dhe sektorit civil për fenomene të ndryshme aktuale dhe konstante të diskurseve politike (multikulturalizëm, diplomaci, populizëm, nacionalizëm, marrëdhënie me publikun, rritje konzistente, marketing politik, sociale...). Në njëzet seminare që janë organizuar nga Shkolla për politikë dëgjuesit kanë pasur mundësi që të njihen me shumë ligjërues me përvojë dhe me ekspertë të lartë për çështjet që janë diskutuar në shkollë. Një pjesë e tyre edhe në Shkollën për qytetari aktive i stërvitin përfaqësuesit e rinj të sektorit civil për tema që lidhen me të drejtat e njeriut, organizimin e aksioneve qytetare etj.

Autorët e teksteve/eseve në këtë doracak janë aktivistë të dalluar qytetarë, të njohur jo vetëm si luftëtarë nga "terreni", por edhe si njerëz që e shfrytëzojnë fjalën e shkruar si mjet për presion konstant për më shumë të drejta dhe për kushte më të mira të veprimit të bashkësive në shoqërinë maqedonase.

Najçevska na kujton se cilat janë të drejtat themelore të njeriut dhe cilat të drejta i kemi si individë dhe si anëtarë të shoqatave në raport me shtetin. Ajo shpjegon edhe si duhet të jetë pozicioni proaktiv shtetëror në raport me respektimin e të drejtave të njeriut, ku është vendi i sektorit civil në shtetin demokratik dhe cilat janë mjetet që mund t'i shfrytëzojë qytetaria aktive për të vepruar në shoqëri.

Bojarovski i bën një analizë të detajuar organizimit të aksioneve qytetare dhe si duhet të organizohet strategjia komunikuese, me qëllim që mediat dhe opinioni publik të bëhen për vete për qëllimin për të cilin organizohet një aksion apo një fushatë.

Trajanovski prezanton një përshkrim të detajuar të luftës për të drejta seksuale të aktivistëve në Maqedoni dhe pasqyrën sistematike të luftës për njohjen e të drejtave civile dhe të drejtave të njeriut të një bashkësie në Maqedoni. Që nga fillimet me turp të aktivizmit qytetar të përfaqësuesve të bashkësisë, përmes fitoreve të vogla dhe humbjeve në luftën kundër homofobisë, deri te luftimi i dukshëm dhe i organizuar për të drejtat e veta me protestat e guximshme kundër dhunës, kundër gjuhës së urrejtjes dhe kundër heshtjes së institucioneve që nuk e penguan dhe nuk e dënuan dhunën dhe gjuhën e urrejtjes ndaj personave që janë pjesë e bashkësisë LGBTI.

Vlado Apostollov na e paraqet gjendjen e mjerueshme të gazetarisë maqedonase në dekadën e fundit, edhe pse rasti i tij, si dhe i disa yjeve të ndritshme të gazetarisë hulumtuese janë fije shkrepe të shpresës që e paralajmërojnë ndryshimin për të cilin shpresojmë se vjen dhe në raport me kushtet e veprimit dhe aktivizmit gazetaresk edhe në raport me solidaritetin gjithnjë e më të madh ndërmjet kolegëve, edhe nga ana e shoqërisë, me qëllim që mos të na ndodhë edhe një mbyllje e medias me ndikim, siç ndodhi me Televizionin A1 në vitin 2011.

Përkundër prapambetjes konstante në raport me lirinë e mediave, zbrazjes së gazetarisë nga përmbytjet e saj, marrja propagandistike e hapësirës mediale, presionet, kërcënimet, shantazhet dhe censura, Apostollovi i vëren dhe i paralajmëron fitoret e vogla të cilat henez do të pasojnë.¹

Xhelo Hoxhiq është një ndër aktivistët më të përkushtuar dhe më të sinqertë në shoqërinë maqedonase, i pranishëm në çdo protestë qytetare në vitet e fundit. Ai është edhe alumnist në Shkollën për qytetari aktive, anëtar i gjeneratës së parë të pjesëmarrësve, dhe përvoja e tij e çmueshme në pjesëmarrje në disa iniciativa të mëdha qytetare, sikurse është AMAN dhe lëvizja për drejtësi sociale '8 Shtatori', i jep të drejtë që të shënojë disa prej rekomandimeve të rëndësishme për aktivistët e tashëm dhe të ardhshëm, të cilat edhe në shkollën për qytetari aktive shpesh theksohen:

plotësisht është legjitim bashkëpunimi me parti politike që janë të gatshme ta mbështesin iniciativën tuaj, por gjithsesi me raporte të definuara qartë prej më parë të partneritetit;

kërkoni partner për iniciativat tuaja edhe në partitë politike, edhe në organizatat joqeveritare, edhe në grupet joformale, edhe tek intelektualët dhe artistët e njohur;

krijoni partneritete mbi bazë të barabartë dhe fer.

Krahas këtyre teksteve autoriale, në këtë doracak përfshimë edhe një nocionar, ku kanë zënë vend nocionet kyç për të cilat diskutuan pjesëmarrësit e Shkollës për qytetari aktive dhe formulimi i të cilave u shfrytëzua për t'u dhënë definimi i shpeshtë i gjerë i secilit prej nocioneve të diskutuara. Në sesionet vijuese të Shkollës sigurisht se edhe këto definicione do të plotësohen dhe do të zgjerohen.

Gjithsesi, ky doracak nuk synon që të japë udhëzime dhe zgjidhje instantë për disa çështje të flakta, me të cilat për çdo ditë përballen ata njerëz që kanë zgjedhur të luftojnë për të vërtetën dhe për një jetë më të mirë në rrugë, as që konsiderojmë se me të do të shteren të gjitha temat që janë në fokusin e interesimit të njerëzve aktiv në sektorin qytetar të Republikës së Maqedonisë. Ky Doracak për qytetari aktive para së gjithash është produkt dhe rezultat i aktiviteteve të Shkollës për qytetari aktive, të cilën Forumi-QHSD e realizon në kuadër të Projektit për shoqëri civile të USAID-it.

Gjyner Ismail

Kryetar i Këshillit drejtues të Forum-QHSD

¹ Meqë teksti i Vllado Apostollovit është shkruar në nëntor të vitit 2014, kur Kezharovski ende ishte nën kërcënimin e kthimit në burg, jemi të lumtur që ndërkohë dëshmuam edhe një fitore.



E drejta ndërkombëtare ua garanton njerëzve të drejtën që në mënyrë aktive t'i përfaqësojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut:

- Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, që përfshin dhe të drejtën që mos të shqetësohet për mendimin e vet, si dhe të drejtën që të kërkojë, të pranojë dhe të përhapë informacione dhe ide me çfarëdo mjetesh dhe pa marrë parasysh kufijtë.
- Secili ka të drejtën e tubimit dhe të përbashkimit të qetë.
- Askush nuk mund të detyrohet që t'i takojë ndonjë përbashkësie.
- Secili ka të drejtën që të marrë pjesë në qeverisjen me punët publike në vendin e vet, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve lirish të zgjedhur.

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

- Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e marrjes e të transmetimit të informacioneve ose ideve, pa përzierjen e pushtetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i pengon shtetet që ndërmarrjeve të radios, filmit dhe televizionit t'u imponojë regjimin e lejeve për punë. 2. Realizimi i këtyre lirive, që përfshin obligime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve dhe sanksioneve të caktuara të parapara me ligj, të cilat në një shoqëri demokratike paraqesin masat e domosdoshme për sigurinë shtetërore, për integritetin territorial dhe sigurinë publike, për ruajtjen e rendit dhe pengimin e trazirave dhe krimeve, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, autoritetin ose të drejtat e të tjerëve, për pengimin e përhapjes së informacioneve të besueshme apo për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë së gjyqësisë.
- Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së tubimit dhe të përbashkimit të qetë me të tjerë, përfshi dhe të drejtën që të themelojë sindikata dhe t'u bashkohet sindikatave për mbrojtjen e interesave të veta. 2. Realizimi i këtyre të drejtave mund të kufizohet vetëm me masa ligjore, të cilat në një shoqëri demokratike janë të domosdoshme për sigurinë nacionale, për sigurinë publike, ruajtjen e rendit dhe pengimin e krimeve, mbrojtjen e shëndetit ose moralit apo mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Me këtë nen nuk ndalohet imponimi i kufizimeve ligjore për pjesëtarët e forcave të armatosura, policisë dhe administratës shtetërore.
- Deklarata për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Individëve, Grupeve dhe Organizatave të Shoqërisë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut universalisht të njohura (Adopted by General Assembly resolution 53/144 of 9 December 1998)
- Secili ka të drejtë që vetë ose me të tjerë t'i promovojë dhe të angazhohet për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.
- Secili ka të drejtë të dijë, të kërkojë, të marrë dhe të ketë informacione për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe si realizohen ato në kuadër të legjislacionit, jurisprudencës dhe sistemit administrativ.

- Secili mund të publikojë, të dissemenojë pikëpamje, informacione dhe njohuri për të drejtat e njeriut.
- Secili ka të drejtë të diskutojë, të mësojë legjislativa dhe praktika që lidhen me të drejtat e njeriut dhe ta kthejë vëmendjen e opinionit drejt këtyre çështjeve.
- Secili ka të drejtë të ankohet ndaj politikave dhe aktiviteteve të nëpunësve individual dhe të organeve shtetërore.
- Secili ka të drejtë të marrë pjesë në debate publike, hulumtime, gjyqe dhe të formojë mendimin e vet për përputhjen e tyre me ligjin dhe me dokumentet ndërkombëtare.
- Të japë ndihmë dhe mbështetje profesionale juridike në mbrojtje të të drejtave të njeriut.
- Secili ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete të qeta kundër shkeljes së të drejtave të njeriut.
- Secili ka të drejtë që të jetë i mbrojtur në këto aktivitete.

Njerëzit kanë të drejtë që t'i mbrojnë të drejtat e njeriut (Human Rights Defenders: Protecting the Right to Defend Human Rights). Sipas Deklaratës për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut:

- Secili ka të drejtë që, vetë ose bashkë me të tjerë, t'i përparojë dhe të luftojë për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në nivel nacional dhe ndërkombëtar.
- Me qëllim përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, secili ka të drejtë që, vetë ose bashkë me të tjerë, në nivel nacional ose ndërkombëtar: të mblidhet dhe të përbashkohet qetë, të formojë, të inkuadrohet dhe/ose të marrë pjesë në organizata, shoqëri ose grupe joqeveritare, të komunikojë me organizata joqeveritare ose ndërkombëtare.
- Ka të drejtë të mësojë, të diskutojë, të formojë dhe të ketë mendim për zbatimin ligjor dhe praktik të të gjitha lirive të njeriut dhe ta drejtojë mendimin e opinionit publik drejt këtyre çështjeve.
- Secili ka të drejtë të zhvillojë dhe të debatojë ide dhe parime të reja në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të angazhohet për pranimin e tyre.
- Secili ka të drejtë që, veç tjerash, institucioneve, agjencive dhe organizatave shtetërore të angazhuara me punë publike t'u drejtojë kritika dhe propozime për përmirësimin e funksionimit të tyre dhe të dëftojë për çdo aspekt të tyre që mund ta pengojë ose ta pamundësojë përparimin, mbrojtjen dhe realizimin e drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Shteti do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë mbrojtjen nga çdo diskriminim, çdo presion, hakmarrje ose çfarëdo veprimi tjetër kokë më vete de fakto dhe de jure, bërë individualisht ose bashkë me të tjerë, si reagim ndaj shfrytëzimit legjitim të të drejtave të theksuara në këtë Deklaratë.

1. Çka do të thotë „të drejta dhe liri të njeriut me njohje universale“?

Të drejta dhe liri të njeriut me njohje universale janë ato për të cilat njerëzit janë marrë vesh në nivel ndërkombëtar dhe të cilat i kanë formuluar në dokumente konkrete në nivel të OKB ose/dhe strukturave ndërkombëtare rajonale.

Të drejtat e njeriut paraqiten si sistem parimesh dhe standardesh ndërkombëtare, të pranuar nga më shumë shtete, me kornizë të formuluar (që të mund të përshtaten në sistemet nacionale), të cilat i rregullojnë raportet mes individëve dhe individëve të tjerë dhe individëve me bashkësinë, pas të cilave qëndrojnë mekanizmat mbrojtës të bashkësisë ndërkombëtare dhe sistemet nacionale të mbrojtjes.

Të drejtat e njeriut kanë të bëjnë me:

- dinjitetin e njeriut (çdo krijesë njerëzore e ka dinjitetin e vet thjesht pse është krijesë njerëzore, pa kurrfarë kufizimi ose nevoje për të përmbushur farë standardesh të sjelljes);
- individualitetin (që përfshin mëvetësinë e çdo krijese njerëzore dhe organikën e barabartë në raport me krijesat dhe me bashkësitë tjera njerëzore dhe që i jep të drejtë çdo njeriu të ngrejë kokë kundër institucioneve dhe sistemeve që i rrezikojnë të drejtat e tyre);
- universalitetin (që nënkupton mundësinë e të gjithë njerëzve, kudo që janë, në çdo kohë, t'i praktikojnë të gjitha të drejtat e njeriut);
- lirinë (që paraqet garancinë se njerëzit nuk do të ekspozohen ndaj veprimeve që i dëmtojnë, e cila krijon kushte që njerëzit t'i kryejnë punët që i duan, garanci e së cilës janë të drejtat dhe liritë e njerëzve të tjerë);
- mundësinë e zgjedhjes (kur njerëzit zgjedhin nga më shumë mundësi mbi bazë të informacioneve të mjaftueshme që i kuptojnë, pa presion dhe pa kërcënime në lidhje me zgjedhjen eventualisht të bërë);
- barabarësinë (formale – barabarësinë në ligje dhe para ligjeve, faktike – barabarësi që i merr parasysh dallimet e trashëguara natyrore dhe sociale dhe barabarësinë e shanseve – si mundësi që çdo individ ta arrijë shkallën më të lartë të potencialit të vet);
- diversitetin (e kuptuar si pasuri, e jo si kërcënim).

2. Shteti dhe të drejtat e njeriut

Shteti demokratik bashkëkohor duhet të funksionojë si mjet për kënaqjen e nevojave dhe interesave të njerëzve. Kjo nënkupton se shteti ka detyrë:

- t'i respektojë të drejtat dhe liritë e secilit njeri (të mos i shkel të drejtat dhe liritë e njeriut, të mos i kufizojë pa nevojë, të veprojnë në pajtim me të drejtat dhe liritë e njeriut, ta definojë funksionimin e institucioneve shtetërore, ashtu që nuk do t'i shkel të drejtat dhe liritë);
- t'i mundësoj të drejtat dhe liritë e secilit njeri (duhet të krijojë kushte në të cilat njerëzit do të mund t'i praktikojnë të drejtat dhe liritë themelore të tyre);
- t'i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njerëzve (të krijojë sistem institucionesh dhe praktikash me të cilat do të mundësoj paraqitjen, procesimin dhe sanksionimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut);

T'i promovojë të drejtat dhe liritë e njerëzve (t'i njohë njerëzit me të drejtat dhe liritë e tyre, t'i njohë me mjetet mbrojtëse që kanë në dispozicion dhe t'i nxisë që të qëndrojnë në mbrojtje të drejtave dhe lirive të tyre dhe të njerëzve të tjerë).

Shteti mund të ketë organikë reaktive ose proaktive në raport me respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut:

Reaktive	Kufizime	Proaktive	Përparësi
Shteti reagon ndaj shkeljeve të bëra të të drejtave dhe lirive të njeriut (ndërmerr aktivitete të caktuara, i aktivizon mekanizmat mbrojtës, realizon procedura, shqipton sanksione dhe i realizon ato sanksione)	Barra e procedurës për të dëshmuar shkeljet e të drejtave i takon viktimës (viktima duhet ta njohë shkeljen e të drejtave dhe lirive të veta, të ketë njohuri për mjetet që ka në dispozicion, të ketë mjete për ta udhëhequr procedurën, t'i tubojë të dhënat e nevojshme dhe të marrë guximin për ta filluar procedurën)	Shteti vazhdimisht e rivlerëson sistemin themelor të vlerave (i definoi vlerat e dëshiruara mbi bazë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut) dhe përdor mjete për promovimin e të drejtave dhe lirive (si, për shembull, akcionin afirmativ për t'u ballafaquar me diskriminimin)	Krijohet atmosfera e respektimit të të drejtave, e masivitetit dhe e inkluzionit
Shteti reagon sipas kërkesës së viktimës ose të subjektit të autorizuar, i cili ka të drejtë ligjore që të kërkojë mbrojtje për individ ose grupe	Problem i diskriminimit strukturor dhe institucional (shteti mund të mos vihet në mbrojtje kur vetë paraqitet si shkelës i të drejtave dhe lirive)	Shteti krijon institucione të cilat duhet t'i promovojnë dhe t'i mundësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut	Dominon qasja holistike, që mban llogari për lidhjen e ndërsjellë të të drejtave dhe lirive
Rastet zgjidhen në mënyrë individuale dhe pasojat nga vendimet e marra kanë të bëjnë vetëm me njerëzit e involvuar në rast	Veprim i vogël preventiv (rastet e zgjidhura mund të mos kenë ndikim të mjaftueshëm në situatat e ardhshme të barasvlershme ose të ngjashme)	Shteti i përdor metodat statistike dhe krijon baza me të dhëna, me qëllim që t'i adresojë shkeljet e vazhdueshme dhe sistemore të të drejtave dhe lirive	Shteti vepron në mënyrë preventive dhe i mbron viktimat e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut nga viktimizimi i mëtejshëm

Shteti vepron përmes:

- ligjeve (me të cilat definohen rregullat e sjelljes dhe të procedurave që bazohen mbi standarde më parë të pranuar),
- institucioneve (të cilat e mundësojnë nxjerrjen dhe zbatimin e ligjeve në mënyrë demokratike dhe në kuadër të parimit për sundimin e së drejtës), dhe
- organeve të dhunës (të cilat e pengojnë ose e sanksionojnë shkeljen e ligjeve).



Individët, grupet dhe organizatat kanë të drejtën e promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndërkombëtarisht të pranuar.

Secili ka të drejtë që si individ ose bashkë me të tjerë të marrë pjesë në aktivitete të qeta kundër shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga ana e shtetit në realizimin e këtyre aktiviteteve.

Secili ka të drejtë që ta kritikojë pushtetin dhe të propozojë përmirësimin e funksionimit të organeve të pushtetit dhe ta kthejë vëmendjen kah çdo mangësi, në mbrojtje dhe promovimin e të drejtave të njeriut

a) *Si do ta njohim se shteti i respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut:*

- Çdo aktivitet i institucioneve dhe organeve shtetërore realizohet ashtu që i njeh të drejtat dhe liritë (qëllimi i fundit i veprimit të shtetit është kënaqja e nevojave dhe interesave të caktuara të qytetarëve)
- Shteti/nëpunësit shtetërorë nuk i shkelin të drejtat dhe liritë e qytetarëve (ekzistojnë mënyra qartazi të përcaktuara të veprimit, të cilat e mundësojnë kontrollin mbi punën e organeve të shtetit)
- Ekzistojnë procedura (për participim dhe mbrojtje) që bazohen mbi të drejtat dhe liritë (pjesëmarrja e njerëzve në marrjen e vendimeve të shtetit është ngritur në nivelin më të lartë përmes sistemit të ndërtuar për informim, paraqitjen e qëndrimeve dhe mendimeve dhe kontrollimin e ndikimit të bërë)
- Qëllimi i veprimit të institucioneve dhe organeve shtetërore është orientuar kah më shumë të drejta për një numër më të madh njerëzish (ekzistojnë parametra matës, përmes të cilëve mund të ndiqet rritja e numrit të të drejtave dhe e numrit të njerëzve që mund t'i praktikojnë)

b) *Si do ta njohim se shteti a i mbron të drejtat dhe liritë themelore të njeriut:*

- Ekziston procedura e zhvilluar e ankesës (për të gjithë e njohur dhe e arritshme)
- Ekzistojnë organe efikase dhe të paanshme të ndjekjes (policia, prokuroria publike)
- Ekzistojnë gjykata të pavarura
- Qytetarëve u lehtësohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive (përmes informacioneve, thjeshtësimit dhe çmimit të lirë të procedurave)

c) *Si do ta njohim se shteti a e kontrollon sistemin me qëllim që të respektojë dhe të mbrojë të drejtat?*

- Ka trupa të veçantë të kontrollit (jashtë vetë institucioneve, të njohur dhe aktivë) – për shembull, kontrollin e jashtëm ndaj policisë, komisione barabarësie, ombudsmene e të ngjashme.
- Këta trupa janë të pavarur (në aspektin financiar, funksional, kadrovik dhe strukturor)

- Ka kontroll sistemor, të përditshëm (mbi bazë të listave paraprakisht të përgatitura dhe të masave për rishikim)
- Rezultatet nga kontrolli i komunikohen publikut (ka informacione të përditshme, raporte, reagime dhe pasoja pozitive për njerëzit)
- Rezultatet e kontrollit kanë ndikim kthyes (mbi bazë të raporteve të dorëzuara bëhen ndryshime të dukshme në institucione, në politika)

ç) Si do ta njohim se shteti i sanksionon shkeljet e të drejtave dhe lirive?

- Ekzistojnë dënime të menduara për shkeljen e të drejtave dhe lirive (dënimet janë të barasvlershme me shkeljet e bëra)
- Nuk ka imunitet të nëpunësve dhe funksionarëve shtetërorë (kur zbatohet sistemi i dënimeve, të parët që goditen janë funksionarët dhe nëpunësit shtetërorë, ndërsa të fundit qytetarët)
- Sanksionet zbatohen mbi bazë të ndikimit të tyre preventiv (dënimet janë elementi i fundit në procesin e gjatë të veprimit, krijojnë hapësirë për promovimin e të drejtës restitutive, mbajnë llogari për viktimën dhe çelin derë për veprim më ndryshe)

d) Si do ta njohim se shteti i mundëson të drejtat dhe liritë?


- Ekziston atmosferë demokratike (shteti krijon mekanizma përmes të cilëve qytetarët mund ta shprehin mendimin e tyre dhe të ndikojnë në vendimet që merren, njerëzit nuk frikësohen që ta thonë mendimin e tyre dhe t'i manifestojnë nevojat dhe interesat e veta, njerëzit rregullisht dhe në mënyrë masive marrin pjesë në proceset e vendosjes dhe nevojat dhe interesat e tyre janë pjesë e vendimeve përfundimtare)
- Njerëzit pyesin, komentojnë, kërkojnë informacione në lidhje me të gjitha çështjet e interesit të tyre
- Faktikisht rritet numri i të drejtave dhe shtohet numri i njerëzve që mund t'i praktikojnë të drejtat dhe liritë themelore

dh) Si do ta njohim se shteti i promovon të drejtat dhe liritë?


- I njofton qytetarët me të drejtat e tyre (ekzistojnë mënyra të rregullta për informimin e qytetarëve për të drejtat që i kanë, për zgjidhjet e reja ligjore me të cilat u garantohen dhe u mbrohen të drejtat e tyre dhe për marrëveshjet ndërkombëtare që i ratifikon shteti dhe obligimet që i ndërmerren me këto ratifikime)
- I mëson qytetarët se si t'i praktikojnë, si t'i kërkojnë dhe si t'i mbrojnë të drejtat e tyre (ekzistojnë mënyra të rregullta të informimit për institucionet e ngarkuara që t'i ndihmojnë qytetarët në realizimin e të drejtave të tyre, të mekanizmave mbrojtës që ata kanë në dispozicion dhe për procedurat për mbrojtjen e të drejtave të tyre)
- I mbështet mbrojtësit e të drejtave të njeriut (krijojnë kushte për ekzistimin e përbashkësive formale dhe joformale të njerëzve që e kontrollojnë pushtetin në lidhje me obligimet e tij)

në mundësimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, mundësojnë paraqitjen e ideve të ndryshme për rritjen e mëtejshme të të drejtave dhe forcimin e mbrojtjes së tyre dhe i mbrojnë sidomos në kushte kur qëndrimet e paraqitura janë në kundërshtim me qëndrimet e shumicës dhe vlerat e pranuar tradicionale, pas të cilave qëndron shumica e popullsisë)

Demokracia, shteti dhe të drejtat e njeriut janë në varësi të ndërsjellë:



Në kushte ideale, shoqëria demokratike bashkëkohore strukturohet në atë mënyrë që siguron organikë të caktuar të njeriut/individit:



3. Sektori civil

Sektori civil përbëhet prej grupeve dhe organizatave të tipit formal dhe joformal, të cilat veprojnë pavarësisht nga shteti dhe tregu, me qëllim që t'i promovojnë interesat dhe nevojat e ndryshme të njerëzve (këto interesa dhe nevoja mund të jenë të nduarnduarta dhe nga sfera të ndryshme: politike, ekonomike, të punës, ekologjike, sportive, të artit, mund të jenë të gjëra dhe shumë të ngushta, mund të jenë me interes për grupe të mëdha njerëzish ose për një rreth shumë të ngushtë njerëzish).

Sektori civil nuk është as i mirë, as i keq. Ai mund të jetë me leverdi dhe i dëmshëm, megjithatë është i domosdoshëm që një shtet të jetë demokratik

Hutitë më të shpeshta për sektorin civil
 Sektori civil i fortë – shoqëri e shëndoshë
 Shteti i fortë – sektori civil i dobët
 Sektori civil – sektori progresiv

Ekzistimi i sektorit civil drejtpërdrejt është i lidhur me zhvillimin e botëkuptimit bashkëkohor për demokracinë. Në kushtet e pluralizmit të mendimeve, ideve dhe shprehjeve, participimi i

qytetarëve në proceset e vendimmarrjes bëhet *conditio qua non* (kusht pa të cilin nuk mundet) i shtetit demokratik.

Vënia e konceptit për të drejtat e njeriut mbi bazën e strukturës shoqërore bashkëkohore, nënkupton zgjerimin e madh të rrethit të njerëzve që kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e qeverisjes dhe të vendosjes dhe që kanë të drejtë të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të këtyre proceseve.


Sektori civil si tërësi individësh është në kundërshtim me cilëndo formë të kuadrit kolektiv të ngurtë. Roli i sektorit civil është të sigurojë një pjesë të kanaleve të ndikimit të njerëzve ndaj strukturave të shoqërisë dhe të krijojë kushte për lidhje fleksibile të njerëzve në rrethe me bazë të interesit.

Fleksibiliteti i lidhjes qytetare ka të bëjë si me ndërrimin e sferave të interesit, ashtu dhe me ndërrimin e numrit të njerëzve dhe me ndryshueshmërinë e mënyrave të veprimit. Një njeri mund t'ju takojë strukturave të ndryshme civile, me nivel të ndryshëm angazhimi dhe të bashkëpunojë ose të përndajë interesa me një numër të ndryshëm njerëzish.

Asnjë njeriu nuk mund t'i bëjmë vend në një kuti.



Njerëzit kanë identitete të shumëfishta.



Ajo që ndonjë i takon një grupi të caktuar njerëzish për shkak të disa karakteristikave të veta, ose vetë konsideron se i takon atij grupi, ose, ndërkaq, të tjerët mendojnë se i takon atij grupi, nuk guxon të ndikojë ndaj mundësisë për praktikimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

Dalja ose hyrja nga cilado strukturë e përkatësisë së vërtetë ose të supozuar gjithashtu nuk guxon të ketë kurrfarë pasojash ndaj mundësisë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Njerëzit përfshihen në sektorin civil dhe veprojnë në të mbi bazë të karakteristikave të tyre të vërteta ose të supozuara.

Mundësia për ndikimin e sektorit civil është në proporcion të drejtë me zhvillimin e strukturës shoqërore. Sa më e zhvilluar dhe sa më demokratike të jetë struktura shoqërore, aq më e madhe është mundësia për ndikimin e sektorit civil. Në shtetin e zhvilluar demokratik pushteti dëshiron ta dëgjojë mendimin e qytetarëve, ka nevojë për formulimin e interesave të ndryshme në ndërtimin e politikave, e pranon si të domosdoshme shprehjen e pakënaqësisë me qëllim të reagimit adekuat dhe në kohë. Struktura e zhvilluar shtetërore ka nevojë nga alternativat, idetë dhe drejtimit zhvillimore që mund t'i ofrojë sektori civil, ka nevojë për ndihmë dhe veprim paralel në sfera të caktuara dhe ka nevojë që t'i dëgjojë kritikën dhe dëftimet e pakënaqësisë nga ana e qytetarëve, me qëllim që të veprojë në kohë dhe t'i ndërtojë në mënyrë gjegjëse legjislacionin dhe politikën zhvillimore.

Në mungesë të strukturës shoqërore me definim demokratik:

- sektori civil mund të keqpërdoret dhe të deformohet në funksion të vërtetimit/mbrojtjes së politikave të caktuara, të cilat nuk janë në interes ose, bile, janë në kundërshtim me interesat e qytetarëve;
- sektori civil nuk ka ndaj kujt të ndikojë, përkatësisht e humb vendin që duhet të sigurojë participimin e qytetarëve (për shkak të mungesës së institucioneve adekuate, për shkak se institucionet janë të mbyllura për mendimet e qytetarëve ose, ndërkaq, për shkak të mungesës së procedurave të cilat do ta kishin mundësuar ndikimin e qytetarëve);
- sektori civil mund të jetë plotësisht i marginalizuar (si nga ana e shtetit, i cili nuk krijon kushte për ekzistimin dhe shfrytëzimin e tij, si dhe nga qytetarët, të cilët nuk e shohin të sektori civil mjetin për veprimin e tyre).

Sektori civil nuk mund të ekzistojë pa shtet demokratik.

Shteti e jep kuadrin e domosdoshëm të ekzistimit të sektorit civil (sistemin dhe organizimin). Shteti e krijon ambientin e rregullave të përcaktuara dhe të sundimit të së drejtës, të cilat e mundësojnë veprimin dhe ndikimin e sektorit civil.

Shteti ka rol mbrojtës dhe siguron praktikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut për të gjithë njësoj, e me këtë edhe të shfaqjes së mendimit dhe të promovimit të nevojave dhe të interesave që nuk janë të pranueshme për popullsinë shumicë.

Në mungesë të mekanizmave mbrojtës, sektori civil mund t'u nënshtrohet sulmeve të vazhdueshme, bile edhe dhunës, dhe ta humb funksionalitetin e vet (sidomos kur bëhet fjalë për tema të ndjeshme, të cilat janë në kundërshtim me bindjet e shumicës).

Mungesa e mjeteve për veprim mund ta zhvendosë fokusin e sektorit civil dhe të lë zbrazëtira të mëdha gjatë veprimit (në sferat që nuk janë interes prioritar për garniturën në pushtet).

Mungesa e kornizës ligjore në veprim mund të shkaktojë tejkalimin e kufijve të veprimit të sektorit civil dhe realizimin e aktiviteteve që i shkelin të drejtat dhe liritë e grupeve të caktuara të qytetarëve, përkatësisht t'i shkaktojnë dëm bashkësisë më të gjerë.

Shtetit demokratik i duhet sektori civil.

Sektorit civil siguron mobilizimin e njerëzve rreth nevojave dhe interesave të përbashkëta, gjë që ia lehtëson shtetit që t'i perceptojë të njëjtat dhe t'i marrë parasysh interesat e qytetarëve.

Sektori civil i mbledh mendimet e grupeve dhe individëve të ndryshëm dhe siguron zhvendosjen e sovranitetit të shtetit në dobi të individit.

Sektori civil i vë kufi keqbërjes së mundshme të shtetit dhe e disiplinon pushtetin.

Sektori civil e lehtëson participimin e individëve në proceset e vendosjes me strukturimin e subjekteve të njohura për shtetin, me të cilat mund të negociohet dhe të bëjë kontratë.

Karakteristikat e sektorit civil të domosdoshme për një shtet demokratik

Jo secili sektor civil është adekuat për zhvillimin e shtetit demokratik dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në një shtet demokratik sektori civil duhet të ofrojë alternativa dhe standarde të reja (zgjidhje më ndryshe, me të cilat do të mundësohet kënaqja më e plotë dhe më e mirë e nevojave dhe interesave të qytetarëve). Zgjidhjet e ofruara patjetër të jenë në kuadër të vlerave që dalin nga koncepti për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe realizimi i tyre nuk guxon të mbështetet në mjete që janë në kundërshtim me këto vlera.

Sektori civil në një shtet demokratik duhet të jetë pasqyrë reale e pluralitetit të bashkësisë (pluralitetit të grupeve etnike, religjioze, të interesit, nevojave, mirëkuptimit, mendimit, bindjes filozofike). Dimensionimi i njëanshëm i sektorit civil mund të sjellë qasje të pabalancuar ndaj nevojave dhe interesave të ndryshme të qytetarëve dhe, në fund, të shkaktojë destabilizimin e tërë strukturës së bashkësisë.

Sektori civil duhet të ketë mundësinë e reagimit të shpejtë (përballë ngathtësisë së aparatit shtetëror, i cili ndjek procedura të caktuara dhe i cili nuk mundet që gjithnjë në kohë të reagojë në kushte ose nevoja të ndryshuara të qytetarëve). Që të mund ta realizojë këtë funksion, sektori civil patjetër duhet të jetë i përbërë nga individë të cilët nuk janë të ngarkuar në aspektin burokratik, por dhe të ketë në dispozicion edhe mëvetësinë e tillë financiare e cila do t'i mundësojë të veprojë pa leje paraprake për secilën prej tyre (drejtpërdrejt ose indirekt) nga ana e organeve shtetërore.

Sektori civil në një shtet demokratik është forum i hapur për debat për çështje prej më të ndryshmeve (para së gjithash, për ato që nuk janë të pranueshme ose të dëshirueshme për opinionin më të gjerë dhe për popullsinë shumicë). Për sektorin civil nuk guxon të ketë tema tabu. Nga njëra anë, kjo do të thotë se patjetër duhet të ketë mundësi për debat, bile edhe për ato tema që nuk janë kompatible me konceptin për të drejtat e njeriut (me qëllim zhvillimin e argumenteve, por edhe për njohjen e shtrirjes së gjerë të opinionëve të caktuara). Nga ana tjetër, kjo do të thotë insistim që të hapen dhe të vihen në rend të ditës tema që nuk janë të dëshiruara për shumicën ose për ndonjë grup të veçantë, por që janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Sektori civil duhet të mundësoj artikulumin e problemeve dhe interesave të qytetarëve në atë mënyrë që ato të mund të paraqiten në mënyrë adekuate para shtetit dhe të mundësojë që të dëgjohet zëri i qytetarëve dhe ta forcojë mundësinë e ndikimit të tyre në zgjidhjen përfundimtare.

4. Si vepron sektori civil?

a) I identifikon nevojat dhe interesat e qytetarëve

Përmes kontaktit të drejtpërdrejtë, përmes analizave dhe hulumtimeve, duke mbledhur të dhëna (kuantitative dhe kualitative), me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë ose mbi bazë të përvojës së vet.

b) I motivon qytetarët për aksion

I mbështet ata, krijon kushte për bashkëpunim, i përfaqëson dhe i paraqet qytetarët, i organizon grupet e ndryshme rreth interesave dhe nevojave të tyre të përbashkëta, vë lidhje me organizatat dhe strukturat ndërkombëtare, si dhe me trupat nacionalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

c) Promovon pluralizëm dhe diversitet

Sektori civil siguron praninë e grupeve të ndryshme përmes përbashkimeve të tyre të veta, është fleksibël në pranimin e njerëzve të ndryshëm, të cilët tubohen rreth ndonjë qëllimi të përbashkët, mundëson promovimin e interesave dhe nevojave që lidhen me grupe shumë të vogla njerëzish, siguron prani të balancuar të një diapazoni të gjerë të grupeve të ndryshme në procesin e vendosjes.

ç) Ndikimi ndaj shtetit dhe bartësve të pushtetit

Vë komunikim të vazhdueshëm dhe ad hoc me përfaqësuesit e pushtetit, i prezanton dhe i përfaqëson interesat e qytetarëve para organeve të pushtetit, tregon për zgjidhjet e mundshme, ofron analiza, raporte, informacione, të dhëna të përdorshme për strukturat e pushtetit.

d) Dëfton për gabimet, mungesat, lëshimet dhe shkeljet e ligjeve

Analizon, mbledh, krahason, raporton për praktikimin e të drejtave nga ana e qytetarëve dhe për mënyrën e mbrojtjes së tyre.

dh) Mund të kënaqë nevoja dhe interesa të caktuara dhe të vë struktura paralele ose t'i shtojë ekzistueset, të formuara nga ana e shtetit

Veprimi humanitar, ndihma dhe mbështetja sociale, elementet arsimore, janë aktivitetet konkrete lidhur me kënaqjen e nevojave të qytetarëve.

Sektori civil mund të ndikojë ndaj:

- Ligdhënësit (në çdo nivel të nxjerrjeve të ligjeve, akteve nënligjore, marrjes së vendimeve dhe ndërtimit të politikave)
- Ekzekutivit (në përgatitjen e ligjeve, në realizimin e politikave dhe në zbatimin e ligjeve)
- Detyrimit (si mekanizëm kontrollues)

5. Mjetet e qytetarisë aktive

Sektori civil mund të veprojë përmes dy mjeteve: monitorimit dhe aksionit direkt.

a) Monitorimi

Monitorimi nënkupton mbikëqyrjen e vazhdueshme, të menduar, të organizuar, me target, tubimin e të dhënave dhe raportimin për aktivitete, zgjidhje, situata të caktuara.

Objekt monitorimi mund të jenë: ligjet, dokumentet, materialet zyrtare, mediat, institucionet, organizatat, situatat, aktivitetet.

Të dhënat e fituara nga monitorimi shfrytëzohen për të dorëzuar raporte të veçanta dhe/ose të përmbledhura, komunikata, konferenca për shtyp dhe njoftime për publikun, shtrimin e pyetjeve në organet gjegjëse të pushtetit, iniciimin e procedurave para organeve kompetente drejtuar kah mbrojtja më e madhe e të drejtave dhe/ose ndryshimi i normave ose praktikave, në drejtim të respektimit më të madh të të drejtave të qytetarëve.

Monitorimi është pjesë përbërëse e participimit të qytetarëve në proceset e vendosjes. Me të dhënat dhe informacionet e tubuara monitorimi mundëson përfshirjen kuptimore të qytetarëve në proceset e vendosjes.

Monitorimi paraqet edhe nivelin e parë të kontrollit të shtetit. Në të vërtetë, pushteti që e di se mbikëqyret, se zgjidhjet dhe aktivitetet e tij ndiqen, maten dhe analizohen, zakonisht shumë më tepër i respekton ligjet dhe me shumë ndërgjegje i kryen obligimet e veta. Në këtë mënyrë monitorimi e vë kufirin e parë ndaj keqbërjes së pushtetit.

b) Aksioni

Përmbledhje e veprimeve konkrete që i ndërmarrin qytetarët (vetëm ose bashkë me të tjerë) me qëllim mbrojtjen, praktikimin më të mirë ose promovimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Parakushte për veprim

- Qytetarët patjetër të kenë lirinë aktive (të dinë, të guxojnë, të duan diçka të bëjnë, t'i kenë në dispozicion mjetet e nevojshme që këtë ta bëjnë)
- Të ketë rregulla të lojës të parashikuara më parë – procedura veprimi të caktuara me ligje, të cilat nuk e kufizojnë, por që e mundësojnë veprimin qytetar (kufijtë e realizimit të të drejtave që e pamundësojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, institucionet që mund të ndihmojnë, mekanizmat mbrojtës)
- Të ekzistojë hapësira e definuar e veprimit (fizik dhe simbolik), që nënkupton edhe lirinë nga frika dhe dënimi (sanksione dhe viktimizimi i njerëzve që i ndërmarrin aktivitetet)
- Të jetë i përgatitur për t'i bartur pasojat nga aktivitetet e veta dhe në mënyrë aktive t'i kundërshtojë këto pasoja (vetëdije për reperkursionet e mundshme negative, për reagimet e mundshme të opinionit më të gjerë dhe të pushtetit, dhe njohuri për mekanizmat mbrojtës që mund të përdoren)
- Të ketë sistem nga institucionet demokratike ku do të veprojë/ndaj të cilëve do të veprojë (strukturat e pushtetit funksionojnë ashtu që e mundësojnë ndikimin nga ana e qytetarëve)
- Të ketë mbrojtje nga shteti (sistemi i jurisprudencës është i drejtuar drejt mbrojtjes së njerëzve që e kontrollojnë pushtetin, që shtrojnë pyetje dhe që i kundërshtojnë zgjidhjet e caktuara të pushtetit)

- Mbështetja mediatike (ka media që i bartin informacionet për aktivitetet e sektorit civil, të cilat kanë qëndrime të njëjta/të ngjashme me çështje konkrete që vihen në rend të ditës, që i përkrahin këto aktivitete dhe marrin pjesë në to në kuadër të veprimit të vet)

Përgatitje për aksion

- çka dua (formulimi i saktë i kërkesës është me shumë rëndësi si për atë çka kërkon, si për atë të cilit i drejtohet kërkesa)
- identifikimi i organit, institucionit kompetent (ku të drejtohem – shumë shpesh aktivitetet e sektorit civil rrëzohen për shkak të “trokitjes në derë të gabuar”, përkatësisht shtrimit të kërkesës konkrete para organeve dhe institucioneve që nuk janë kompetente për problematikën e dhënë)
- aleat (prej kujt mund të pres mbështetje – aleatët gjithnjë janë të nevojshëm si për arritjen e masivitetit dhe për t’i dhënë fuqi më të madhe kërkesës, ashtu dhe për të sanuar pasojat eventuale të padëshirueshme që dalin nga aktivitetet)
- kundërshtar (prej kujt mund të pres kundërshtime – i rëndësisë së njëjtë, sikurse të përcaktimi i aleatëve, është edhe përcaktimi i kundërshtarëve të mundshëm, me qëllim të ngritjes së strategjive të veçanta për amortizimin e veprimeve që ata bëjnë dhe për adresimin e argumenteve të tyre)
- Çka më tej (nëse kam sukses, nëse nuk kam sukses –patjetër gjithnjë duhet pasur planin “B” dhe planin “C” në rast mossukses, të ekzistojë plani për zvogëlimin e dëmeve dhe ndihma për viktimat. Patjetër duhet pasur idenë për ditën pastaj, në rast të realizimit të qëllimit. Asnjë qëllim nuk guxon të paraqesë fundin)

Probleme:

1) Sektori civil i pranueshëm dhe i papranueshëm për politikën dhe partitë politike

Aktivizmi qytetar mund të korrespondojë në ndonjë sferë me aktivitetet, strategjitë dhe/ose politikat e strukturës në pushtet. Rëndom kjo ndodh kur bëhet fjalë për një lloj të caktuar grupesh të marginalizuara, për aktivitete humanitare, por dhe për aktivitete të ndryshme të cilat lidhen me ngritjen e vetëdijes për probleme konkrete.

Aktivizmi qytetar mund të jetë i përkundërt me aktivitetet, me strategjitë dhe me politikat e strukturës në pushtet. Në raste të këtilla, është shumë e natyrshme që aleanca të kërkohet te partitë politike opozitare, të cilat mund t’i paraqesin kërkesat e qytetarëve në kuvend (po qe se i kanë përfaqësuesit e tyre në të) ose t’u bëjnë masivitet dhe zë këtyre kërkesave përmes organizimit të anëtarësisë së tyre.

Tema të ndjeshme

2) Në veprimin e sektorit civil mund të paraqiten tema që kërkojnë mënyrë të veçantë veprimi, për shkak se janë në kufijtë e sigurimit të shtetit, për shkak se janë në kundërshtim të plotë me sistemin e vlerave që e promovon struktura në pushtet, për shkak se lëvizin linjës së tolerancës fetare dhe/ose etnike, ose për shkak se janë në kundërshtim (tema tabu) me sistemin e vlerave të shumicës së popullsisë.

Në rastin kur fjala është për tema të ndjeshme, nevojitet njohje më e madhe e problematikës dhe shkathësi më e madhe në gjetjen e strategjive dhe mënyrave që këto tema të vihen në rend të ditës pa shkakuar fare efekt të kundërt. Në këso lloj rastesh ndihmon shumë bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare ose me rrjetet e organizatave joqeveritare dhe shfrytëzimi i ratifikateve ndërkombëtare dhe i standardeve që promovohen me to.

6. Si bëhet aktive qytetaria?

Që të jetë aktiv, qytetari nuk ka nevojë për bashkimi formal (numri i njerëzve që veprojnë dhe njohja formale e grupit nuk përbëjnë elementin thelbësor të qytetarisë aktive). Njerëzit mund të veprojnë si: individ, grup, organizatë joformale, shoqëri, rrjet shoqërisht, sindikatë, parti politike...

Çdo individ bëhet pjesë e qytetarisë aktive me atë që:

- Zgjedh (lirisht dhe mbi bazë të informacioneve të mjaftueshme dhe të kuptueshme, kërkon informacione, i shqyrton të dhënat dhe merr vendim me të kuptuar të asaj që është ofruar)
- Merr pjesë (e tregon mendimin/qëndrimin e vet, i kumton nevojat dhe interesat e veta dhe kërkon kënaqjen e tyre)
- Kontrollon (shpreh kënaqësi ose pakënaqësi nga zgjidhjet që janë marrë, shtron pyetje për zgjidhje dhe aktivitete të caktuara, kërkon raport dhe përgjegjësi nga organet shtetërore)
- Dorëzon padi, ankesa, peticione, parashtresa ... në organet gjegjëse në rastet kur mendon se i ka të shkelura të drejtat dhe liritë, ose të rrezikuara interesat.

Që individi të mund të jetë pjesë e qytetarisë aktive, duhet:

- T'i praktikojë të drejtat dhe liritë (t'i dijë të drejtat e veta dhe të të tjerëve, të veprojë në harmoni me këto të drejta dhe të dijë se kur ato shkelen)
- Ta kuptojë të drejtën si përgjegjësi (për realizimin e të drejtave dhe lirive të veta dhe të të tjerëve)
- Të ngrihet në mbrojtje të të drejtave të veta dhe të të tjerëve (ta regjistrojë/ta njohë shkeljen e saj, ta kundërshtojë shkeljen, të japë mbështetje për të gjitha ato të drejta që janë shkelur)
- Ta individualizojë fajin për shkeljen e të drejtave (të njihen shkelësit direkt dhe të fshehur të të drejtave të njeriut dhe ata të emërohen)
- Të shfrytëzohet gjithçka që ka në dispozicion sistemi (sistemi ofron mjete dhe mënyra të ndryshme të luftës me shkeljet e të drejtave të njeriut – ankesa, peticione, procese gjyqësore, iniciativa, marshe, demonstrata, greva...)

Shteti demokratik ofron më shumë mundësi dhe mjete për qytetarin aktiv:

- Thirrje në procedura (qytetarët patjetër t'i ndërmendin organet shtetërore dhe të kërkojnë prej tyre realizimin me përpikëri të procedurave të caktuara ligjore)
- Prania (qytetarët duhet ta shfrytëzojnë çdo mundësi të dhënë në ligje për të qenë personalisht të pranishëm gjatë marrjes së vendimeve)

- Kërkimi i bisedës (qytetarët duhet ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për kontakt të drejtpërdrejtë me ata që i kanë zgjedhur për t'i përfaqësuar dhe me përgjegjësit për zbatimin e ligjeve)
- Këqyrjen e dokumenteve (qytetarët kanë të drejtë ta shikojnë tërë dokumentacionin që lidhet me nxjerrjen e zgjidhjeve të caktuara ligjore, të vendimeve apo politikave)
- Shumë komunikim me shkrim (mënyra më e mirë e komunikimit është ajo me shkrim, për shkak se në kërkesën me shkrim administrata patjetër të japë përgjigje me shkrim, për shkak se është e mundur që të thirret në komunikimin e mëparshëm, është e mundur që në mënyrë më precize të përcaktohen datat dhe situatat fillestare, ndjekja e ngjarjeve, vendndodhja e përgjegjësisë individuale dhe ngritja e nivelit të mbrojtjes së kërkuar)
- Shfrytëzimi i heshtjes së administratës (heshtja është miratim)
- Procedura dhe konteste administrative (që kushtojnë pak, e që në shumë raste janë urgjente)
- Gjetja e bashkëmendimtarëve ose e viktimave (qytetari duhet t'i identifikojë njerëzit në situata të ngjashme, me nevoja dhe interesa të ngjashme dhe të provojë paraqitjen e përbashkët. Shteti shumë më lehtë i shkel të drejtat dhe liritë e qytetarëve kur ata përpiqen që të drejtën e tyre ta realizojnë në dëm të të drejtës së tjetrit)
- Paraqitje/veprim i organizuar

Më vështirë është t'i mbrosh parimet dhe t'i kundërvihesh mendimit publik

Disa njerëz e ke vështirë, bile është me shumë rrezik, që t'i përfaqësosh. Ka çështje për të cilat nuk flitet, të cilat janë në kundërshtim me traditën dhe kulturën e bashkësisë më të ngushtë apo më të gjerë, të cilët janë pjesë e diskriminimit institucional dhe strukturor. Për llojin e këtillë të çështjeve është i nevojshëm veprimi i përbashkët i më shumë njerëzve dhe i strukturave të ndryshme.

7. Korniza e veprimit të qytetarisë aktive

- Sektori civil është pjesë e rrethimit politik ku zhvillohet dhe ai u nënshtrohet të gjitha problemeve, kufizimeve, deformimeve të atij rrethimi (aktivizimi qytetar as është i përkryer, as është i pagabueshëm, megjithatë është i domosdoshëm).
- Sektori civil nuk mund t'i realizojë qëllimet e veta pa involvimin e subjektit politik (partitë politike janë ato që e marrin pushtetin dhe hyjnë në trupat e zgjedhur legalisht ku marrin vendime. Shteti është ai që e ka mjetin e dhunës. Sektori civil duhet/doemos të gjejë aleat në strukturat politike, të cilat do të rrinë pas ideve që i promovon dhe pas kërkesave që i shtron. Vetëm në këtë mënyrë ato ide dhe kërkesa mund të bëhen pjesë e politikave, e zgjidhjeve ligjore dhe e strategjive zhvillimore).
- Sektori civil duhet të bashkëpunojë me pushtetin (si për çështjet për të cilat nuk ka kundërshtime, ashtu dhe për çështjet që i hapin si alternativa dhe për çështjet të cilat pushteti nuk i ka vënë në listën e prioriteteve të pushtetit të tij, bile dhe ta detyrojë pushtetin që t'i dëgjojë problemet për të cilat nuk do që të dëgjojë).

- Sektori civil duhet të kërkojë mbështetje te partitë politike opozitare (opozita është aleat natyror i sektorit civil për të gjitha çështjet që janë ideologjike, që kanë të bëjnë me vlerat ose në njëfarë mënyre që janë në kundërshtim me politikat e strukturës qeveritare. Opozita dhe partitë politike opozitare që janë në Kuvend mund t'i vënë në rend të ditës këto çështje, mund të kërkojnë që ato të shikohen ose, ndërkaq, ta paraqesin zërin e qytetarëve në trupin ligjdhënës. Opozita mund të ndërtojë sistem vlerash pas të cilit mund të ndalet sektori civil në luftën për ndryshimin e pushtetit dhe ku do të thirret sektori civil gjatë realizimit eventual të këtij ndryshimi).
- Dimensioni ndërkombëtar (sektori civil mund të mbështetet nga qytetarët e shteteve të tjera, mund ta bëjë të shikuashëm problemin edhe jashtë shtetit, të kërkojë ndihmën e strukturave dhe shoqërive ndërkombëtare ose ta vë problemin në një kontekst më të gjerë që ka të bëjë ose që i përfshin interesat dhe nevojat e njerëzve jashtë shtetit nacional).



Çka është qytetaria aktive? Kjo është pyetje së cilës patjetër duhet t'i kundërvihet përgjigjja se qytetari aktiv është diçka krejt tjetër nga pamja e rëndomtë për pjesëmarrjen e tij politike vetëm gjatë kohës së aktiviteteve zgjedhore. Koha është ajo e rëndomta, edhe për politikanët pamje e dëshiruar për qytetarin aktiv, që të fillojë që të ndryshohet.

Është koha që qytetarët ta njohin, e pastaj edhe ta praktikojnë se ata vetë janë “opozitë” permanente e partive politike, të cilat përkohësisht janë në pushtet, për shkak se ai pushtet u është lënë në emrin e qytetarëve dhe se ata mund ta kthejnë sërish në duart e tyre – në çdo katër vjet, ose atëherë kur qytetarët do ta njohin se partia politike që ka marrë mandatin nga qytetarët nuk po e realizon programin e premtuar politik ose, ndërkaq, e realizon me korrupsion apo me parime të papranueshme etike.

Në këtë mënyrë qytetarët demonstrojnë se kanë:

- Vetëdije për qytetari demokratike

Me të cilën gjë tregojnë se pjesëmarrja e përhershme e qytetarëve në jetën politike të një shoqërie, përmes përbashkimeve qytetare ose përmes iniciativave qytetare ad hoc, është në themelet e bashkësive demokratike, participative.

- Vetëdije për monitorim dhe ndikim në politikat publike

Si tregues se qytetarët gjithnjë dhe për çdo vendim politik mund të organizohen për ta monitoruar marrjen e vendimit, ose për të marrë pjesë më drejtpërdrejt në krijimin dhe marrjen e politikave publike në nivel lokal dhe qendror, duke i respektuar ligjet dhe procedurat të cilat duhet të jenë të tilla për ta mundësuar atë.

Këto arritje dhe të drejta të qytetarëve në një shoqëri të hapur demokratike më së miri realizohen kur qytetarët e dinë se kanë dhe se duhet ta përkryejnë përmbledhjen e shkathtësive interdisiplinare që do të ndihmojë në:

- Kontrollin e pushtetit lokal dhe qendror
- Aplikimin e shkathtësive në çështjet dhe politikat reale
- Shfrytëzimin e përvojave komparative
- Vlerësimin e mundësive

“Trajnimi” i vazhdueshëm i aktivizmit qytetar do t'i përkryejë procedurat dhe mundësitë e kontrollit të pushtetit lokal dhe qendror në çështje dhe politika reale me rëndësi të drejtpërdrejtë për qytetarët. Kur qytetarët e praktikojnë aktivizmin, gjithsesi se vijnë në kontakt me praktika, përvoja dhe zgjidhje nga disa aksione të tjera.

Objektivat e qytetarisë aktive

- Përveç arritjes së objektivave të çdo aksioni qytetar veç e veç (Ulja e ndotjes në qytet, Fushata për shtigje për biçikleta, Çmime më të lira të...), synimi i vazhdueshëm i objektivit themelor, i madh, i aktivizimit qytetar është ta zhvillojë përkushtimin e qytetarëve për qytetari aktive si mënyrë e participimit në krijimin dhe vendosjen e politikave publike me:
- Njohuri dhe shkathtësi për praktikimin e qytetarisë aktive
- Sigurimin e përvojave që demonstrojnë kompetencë
- Kontribut në pranimin e rëndësisë për qytetari aktive

Përveç shkathtësive dhe diturive të cilat çdo qytetar i arrin përmes arsimit për ta arritur profesionalitetin në profesionin që ka zgjedhur çdo anëtar i bashkësisë duhet të ketë ndjesinë se pjesëmarrja e tij në bashkësi, në nivel lokal dhe nacional nuk mbaron vetëm me angazhimin e tij profesional. Çdo qytetar ka mundësi pjesëmarrjeje në funksionimin e bashkësisë me iniciativa dhe aksione qytetare. Që të arrihet kjo, është e domosdoshme njohja me mënyrën se si funksionon bashkësia lokale ose nacionale dhe të njihet me të drejtat dhe mundësitë e tij për të marrë pjesë në iniciativa dhe aksione.

Në këtë mënyrë çdo qytetar fiton një shkallë të caktuar përvojë dhe kompetence për të marrë pjesë ose për të udhëhequr si lider në realizimin e iniciativave qytetare dhe duke e bërë atë anëtar kompetent të bashkësisë. Kjo, ndërkaq, kontribuon që pjesëmarrja individuale në aksione të bashkësisë të bëhet shembull për të gjithë të tjerët se qytetarët kanë mundësi që ta japin kontributin e tyre në funksionimin e bashkësisë edhe atëherë kur strukturat e vendosura të pushtetit janë joefikase ose nuk i njohin nevojat aktuale dhe thelbësore të qytetarëve dhe të bashkësisë.

qytetarë hapësira ime të drejta politika arsim pjesëmarrje **demokraci iniciativë** aktivizëm
qytetari participim bashkësi përndarje
shoqëri **solidaritet padëgjueshmëri**

Çka na mëson qytetaria aktive

- Si të monitorohen dhe si të ndikohet në politikat publike
- Se mund të merret pjesë në procesin e krijimit të politikave publike
- Se është e mundur të zhvillohen shkathtësi dhe baza konkrete për të qenë qytetar i përgjegjshëm dhe aktiv
- Zhvillohen shkathtësi komunikuese frytdhënëse dhe kreative
- Nxiti pamje pozitive dhe vetëbesim në praktikimin e të drejtave dhe përgjegjësi

Çka janë politikat publike?

Politikat publike mund të definoohen si pajtim që merr pushteti (lokal ose qendror) në gjetjen e instrumenteve dhe mënyrave për t'i plotësuar obligimet dhe përgjegjësitë e veta në realizimin e politikave për të cilat ka marrë mandat gjatë kohës së zgjedhjeve, si dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe të bashkësisë për zgjidhjen e problemeve që qëndrojnë në rrugën e mirëqenies së përgjithshme.

Politikat publike përfshijnë ligjet, rregullativat, vendimet dhe praktikatat që i krijojnë:

- Pushteti ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor
- Administrata publike
- Agjencitë rregullatore
- Trupat dhe agjencitë tjera publike dhe qeveritare

Qytetari aktive... Politika publike... Çfarë është lidhja midis tyre? Problemet!!! Pikërisht ashtu, problemet janë lidhja midis politikave publike dhe qytetarisë aktive. Kur problemet nuk mund të zgjidhen ose nuk ka vullnet për këtë, me instrumentet institucionale për krijimin dhe daljen me politika publike, atëherë në skenë del – QYTETARIA AKTIVE.

Problemet që dalin para ndonjë interesi publik të bashkësisë nuk duhet të shikohen si pengesa, por si sfida dhe ato duhet të zgjidhen. Në këtë mënyrë gjithnjë bëhet edhe një hap më tepër drejt një bashkësie më të mirë ku jetojnë qytetarë të kënaqur, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, politike, fetare ose çfarëdo tjetër.

Problemet duhet të zgjidhen e jo të “futen nën tepih”. Më së paku zgjidhja e tyre, ose vullneti për t'u zgjidhur duhet të varet nga interesat politike ose partiake.

Synimi për një bashkësi më të mirë asnjëherë nuk mbaron. Kur do të arrihet një qëllim, para bashkësive del sfida e re që duhet të tejkalohet me zgjidhjen e ndonjë problemi. Cilat janë kriteret që e përcaktojnë zgjedhjen e problemit që duhet të zgjidhet? Ja disa pyetje, përgjigjet e të cilave përcaktojnë se a duhet të zgjidhet ndonjë problem dhe si duhet bërë kjo në bashkësi, rreth së cilës tubohet energjia e një numri të caktuar qytetarësh:

1. A është problemi i rëndësishëm për një numër më të madh qytetarësh?
2. A është pushteti (lokal, qendror) përgjegjës për zgjidhjen e atij problemi?
3. A ekzistojnë informacione të mjaftueshme që do të ndihmojnë që të organizohet aksioni i frytshëm qytetar?
4. A ekzistojnë shanse reale për zgjidhjen e problemit?

Hapat themelore për krijimin e aksionit qytetar

Kur do të përcaktohet se disa qytetarë të bashkësisë kanë ndonjë problem dhe kur do të niset të bisedohet për të, në të vërtetë bëhet hapi i parë për një aksion qytetar. Rëndom, përvoja i një hapat në vazhdim gjatë kreacionit të një iniciative qytetare:

1. Identifikimi i problemit të një bashkësie.
2. Propozim-zgjidhje në formën e rekomandimeve për politika publike të zbatueshme.
3. Plan aksional për pranimin dhe implementimin e propozimeve që dalin nga iniciativa qytetare.
4. Realizimi i planit aksional para opinionit publik.

Koncentrimi i pakënaqësisë nga ndonjë situatë në bashkësi, është simptoma e parë që të çon në identifikimin e problemit për të cilin është i domosdoshëm aksioni qytetar. Në këtë fazë bisedat dhe debatet për problemin nuk është e thënë të jenë të organizuara, por gjithsesi kontribuojnë në mprehjen e pamjes për të. Rëndom në këtë fazë krijohen bërthamat organizative dhe lideriste, të cilat formohen në fazën e dytë të debateve brenda bashkësisë, kur tubimi i informacioneve për natyrën e problemit dhe për problemet prej ku ai gjeneron bëhen më të organizuara dhe më të fokusuara.

Njëri prej rekomandimeve në këtë fazë është “sa më tepër burime dhe informacione, aq më tepër opsione për zgjidhje”. Numri i mjaftueshëm i informacioneve do ta ndihmojë prezantimin e argumentuar të problemit.

Në këtë fazë të përgatitjes të një iniciative qytetare rezultatet më të mira dhe më efikase arrihen po qe se ata që tubohen rreth saj organizohen në grupe:

- Grupi 1 – Për prezantim të argumentuar të problemit
- Grupi 2 – Zhvillimi i politikave alternative
- Grupi 3 – Harmonizimi i zgjidhjeve të propozuara me dispozitat kushtetuese dhe ligjore
- Grupi 4 – Punë në planin aksional

Grupi për zhvillimin e politikave alternative i përgatit zgjidhjet e problemit dhe duhet të ofrojë përgjigje komplet të menduara dhe aplikative, të cilat duhet të jenë të harmonizuara me sugjerimet në lidhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, për të cilat kujdeset grupi i qytetarëve që e kontrollon legjislacionin dhe harmonizimin e zgjidhjeve të reja me të.

Grupi i katërt punon në planin aksional të iniciativës qytetare dhe i planifikon aktivitetet në përputhje me fazat për realizimin e iniciativës qytetare nga fillimi deri në realizimin e qëllimit.

Në një moment, iniciativa qytetare duhet të jetë e prezantuar edhe para publikut më të gjerë përmes mjeteve të komunikimit. Nga prezantimi dhe nga promovimi publik i iniciativës qytetare pritet:

- Ballafaqim me kontekstin real me të cilin përballlet iniciativa
- Nisja e debatit publik që mund ta stimulojë iniciativën dhe – e kundërta
- Ndhimmon që të fitohen bashkëmendimtarë aktivë të rinj dhe mbështetje më të madhe publike

Organizimi i një aksioni qytetar

Çdo ndryshimi i paraprin aksioni i cili do të jetë i suksesshëm vetëm po qe se është i organizuar, ndërsa organizimi i mirë nënkupton investim:

- Në zemra ta sigurojë MOTIVIMIN
- Në koka ta sigurojë STRATEGJINË
- Në “duar” dhe “këmbë” ta sigurojë AKSIONIN

Motivimi, strategjia dhe aksioni janë trilingu i suksesit i çdo iniciative qytetare. Motivimi e ushqen iniciativën me energji dhe entuziazëm, strategjia e siguron qasjen racionale të planifikimit dhe realizimit të hapave më parë të përpunuar, ndërsa këto dyja – motivimi dhe strategjia shndërrohen në aksion që çon tek objektivi.

LIDERI DHE LIDERIZMI NË ORGANIZIMIN E NJË AKSIONI QYTETAR

Këto tri shkathtësi - të motivosh, të përgatisësh strategji dhe të strukturosh aksion kolektiv, mund të studiohen dhe të mësohen. Janë këto tri shkathtësi lideriste themelore të domosdoshme për zhvillimin e fushatës dhe për krijimin dhe realizimin e një aksioni qytetar.

Në lidhje me liderizmin në aksionin qytetar, organizimi i mirë nënkupton që të jenë të plotësuar tre faktorë:


1. Liderë që organizojnë dhe zhvillojnë liderë të tjerë që të koordinojnë me ta në ekipe lideriste.
2. Të krijohen raporte, bashkësi dhe përkushtim rreth liderizmit të aksionit.
3. Nxjerrja e fuqisë nga resurset e bashkësisë që të jetë energji e strategjisë me të cilën duhet të realizohen objektivat dhe rezultatet e vëna.

Nga përvoja e aksioneve qytetare në këtë temë – liderë dhe liderizëm, njihen rekomandime të caktuara të cilat relativisht janë instruktive. Nga përvoja, kur është në pyetje roli i liderit dhe liderizmit në planifikimin, organizimin dhe realizimin e një fushate qytetare, veçohen situata kur të gjitha aktivitetet dhe të gjithë aktivistët kyç rreptësisht janë të fokusuar kah një lider. Këto përvoja nuk janë domosdoshmërisht negative, por hapin shumë pyetje në raport me efikasitetin e aksionit për shkak të centralizimit të tejtheksuar dhe komunikimit njëkahësh që, si e para, merr shumë kohë e si e dyta, kërkon nga lideri, i cili është qendra e aksionit, kapacitete dhe përkushtim të jashtëzakonshëm.

- A është lider ai tek i cili shkojnë të gjithë?
- Çka do të thotë të jesh në qendër?
- Çfarë është ndjesia kur je shigjetë që nuk mund të drejtohet drejt cakut?
- Çka do të ndodhë nëse lideri heq dorë?



Lideri në qendër



Mungesë liderizmi

Ndonjëherë shkojmë në skajshmërinë tjetër:

Nuk na duhet lider, sepse të gjithë mund ta bëjmë atë!

Kjo situatë e vë në rrezik koordinimin në iniciativën qytetare, dhe ai, për shkak se ndonjëherë fjala është për procese të komplikuar dhe komplekse, është shumë i rëndësishëm kur bëhet fjalë për arritje të suksesshme të objektivit të aksionit qytetar. Përveç kësaj, në një iniciativë qytetare kështu të organizuar humbet ndjenja e përgjegjësisë.

ÇORGANIZIM	LIDERIZËM	ORGANIZIM
Ndarje	Vënia e lidhjeve dhe raporteve	Përbashkësi
Konfuzion	Interpretim	Mirëkuptim
Pasivitet	Motivim	Pjesëmarrje
Reaktivitet	Strategji	Iniciativë
Pa aksion	Mobilizim	Aksion
Mungesë objektivi	Marrja e përgjegjësisë	Objektivi

Liderët, para së gjithash, janë organizatorë të mirë, ose menaxherë, të cilët janë përgjegjës për t'i arritur objektivat e aksionit qytetar.

Njëra prej vetive më të rëndësishme të menaxhimit të liderëve të tillë është koordinimi dhe inkurajimi i të tjerëve që të ndërmarrin aktivitete lideriste në sfera të caktuara ose në faza të caktuara të fushatës.

Kjo do të thotë delegim i përgjegjësisë (një termin më stimulues sesa ndarja e detyrave) tek liderët tjerë.


Duhet të mbahet mend: në fazën e hershme të fushatave, motivimi dhe angazhimi i vullnetarëve dhe mbështetësve është kritik, prandaj skajshmërisht është e rëndësishme që të fitohen liderë/organizatorë të rinj që të formohen ekipe lideriste.

Kritere për efikasitet ekipor:

1. Kapacitetet e ekipit shkojnë në favor të objektivit që duhet të arrihet
2. Ekipi mëson se si të punojë më mirë gjatë kohës së përgatitjeve dhe gjatë realizimit të aksionit
3. Ekipi e mbështet zhvillimin dhe specializimin individual

Që të arrihet ky efikasitet ekipor, më parë duhet të sigurohen kushtet për një start të mirë:

1. Ekipi i liderëve/organizatorëve është stabil dhe i di potencialet dhe kufizimet.
2. Misioni i juaj ka drejtim të qartë. Detyrat që duhet t'i realizoni janë të qarta, sfiduese, janë të rëndësishme për aksionin që realizoni.



3. Ekipet punojnë në mënyrë të pavarur dhe në të njëjtën kohë të lidhura me ekipet tjera lideriste.
4. Ekipet e mira ndihmohen me njëra-tjetrën. Ekipet e mira komunikojnë kur u duhet ndihmë.
5. Keni rregulla të qarta.

TREGIMI/NARRACIONI I NJË AKSIONI QYTETAR

Për mossuksesin e një aksioni qytetar fajtorë më shpesh janë inercia, frika, shkalla e ulët e vetëbesimit, izolimi dhe apatia. Këto gjendje tejkalohen me urgjencë, shpresë, duke e ditur se qytetarët mund të bëjnë dallimin, me solidaritet dhe me mllef.

Instrumentet për kapërcimin e emocioneve që krijojnë inhibicion, qëndrojnë tek narracioni, te tregimet:

- Te secili aktivist veç e veç (*Tregimi im*),
- Në tregimet e bashkësisë sonë (*Tregimi ynë*), dhe
- Në *Tregimin tani dhe këtu*, që shkruhet dhe transmetohet derisa zgjat aksioni qytetar.

“Tregimi im” tregon se përse secili prej nesh i është bashkuar aksionit. “Tregimi ynë” i bashkon vlerat e bashkësisë, të organizatës, ose të fushatës ad-hoc, si dhe resurset që ka bashkësia që ta arrijnë objektivin. “Tregimi tani e këtu” tregon urgjencën, sfidën aktuale, për të cilën jemi thirrur për ta ndërmarrë aksionin.

Të tri elementet që e bashkojnë tregimin që e përhapim janë: Sfida, Zgjedhja dhe Rezultatet, përkatësisht ndryshimet që duhet t'i arrijmë.

Shumë elemente të “Tregimit tani e këtu” janë të njohura dhe të afërta. Sfida, në vend se të jetë në të kaluarën, tani është këtu. Shpresa është në të ardhmen, në ndryshimet e ardhshme që duhet të ndodhin me aksionin qytetar. Zgjedhja nuk është zgjedhje të cilën ndonjëherë e kemi bërë, por është zgjedhje që e bëjmë tani. Se këndejmë, “Tregimi tani e këtu” është për nevojën urgjente, aktuale, për ndryshim, e cila kërkon që t'i kushtohet vëmendje e plotë, ndërsa rrënjët e saj janë në “Tregimin tim” dhe “... tonë”.

“Tregimi tani e këtu” është aksioni që e ndërmarrim.

PJESA II

QYTETARIA AKTIVE – NGA INICIATIVA QYTETARE TE FUSHATA E REALIZUESHME

Për ato grupe qytetarësh që kërkojnë modele dhe vegla pak më strategjike për ndryshim social efektiv, punë këtu kanë: fushatat!

Çfarë janë fushatat? Në thelb, fushatat janë përpjekje të organizuara dhe të vazhdueshme për arritjen e një drejtësie të caktuar sociale. Fushatat janë mënyrë e fortë për ndërtimin strategjik të kapaciteteve, zhvillimin e përvojës dhe vënien e themeleve për lëvizje të ardhshme. Njëkohësisht, fushatat korri fitore për fushata të reja.

Fushatat kanë objektiv! Fushatat janë të definuara nga ana e objektivave të tyre, që mund të jenë të ndryshëm dhe “të mëdhenj” ose “të vegjël”: ... arritja e reformave në sferën e urbanizimit; rrezimi i diktatorit, ndryshimi i urdhëresës së Këshillit të Qytetit në lidhje me komunikacionin; sindikalizimi në fabrikat e kompanive multinacionale...

Fushatat kanë objektiv real (të realizueshëm)! Disa objektiva janë me më tepër leverdi sesa disa të tjerë. Prandaj, duhet pasur prioritete. E kotë është të ngrihet e tërë një lëvizje që do të synojë drejt objektivave të porealizueshëm (jorealë). Objektivat e realizueshëm të një fushate duhet të shikohen nga aspekti i kapaciteteve të atyre që e organizojnë fushatën.

Shikimi i objektivave realë të një fushate dhe realizimi i tyre janë inspirative dhe stimulative për aksionet (fushatat) e ardhshme qytetare.

Fushatat mund të përdorin taktika shumë të ndryshme! Bllokada, greva, marshe, paraqitje dhe fjalime në rrugë... janë vetëm një pjesë e taktikave të realizimit të një fushate. Më mbresëlënëse janë ato fushata që përmbajë paraqitje të dramatizuara. Të tilla janë, për shembull, aksionet e vazhdueshme të organizatës “Femen”. Te ne aksione “skenike” të suksesshme realizonte iniciativa qytetare “Shkupjanët e këndueshëm”. Në rajon, njëra prej fushatave më të suksesshme, e cila për një vit, në vitin 2000, e rrëzoi kryetarin e atëhershëm të Serbisë, Slobodan Millosheviq, tregoi se aksionet me inskenim dhe me humor ishin relativisht inspirative për mbështetje, solidaritet të qytetarëve dhe për vendimin e tyre që t’u bashkohen studentëve, të cilët ishin bërthama e lëvizjes “Rezistenca”.

Përse janë të nevojshme taktika të ndryshme? Ndhmon në rekrutimin dhe arsimimin e organizatave dhe individëve të caktuar si aleatë potencialë. Taktikat e ndryshme, konform grupeve të targetuara, në faza të caktuara të iniciativës qytetare janë inspirim për mbështetje të re dhe solidaritet që të ndërtohet një mosbashkëpunim më masiv me sistemin.

Që të ngrihet një fushatë, duhet – kohë! Fushatat dallojnë nga aksionet e çastit. Njëri prej objektivave të tyre është të bëjnë presion të vazhdueshëm për një periudhë më të gjatë.

DUHET PASUR PARASYSH: Te fushatat e çastit, ata ndaj kujt bëhet presioni e dinë se duhet ta durojnë valën e goditjes, ndërsa në rastin e dytë fushatat e gjata kanë për qëllim që presioni i vazhdueshëm të arrijë temperaturën deri në thyerjen e rezistencës për realizimin e aksionit qytetar dhe realizimin e objektivit të tij.

Përse kanë sukses fushatat? Një fushatë të suksesshme i duhet qytetaria (sa më shumë, aq më mirë) dhe liderët. Liderët janë të rëndësishëm, por fuqia e vërtetë e ndryshimeve sociale qëndron te populli i mobilizuar. Fushatat e ndihmojnë ndërtimin e kapaciteteve të liderëve të vendit në mjedisin e tyre lokal në një mënyrë të decentralizuar. Fitoret në nivel lokal, në nivel të iniciativave qytetare e rrisin vetëbesimin dhe stimulojnë iniciativa të reja.

Fushatat lokale mund të replikohen! Edhe pse organizatat lokale ose grupet ad-hoc duhet të gjurmojnë pas fushatave autentike, ndonjëherë janë të zbatueshme edhe fushatat që replikohen. Shumë shembuj dhe leksione praktike mund të mësohen ose të jenë inspirim nga përvojat e arritura nga koncepti “aksion i padhunshëm” i lëvizjes studentore “Otpor” (Rezistenca).

Për lindjen dhe përvojat e lëvizjes studentore “Otpor”, [më shumë këtu](http://www.aforcemorepowerful.org/films/bdd/story/otpor/otpor-origins.php) (<http://www.aforcemorepowerful.org/films/bdd/story/otpor/otpor-origins.php>)

Vrojtime kyç të “Ministrisë” së aktivizmit:

- Aktivistët besojnë se mund të bëjnë dallim në bashkësinë e tyre
- Besojnë se bëjnë dallim në bashkësi
- Zhvillojnë njohje për politikat publike
- Zhvillojnë njohje për t'i sfiduar kreatorët e politikave
- E dinë se si funksionon qeveria
- E zhvillojnë përkushtimin ndaj qytetarisë aktive
- Involohen në bashkësi
- I dinë problemet specifike të bashkësisë
- I zhvillojnë shkathtësitë për punë në grupe
- Zhvillojnë shkathtësi të rëndësishme hulumtuese dhe komunikuese



REKRUTIMI I AKTIVISTËVE DHE I MBËSHTETËSVE TË AKSIONEVE QYTETARE

Rekrutimi – Çka është ai? Thjesht, ai është aksion, ose seri aksionesh që duhet të tërheqin numër sa më të madh njerëzish për t'u bashkuar ose për ta mbështetur iniciativën tuaj.

- Një gjë është – të ftoni një numër të madh njerëzish në ngjarjet që organizoni që t'ju mbështesin.
- Tjetër gjë është – të tërhiqni sa më shumë vullnetarë që do të përfshihen në ekipet organizuese ose lideriste.

Rekrutim – Përse? Ka më shumë arsye. Ja disa prej tyre:

- Iniciativa bëhet më e shikueshme.
- Numrat e mëdhenj bartin më shumë energji, e cila e përshpejton procesin e ndryshimeve.
- Më shumë njerëz, fushata më e madhe.
- Mprehin shkathtësitë dhe argumentet për të cilat është ndërmarrë aksioni
- Aksionin e vë më afër popullit.
- Njerëz të rinj, ide të reja.
- “Fryhet” ndjenja për përbashkësi.

Rekrutim – Si?

- **Me zemër** – Ka më shumë shanse që të tërheq më shumë njerëz po qe se tregimi juaj lidhet me tregimin e bashkësisë (tregimin tonë), me nevojat e tyre dhe me “tregimin tani dhe këtu”. Prandaj, është me rëndësi që t’u kushtohet kohë e mjaftueshme vullnetarëve dhe mbështetësve që të “infektohen” me inspirimin, vizionin dhe strategjinë e aksionit tuaj. Nëse ata nuk e “blejnë” tregimin tuaj, do të jetë më vështirë me të tjerët.
- **Me arsyen** – Aksionet qytetare janë operacione të ndërlikuara. Shumë energji dhe kohë harxhohet në çështje administrative, në logjistikë, në bindjen nga ana e folësve ... Ende mbetet për t’u zgjidhur çështja e rëndësishme që të bindet një numër sa më i madh i qytetarëve që të vijnë në ngjarjet tuaja, që tua japin mbështetjen. Duhet pasur parasysh: nëse doni që në ngjarjen tuaj të vijnë 1.000 qytetarë, duhet të informoni më së paku 3.000.

PJESA III

KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

„Propaganda për demokracinë është ajo që për regjimet diktatoriale është dhuna.“

Noam Çomski, „*Manufacturing Consent: The Political Economy of the Mass Media*“, (1988), by Edward S. Herman and Noam Chomsky

I njohur edhe si analist i mediave, Noam Çomski bashkë me Eduard Hermanin e koncipojnë modelin e propagandës, sipas të cilit në kushtet e ekonomisë së tregut, edhe krahas mungesës së intervenimit shtetëror, mediat nuk janë të paanshme dhe janë nën ndikimin e fuqisë korporative.

E filluam këtë pjesë të doracakut, “Komunikim me publikun”, me temën Propagandë për shkak se përvojat bashkëkohore shënojnë se pushtetet, në kushtet e kontrollimit të mediave, i shfrytëzojnë mjetet e propagandës që t’u shërbejnë elitave dominante (politike ose të biznesit) dhe interesave të tyre dhe që ta objektivizojnë realitetin mediatik, në vend të realitetit objektiv.

Mjetet e propagandës në media:

- Selektimi i temave
- Distribuimi me interes i temave
- Theksimi
- Vënia e temave në korniza
- Filtrimi i informacioneve
- Udhëheqja me debatet
- Defokusimi
- Komunikimi me publikun

Realiteti mediatik është gjendje në të cilën përdorimi i vazhdueshëm i propagandës krijon pseudo-realitet, iluzion, që ka për qëllim të imponohet si objektiv dhe në atë mënyrë ta

shtrembërojnë perceptimin e shikimit të realitetit dhe të krijojnë mendime publike në favor të politikave në pushtet.

Së këndejmi, komunikimi me publikun është pjesë thelbësore e iniciativave qytetare të organizuara.

Procesi për informimin e publikut për motivin, aktivitetet dhe objektivin e një organizimi

Forma themelore e këtij komunikimi është prodhimi dhe distribuimi i raporteve të rregullta, ndërsa forma plotësuese janë:

- Mbulimi mediatik
- Ndikimi ndaj vendimeve të kreatorëve të politikave
- Krijimi dhe ruajtja e reputacionit tek: aktivistët, vullnetarët, partnerët, qeveria, donatorët, të tjerët...

Objektivi i komunikimeve me publikun: Ta promovojë objektivin e iniciativës qytetare, ta sigurojë të kuptuarit e tij dhe të vë bashkëpunim midis organizatës dhe grupeve më relevante të targetit të tij. Në objektivat e veçantë dhe specifik të komunikimit me publikun është krijimi i pamjes së organizatës që e ndërmerr iniciativën.

Përse është e nevojshme pamja pozitive?

- T'i përmirësojë raportet e organizatës me partnerët.
- T'i përmirësojë raportet me të punësuarit dhe vullnetarët.
- T'i përmirësojë perspektivat financiare dhe raportet mes partnerëve.
- T'i përmirësojë performancat e organizatës.
- Të përmirësohet mirëkuptimi.
- Atëherë kur grupet e targetuara nuk kuptojnë se çfarë punon organizata dhe cili është objektivi i saj.
- Atëherë kur puna dhe aktivitetet janë shumë profesionale, komunikimi me publikun ndihmon që të përshkruhet aktiviteti, për secilin më lehtë i kuptueshëm.

Format dhe objektivat e komunikimit publik dallojnë për çdo organizatë më vete

Përse është i domosdoshëm komunikimi me publikun? Ja disa shkaqe për domosdoshmërinë:

- Organizatave iu duhen mbështetje dhe financa. Dukja e organizatave qytetare dhe e iniciativave të tyre është me rëndësi për grumbullimin e financave nga donatorët.
- Liderët e organizatave qytetare dhe të iniciativave të sponsoruara janë të obliguar që t'i informojnë donatorët, klientët, partnerët, obliguesit tatimorë dhe publikun për aktivitetin e tyre dhe për mënyrën se si shfrytëzohet mbështetja financiare e donatorëve.

Nga ana tjetër, organizatat qytetare kanë nevojë për fedback për aktivitetet e tyre që të fokusohen në objektivin e tyre dhe të jenë relevante në raport me nevojat e bashkësisë. Arrijte jo më pak e

vogël nga komunikimi me publikun është vënia e lidhjeve me partnerët e rinj dhe me ata potencialë, me të cilën gjë forcohet rrjetëzimi dhe bashkëpunimi me organizatat dhe iniciativat qytetare simotra.

Forma të tjera të komunikimit

Komunikimi i brendshëm: Informimi i aktivistëve dhe i vullnetarëve të përfshirë në një iniciativë, ose në shoqëritë qytetare. Është i domosdoshëm, për shkak se gjatë gjithë kohës i siguron informacionet e domosdoshme për rrjedhën e iniciativës, për reagimet, për rezultatet sipas fazave. Kjo u jep pjesëmarrësve në iniciativë ndjesinë se ata vazhdimisht i takojnë asaj dhe se janë të përkushtuar ndaj aksionit. Në të njëjtën kohë, kjo siguron sistemin e përfshirjes së aktivistëve dhe të vullnetarëve në fazat adekuate të iniciativës që të marrin pjesë me aktivitete gjegjëse, të cilat dalin nga shkathtësitë dhe dituritë e tyre.

Komunikimi profesional është i domosdoshëm po qe se gjatë kohës së iniciativës bëhen hulumtime të caktuara, ose arrihen njohuri për të cilat nevojitet ndonjë profesionalizëm i veçantë.

Rrjetëzimi: Komunikimi i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i informacioneve e ndihmon koordinimin e aktiviteteve me partnerët dhe siguron hapësirë për përfshirjen e partnerëve të rinj në iniciativë.

Puna me mediat

Komunikimi me mediat, e përmes tyre edhe me opinionin publik, sot kryesisht bëhet përmes mediave tradicionale, përmes internetit dhe rrjeteve sociale.

Në pjesën e tradicionaleve - radioja, televizioni, gazetatat, magazinat, janë media të cilat ende kanë potencial që ta sigurojnë komunikimin e iniciativave qytetare, të organizatave me grupet e tyre të targetuara dhe me opinionin më të gjerë. Me mediat tradicionale, veçmas me televizionin, arrihet përfshirja e një publiku më të madh se sa ajo çka mund të bëhet vetëm me aktivitetet programore.

Mungesa e ambientit mediatic maqedonas, në pjesën e mediave tradicionale, është se ajo është tërësisht e “sunduar”, e partizuar, e politizuar dhe e ndarë, përfshi dhe servis radiodifuziv publik, i cili sipas Kushtetutës dhe ligjeve duhet të jetë servis i qytetarëve dhe i iniciativave të tyre. Fushatat e paguara janë të shtrenjta, ndërsa iniciativat qytetare nuk kanë buxhete për një gjë të tillë, kështu që raportet me mediat tradicionale relativisht janë të ndërlikuara.

Raportet me mediat – Sidoqoftë, organizatat qytetare dhe organizatorët e iniciativave nuk duhet të heqin dorë nga arritjet që mund të fitohen nga mediat, qoftë edhe në kushte të këtiilla. Thjesht, duhet të përshtaten me kushtet, t'i studiojnë shprehitë dhe nevojat e tyre dhe të gjejnë mënyra të reja për t'i kapërcyer pengesat.

Në këtë kuptim, ruajtja e raporteve të mira me mediat është jashtëzakonisht e rëndësishme. Si e para, siç thamë tashmë, duhet t'i kuptoni nevojat e tyre. Që të jetë kjo funksionale, përgatituni që të siguroni:

- Informacione që ju duhen
- Atëherë kur ju duhen (tajming)
- Në formën më të leverdishme të tyre

Kur themi se ruajtja e kontakteve me mediat është shumë e rëndësishme, mendojmë edhe në atë se aktivistët qytetarë duhet ta shfrytëzojnë profesionalizmin e tyre dhe përvojën direkte me temat reale të qytetarëve që të imponohen si ekspertë. Ata duhet të jenë të përgatitur për paraqitje mediatike po qe se ndodh diçka që kërkon analizë ekspertësh nga sfera që është specialitet i organizatës (epidemi, diskriminim, sundimi i të drejtës, ekologji ...).

Gatishmëria për paraqitjen mediatike është e domosdoshme edhe kur organizata është në krizë, për shkak se në raste të këtilla mbulesa mediatike e pakontrolluar nuk është e dëshirueshme. Në këtë kuptim liderët e bashkimeve dhe iniciativave qytetare, si dhe të personave përgjegjës për marrëdhënie me publikun, patjetër të jenë të përgjegjshëm dhe të përgatitur që t'ia dalin me mediat.

Përgatitja për paraqitje mediatike realizon arritje në:

- Krijimin e pamjes adekuate të organizatës në publik
- Promovimin e politikave dhe iniciativave për të cilat angazhohet shoqëria ose iniciativa
- Informimi dhe këshillimi i target – grupeve

Që të arrihet dituria e dëshiruar për komunikim me mediat, është e nevojshme njohja me karakteristikat elementare të natyrës së mediave dhe redaksive të ndryshme. Kjo ndihmon që të mos ndihen sikur të jeni në ndonjë territor të huaj, kështu që me rëndësi është të dihet se çdo media dhe çdo redaksi e ka mënyrën e vet të punës. Media të ndryshme, nevoja të ndryshme:

- **Redaksitë e deskut** të gazetave, radiove dhe televizioneve, për lajme të reja për çdo ditë dhe në çdo moment
- **Magazinet dhe producentët e programeve dokumentare** kanë nevojë për storje që hyjnë më thellë
- **Radiot dhe TV-stacionet lokale, si dhe gazetat lokale** duan storje që kanë lidhje me shikuesit, me dëgjuesit dhe lexuesit e tyre
- **Korrespondentët e agjencive dhe mediave të huaja** i interesojnë storjet me ndikim më të gjerë

Si të arrihet te mediat dhe çka është ajo që mediat e presin nga informacionet që kanë potencial të jenë lajm? Ekzistojnë më tepër mënyra, por dy janë bazë:

- Me sigurimin e informacioneve drejtpërdrejt në media
- Me organizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve që ia vlen të jenë lajm

E dyta, organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve që kanë potencial në vetvete për të qenë lajm mediatik, është mënyra më e mirë. Kërkon pak më shumë angazhim dhe kreacion të aktivistëve, por në detin e informacioneve që sot arrijnë në media, selektimi i atyre që do të bëhen lajm i ditës është shumë i rreptë.

Për një komunikim të mirë me mediat ndihmojnë edhe këto informacione të tipit “thashethem” për gazetarët. Kini parasysh:

- Shumica e gazetarëve janë të gjithëdijshëm, përkatësisht kanë njohuri sipërfaqësore për shumë punë.
- Më pak prej tyre janë me të vërtetë të “specializuar”.
- Shumë shpesh arsimimi i tyre nuk përputhet me specializimin e tyre gazetaresk.

Çka duan gazetarët?

- Ju duhen shpjegime të detajuara. Ua jepni, për shkak se nëse i lini që vetë t'i nxjerrin konkluzionet, mjerë ju dhe iniciativa.
- Disave ju duhet ndihmë. Më të këqij janë ata të cilëve iu duhet ndihmë, por janë hijerëndë në kërkimin e saj.
- Pyesin për çështje elementare. Kjo nuk është keq. Kjo është më mirë sesa të mos pyesin.

Të mos harrohet: Nuk bëhet nga çdo informacion lajm. Prandaj, cilët janë faktorët themelorë që duhet t'i ketë një informacion që të shndërrohet në storje mediatike relevante?

- Të jetë e re dhe me interes për pjesën më të madhe të publikut (do të thotë, duhet të ketë relevancë).
- Të jetë befasues, provokativ dhe të ketë kënd të ri.
- Të jetë tërësisht i saktë.
- Të shpallet në kohë.

Ja edhe disa elemente për storje të suksesshme:

- Në kohë
- Relevancë dhe me interes për publikun e përgjithshëm ose për një pjesë të tij
- Me interes për bashkësinë, për shtetin, për botën
- Kënd i pazakonshëm
- Person me interes. Po qe se informacioni lidhet me ndonjë personalitet të njohur, ai fiton përparësi
- Fotografi ose video e mirë

Sigurohuni që storja ka më së paku 2-3 prej këtyre elementeve që të marrë vëmendjen e mediave.

Plasimi i storjes suaj: Përgatiteni informacionin me selektimin e elementeve më të rëndësishme që duhet t'i përmbajë porosia mediatike. Le të jetë ajo e thjeshtë, jo me dy kuptime dhe e qartë. Le të jetë e shkurtër. Prezantoni një ide, një element, në një komunikatë për media. Nëse keni më shumë ide, shndërroni në porosi për ndonjë rast tjetër në të ardhmen. Në të kundërtën, mund të ballafaqoheni që mediat vetë ta bëjnë selektimin dhe zgjedhjen e informacioneve në komunikatën tuaj. Të jeni të sigurt se në këtë rast nuk do të jeni me fat.

Si ta shkruani storjen? Po qe e mundur, ikni asaj që ju ta shkruani lajmin. Megjithatë, lëreni këtë për gazetarët. Por, gjithsesi, elementin kyç të storjes ta vendosni në krye të informacionit. Largojuni gjuhës profesionale dhe teknike. Gjithçka mund të shpjegohet në mënyrë të thjeshtë, popullore. Nëse ka numra, bëjini të kuptueshëm dhe figurativ. Nëse ka më shumë numra dhe statistika, patjetër t'i ndani në letër dhe ato t'ua shpërndani gazetarëve.

A do të publikohet storja? Po qe se ju u përmbaheni këtyre parimeve bazë dhe po qe se e gjeni mënyrën mediatike me interes për prezantimin e informacionit tuaj, ka shanse të mëdha. Por, gazetarët nuk mund ta garantojnë këtë. Ata e shkruajnë lajmin, redaktorët e redaktojnë ose e "ftallojnë", kështu që mund ta ndryshojnë, ta ndërrojnë këndin deri në atë shkallë sa nuk do të arrini ta njihni informatën tuaj. Por, kjo nuk duhet t'ju pengojë që të përipiqeni në përhapjen e informacioneve tuaja.

PJESA IV

RRJETET SOCIALE DHE FUSHATAT

Shoqëritë dhe bashkësitë qytetare gjithmonë janë në kërkim të gjetjes së mënyrës më të mirë për t'ia dalë mbanë me barrierat të cilat e pengojnë dialogun dhe të jenë më afër thelbit të demokracisë **participative**. Që ta realizojnë atë nëpërmjet komunikimit me publikun, një nga veglat dhe mediumet më të shfrytëzuara kohëve të fundit në internet janë **rrjetet sociale**. Parimet e funksionimit në rrjetet sociale, praktikisht rrjedhin nga mënyra se si pulsojnë bashkimet dhe shoqëritë qytetare: të lidhen, të ndajnë dhe të iniciojnë realizime në interes të përbashkët, të ndërmarrin aksione... Rrjetet sociale u mundësojnë bashkësive t'i ndajnë përvojat e tyre nëpërmjet *e-vendeve*, *e-veglave* dhe *e-shërbimeve* dhe që moti e zëvendësuan emailin si vegël për komunikim, që ishte i njëanshëm, pa bashkëveprim. Në dallim nga gjenerata e parë e internet-komunikimit, e dyta dhe e treta (nëpërmjet komunikimit mobil) mundësojnë komunikim dhe bashkëveprim të paparë të shumanshëm.

Shkallët e përfshirjes. Duke marrë parasysh se rrjetet sociale lidhin njerëz dhe individualistë të cilët tashmë i kanë *e-vendet* e veta me të gjitha shprehitë e tyre, me leverdi është të njihen disa prej shprehive që ato kanë, që të njihen si partnerë potencialë në iniciativat qytetare. Ja një ndarje e mundshme:

- **Kreatorët:** bllojojnë, publikojnë statuse, ueb-faqe, krijojnë video, përmbajtje audio dhe grafike, shkruajnë storje...
- **Kritikuesit:** publikojnë rejttingje dhe kritika në postet e tyre, komentojnë në bllogje të tjera, marrin pjesë në forume, marrin pjesë në krijimin e wiki-përmbajtjeve...
- **Koleksionistët:** janë të parapaguar në RSS-fide, „votojnë“ në ueb-faqe, „tagojnë“ fotografi dhe ueb-faqe...
- **Pasuesit:** krijojnë profile në rrjetet sociale, vizitojnë rrjete sociale.
- **Vëzhguesit:** lexojnë bllogje, dëgjojnë podkaste, shikojnë video të huaja, lexojnë forume onlajn, lexojnë kritika dhe rejttingje...
- **Pasivët:** s'bëjnë asgjë nga kjo çka u tha më parë.

Mediat sociale, si pjesë e strategjisë mediatike për komunikimin e aksioneve qytetare me publikun, nuk duhet të shihen si zgjidhje të gatshme. Ato janë këtu, ato kanë potencial, por nuk janë shkop magjik për zgjidhjen e problemeve tuaja komunikuese.

Për këtë shkak, gjithnjë duhet të vlerësohet niveli gjegjës dhe potenciali i këtyre mundësive në planifikimin e komunikimeve të iniciativave të bashkësive. Thjesht, nuk ka model të pranuar me shtrirje të gjerë. Çdo iniciativë duhet të krijojë strategji të vet, autentike, komunikuese.

Rrjetet sociale dhe fushatat. Kur bëhet fjalë për krijimin e strategjisë komunikuese për ndonjë fushatë qytetare, duhet pasur parasysh:

- Kontrollin e informacioneve – ato që dërgohen dhe ato që vijnë nga jashtë.
- Domosdoshmërinë e ekipit liderist dhe të ekipit që e krijon dhe që e realizon komunikimin me publikun.
- Duhet të mbahet llogari për etikën e sjelljes në lidhje me projektin dhe me organizimin.

Në këtë kuptim, gjithsesi, ajo që mund të pritet si arritje nga komunikimi gjegjës dhe mirë i realizuar i komunikimit përmes rrjeteve sociale është se ato janë mjeti efektiv për sigurimin e mbështetësve dhe se, në të njëjtën kohë, janë proces i hapur për kritika/recensione dhe mbikëqyrje për atë shkak se janë të hapura për interaksion për të gjitha sugjerimet. Kjo e ndihmon lidhjen e interesave të përbashkëta dhe lidhjen në rrjet të të gjithë atyre që do të ndjejnë se ideja dhe objektivat e iniciativës civile janë të rëndësishme edhe për bashkësinë e tyre ose për ata si individë. Përfundimisht, ky tip interaksioni pa dyshim se e përparon demokracinë dhe pjesëmarrjen direkte të qytetarëve.

Rrjetet sociale janë vegla të jashtëzakonshme për përhapjen e informacioneve. Procesi është më i suksesshëm kur është në kombinim me komunikimin e drejtpërdrejtë, fytyrë për fytyrë, përkatësisht me njërin prej arritjeve bazë të iniciativave civile – komunikimin e drejtpërdrejtë të njerëzve në një bashkësi të lidhur në emër të objektivit të aksionit. Në të njëjtën kohë, rrjetet sociale për shkak të lidhjes dhe interaksionit, janë mundësi serioze për të mësuar raportin kritik në tema aktuale. Por, gjithsesi se kjo nuk është e mjaftueshme. Nevojitet që edhe pak më shumë të njihen parimet për t'u realizuar një fushatë e suksesshme komunikuese.

Kutia me vegla në mediat sociale. Në këtë kuti ka 4 të ndara, të cilat thirren:

- Fokus
- Nxit vëmendje
- Aksion
- Angazho

Identifikoni një objektiv të thjeshtë, konkret dhe që mund të matet: Edhe pse rrjetet sociale gjerësisht përdoren për të nxitur aksion, njerëzit që i përdorin më suksesshëm kanë një veçori të përbashkët: fokusin preciz. Sado që të jetë i madh, kërcënues dhe impresiv, realizimi i çdo objektivit fillon me disa njerëz dhe hap pas hapi. Prandaj, shkak i përcaktuar qartë, veprimet e përcaktuara qartë për ndryshim, fazat e përcaktuara qartë për realizim dhe objektivi i qartë, dëshmojnë se një iniciativë ka - fokus.

Fokusi le të jetë human: Fokusojeni fushatën tuaj tek ata që doni t'i ndihmoni më shumë sesa menjëherë të propozoni zgjidhje. Zgjidhjet do të vijnë më lehtë dhe do të jenë më adekuate po qe se në fazën e hershme të strategjisë për komunikim të iniciativës suaj njiheni me problemin dhe me njerëzit që përfshin ai (problemi), për të cilët ndërmerret aksioni. Aksioni gjithashtu duhet të jetë i qartë. Bëjeni planin e realizimit në faza. Bëni hapa të vegjël që t'i kapni fazat e planifikuara, që ta arrini makro-objektivin afatgjatë.

Për të parë se deri ku keni arritur dhe a realizohet gjithçka sipas planifikimit, bëjeni vlerësimin dhe jepeni notën tuaj. Identifikoni sistem vlerash (indikatore), që do t'u ndihmojë ta vlerësoni realizimin e iniciativës suaj në çdo fazë. Bëni teste për t'i kontrolluar supozimet tuaja. Kjo do t'ju japë informacione për t'i vlerësuar hapat në vazhdim.

Respektoni afatet dhe festoni fitoret e vogla, gjithsesi pa u defokusuar nga objektivi kryesor. Objektivi vazhdimisht duhet të jetë i fokusuar, që t'i ruani shanset për sukses dhe të krijoni momente të nxitjes plotësuese.

Me shumë rëndësi është që në çdo fazë të jeni të sigurt se objektivi i iniciativës suaj ka kuptim për çdo aktivist, për çdo vullnetar dhe për çdo individ nga target-grupi juaj dhe se me çdo cak të arritur me sukses shkaktoni gëzim, fat dhe nxitje të re.

Nxit vëmendje është e ndara e dytë në rutinë me vegla në rrjetet sociale. Me fjalë të tjera, ajo porositi: „Bëje që të shihen!“ Të nxitet vëmendja është më shumë sesa shkaktimi i shkurtër i interesimit të ndonjë që e bën skanimin e faqes në ekranin e kompjuterit derisa e lexon porosinë tuaj onlajn në ndonjë rrjet social. Flasin për një karrem më të komplikuar. Karremi i tillë provokon dëshirë për më shumë dituri dhe informacione. Kur do të tërhiqni vëmendje, do të ndodhin gjëra të mrekullueshme.

I bëni kreacion fushatës me karrema që do të shkaktojnë identifikim të lehtë të iniciativës suaj. Bëni përmbajtjet të papritura dhe befasuese. Njerëzit duan informacione të reja, të cilat pastaj duan t'i përndajnë. Tërhiqni ashtu që do ta sfidoni kërshtërinë e tyre. Ja një truk që ndihmon: Vendoseni të njohurën në kornizë të re:



Gardh prej një milion dollarësh! Aksion qytetar si shprehje e pakënaqësisë nga “barokëzimi” i Shkupit

Organizimi i ngjarjeve si pjesë e strategjisë së komunikimit, përveç tërheqjes së mediave është i mirë edhe për vizualizimin e iniciativave. Rezultatet nga ky vizualizim, fotografitë dhe videot janë material i mirë për komunikim në rrjetet sociale. Dëftoju gjërat, mos trego me fjalë. Fotografitë dhe videot zëvendësojnë mijëra fjalë, thonë parimet e komunikimit mediatic.

Prek deri në instinkte është rekomandimi tjetër i mirë që vjen nga e ndara “Shkakto vëmendje” në rutinë me vegla në rrjetet sociale. Duhet të disenjohen fushata që i aktivizojnë shqisat – vende, tinguj, shije... Përdorni muzikë që të hyni më thellë, që të shkaktoni emocione.

Një hulumtim ka treguar se vetëm 6 për qind e të anketuarve kanë pohuar se reklamat ndikojnë në vendimet e tyre. I njëjti hulumtim ka vërtetuar se madje 90 për qind e të anketuarve më shumë u besojnë rekomandimeve të miqve dhe të njohurve të tyre. Njerëzit mbajnë mend 80 deri në 90 për qind nga ajo që shikojnë, ndërsa më pak se 15 për qind nga ajo çka dëgjojnë ose lexojnë.

Prandaj, mos fol – por, dëfto!

Rekomandime dhe truqe të tjera:

- **Le të jetë shkurt:** pa marrë parasysh se a është video apo slogan. Precizja, e shkurtra dhe figurativja e rrëmben vëmendjen
- **Le të jetë personale:** Bëni „tag “ fotografish
- **Zgjidhni ngjyrën e fushatës suaj:** Kanceri i gjirit - rozë...

Angazho është e ndara e tretë në kutinë me vegla në rrjetet sociale. Rekomandimi i parë në të është: Insisto për lidhje personale!

Angazhimi, involvimi, është sfida më e madhe nga të katër krahët e këtij modeli. Angazhimi i pasuesve është më tepër art sesa shkencë. Mënyra se si i involvoni, nuk ka shumë lidhje me logjikën dhe arsyen. Mund të keni argumente të mira se përse njerëzit do të duhet t'ju bashkohen, por nëse nuk i angazhoni emotivisht, do të hamenden.

Prandaj: Rrëfeni tregim! Krijoni tregime të argumentuara, “të ngjitshme”, për t'i transmetuar informacionet e rëndësishme. Mbajeni mend: më pak është më shumë!

Zhvilloni empatinë (njëjtësimin). Derisa i angazhoni të tjerët, lejoni që target-grupi tuaj t'ju angazhojë edhe juve. Ç'është me rëndësi për ta? Ç'lidhje ka ajo me fushatën tuaj?

Autenticiteti i fushatës suaj është “karremi” i radhës. Afshi i singertë është ngjitës. Sa më tepër që të jeni autentik, aq më shumë të tjerët do ta kenë më të lehtë që të lidhen për ju dhe për fushatën tuaj. Ndërtoni bazë të përbashkët që t'i përndani bindjet dhe vlerat tuaja.

Tregimet e mira janë medime për porosinë tuaj dhe, në të njëjtën kohë, storje tërheqëse edhe për mediat tradicionale, të cilat, të mos harrojmë, gjithnjë e më shumë marrin informacione nga rrjetet sociale. Kur veç është ashtu, vendosini tregimet tuaja atje. Në çfarë mënyre kumtojmë diçka, është po aq e rëndësishme me atë që tregojmë. Lidheni komunikimin me kontekstin.

Përse janë të rëndësishme storjet? Nga aspekti psikologjik, për shkak se truri i njeriut është i organizuar që të absorbojë storje dhe të orientohen sipas tyre, për shkak se funksionojmë sipas rregullave që të kuptojmë. Tregimet u japin jetë fakteve dhe u injektojnë afsh.

Ndërmerr aksion, është e ndara e katërt. Aksioni siguron mundësi dhe jep fuqi. Rekomandimet që dalin nga kjo pjesë janë kritike për të mbyllur rrethin që do t'ua hapë mundësinë atyre që tregojnë interes që të shndërrohen në subjekte që mund të bëjnë ndryshime në bashkësi.

Aksioni le të jetë i lehtë dhe i thjeshtë. Ashtu do të jetë më i pranueshëm. Fushata ka më shumë shanse për sukses po qe se njerëzit e kuptojnë dhe e njohin objektivin si të nevojshëm. Le të jetë argëtues. Le të jetë si lojë, me humor, figurativ.

Shtroni pyetjen: A mund të ndihen sërish si fëmijë?

Këshilla për Facebook

■ **Krijoni faqe facebook-u (jo profil)**

Kjo do t'ju mundësojë të keni adresë URL (pasi të keni marrë 25 fansa), më tepër administratorë, tab për mirëseardhje dhe platforma për përmbajtjet tuaja.

■ **Ngjitni përmbajtje**

Askush nuk e ka për qejf që të jetë i pari në zbatimje dhe askush nuk do që të jetë i pari që do të shkruajë në murin tuaj në Facebook. Lidheni faqen tuaj të Facebook-ut me ueb-faqen tuaj dhe bëjuni link përmbajtjeve... Bëni gjithçka që të keni përmbajtje që iu duhen të tjerëve dhe që mund të përndahen.

Testoni përmbajtje të ndryshme-shmangijuni njëtrajtshmërisë.

Është i domosdoshëm testimi i vazhdueshëm i përmbajtjeve mbi bazë të përvojës, që të zbulohet

mënyra e vërtetë dhe më e mirë e plasimit. Shtroni pyetje, bëni link te vendet me interes për ju dhe të target-grupit tuaj. Nëse nuk merrni “llajke” dhe komente të mjaftueshme – mos u dorëzoni, vetëm bëni diçka më ndryshe.

■ **Shfrytëzoni video.**

Përbajtet multimediale e mbajnë gjallë interesin e fansave dhe ndihmojnë që më mirë të njihen me aktivitetin tuaj. Ngjitni video në Facebook. Mos bëni link me YouTube, sepse shfrytëzuesit mund të shkojnë.

■ **Jini viralë (përhapeni virusin)**

Viraliteti në Facebook bëhet me tagetim. Miqtë, fotografitë dhe fan-faqet e tagetuara të përbajtjeve që përndahen, paraqiten si fide te shfrytëzuesit tjerë dhe janë potencial i ri për përndarje të re dhe të vazhdueshme.

Shembull: Leni Kravic angazhon fotoreporterë që t'i incizojnë njerëzit në koncertet e tij. Pastaj i vë në faqen e vet dhe iu mundësohen fansave që të “shënohen” dhe në atë mënyrë e rrisin numrin e vizitorëve të faqes së vet.

■ **Jini aktivë**

Sapo të ketë publikuar ndokush në faqen tuaj, kthejani menjëherë. Kështu e ruani angazhimin tuaj dhe tregoni se kujdeseni për fansat tuaj.

■ **Ndiqeni statistikën**

Me sistemin e statistikës që ka Facebook shumë lehtë mund ta ndiqni se prej ku vijnë “llajket” dhe të dhënat tjera demografike të fansave tuaj. Facebook mundëson që t'i njihni miqtë dhe ithtarët tuaj, cilat janë interesat e tyre, si të arrini tek ato...

■ **Mbani mend: Facebook është Facebook**

Mos prisni që fansat tuaj në Facebook menjëherë dhe pa përjashtim do të “ngjiten” për iniciativën tuaj. Njerëz të ndryshëm rrinë në qoshe të ndryshme në universin e rrjeteve sociale dhe kanë interesa dhe motivacione të ndryshme.

PJESA V

VULLNETARIZMI DHE AKTIVIZMI QYTETAR PËR PARTICIPIM MË TË MADH POLITIK

Në shoqëritë demokratike njëra prej sfidave për participim më të madh politik është krijimi i mjedisit ku individë me bekground të ndryshëm kanë mundësi të marrin pjesë në krijimin dhe në nxjerrjen e politikave në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar; social, ekonomik dhe politik mes dy cikleve zgjedhore.

Përse? Për shkak se:

- Pjesëmarrja qytetare ka forma të ndryshme në ngritjen e besimit e të përgjegjësisë ndaj obligimeve dhe detyrimeve të qytetarëve dhe institucioneve.
- Kontribuon në forcimin e inkluzivitetit të kategorive të ndryshme të qytetarëve dhe në kohezionin e bashkësisë.

- Sistemet jodemokratike dhe autoritare nuk njohin një angazhim të këtitillë qytetar dhe për këtë shkak tek ato nuk ka pjesëmarrje, besim dhe përgjegjësi direkte qytetare.

Cila është sfida e aktivizmit qytetar?

- Të njihet kontributi i aksionit qytetar si hapje e mundësisë për bashkësi më të drejtë, inkluzive, me mundësi reale të barabarta për të gjithë qytetarët e saj veç e veç dhe për të gjitha grupet e tyre të organizuara.
- Të njihet se edhe vullnetarizmi dhe aktivizmi qytetar kanë role të njëjta të rëndësishme për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në shoqëri.

Vullnetarizmi gjeneron shumë të arritura, të cilat njihen si thelbësore për participimin qytetar në pushtet, por 4 faktorë janë themelartë:

- Vullnetarizmi është hapi i parë në përfshirjen afatgjatë në zhvillimin e bashkësisë.
- Vullnetarizmi dhe aktivizmi qytetar krijojnë liderë, i definojnë hapësirat e përkushtimit dhe i mobilizojnë individualistët.
- Vullnetarizmi e bën relevant aktivizmin qytetar në nivel lokal.
- Aktivizmi qytetar fillon me vullnetarizëm.

Vullnetarizmi është hapi i parë në përfshirjen afatgjatë në zhvillimin e bashkësisë:

- Nga format tradicionale të vullnetarizmit në bashkësitë lokale (kujdesi për personat pleq, mbështetja e aktiviteteve sportive dhe e aktiviteteve të tjera humanitare të bashkësisë...), deri në aktivizëm qytetar hardkor dhe protesta...
- Sipas programit dhe rekomandimit të Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara (UNV, www.unv.org), pranimi i hershëm i vullnetarizmit është bazë në një angazhim afatgjatë të qytetarëve në zhvillimin e bashkësisë.
- Përvojat dhe njohuritë tregojnë se sa më herët që qytetarët t'i pranojnë aktivitetet vullnetare, për aq është më e lartë shkalla e "infektimit" me aktivizëm qytetar.
- Kjo është e ndërlidhur me kontaktin më afatgjatë dhe thelbësor me çështjet për zhvillimin e bashkësisë dhe me mundësinë për të qenë në kontakt me procedurat, veprimet dhe mënyrat për zgjidhjen e çështjeve me rëndësi për zhvillimin e bashkësisë.

Vullnetarizmi dhe aktivizmi qytetar krijojnë liderë, i definojnë sferat e përkushtimit dhe i mobilizojnë individualistët.

- Aftësitë lideriste që zbulohen, që krijohen dhe që zhvillohen gjatë aktiviteteve vullnetare, e mandej edhe në format e hershme të aktivizmit qytetar, janë kritike kur bëhet fjalë për mobilizimin e qytetarëve në aktivitetet e mëvonshme për zhvillimin më të mirë të bashkësisë.
- Kapacitetet dhe shkathhtësitë lideriste i mobilizojnë njerëzit që të bëhen pjesë e kauzave të reja dhe më të mëdha qytetare.

Vullnetarizmi e bën relevant aktivizmin qytetar në nivel lokal.

- Format e ndryshme të vullnetarizmit dhe të aktivizmit qytetar, sipas rregullit, janë të lidhura me nevojat direkte sociale, politike, ekonomike e të tjera të qytetarëve në kontekstin lokal, në këtë realitet dhe dinamikë, të aktiviteteve sociale të bashkësisë.

- Kjo praktikë e aktivizmit/vullnetarizmit grasrut është rezultat i nevojave më të drejtpërdrejta të bashkësisë dhe mu për këtë shkak ka më tepër legjitimitet.
- Që të ketë më shumë efekt, nevojat për aktivizëm qytetar dhe për iniciativa qytetare, më parë duhet të dalin nga analizat rreth nevojave të bashkësive.

Aktivizmi qytetar fillon me vullnetarizëm, ndërsa participimi i qytetarëve në bashkësi duhet të shihet si pjesë e strategjisë për zhvillim. Në këtë kuptim, nëse e pranojmë se vullnetarizmi dhe aktivizmi qytetar e nxisin participimin në krijimin dhe marrjen e politikave, përvojat njohin gjashtë arritje:

- Promovimin e inkluzivitetit
- Transformimin e afiniteteve dhe njohjeve personale
- Arritjen e njohurive
- Përvoja dhe shkathtësi në përfaqësimin, realizimin e fushatave, në ngritjen e vetëdijes
- Pjesëmarrje në krijimin e bashkësive më të mira dhe më miqësore
- Thellimin dhe përkryerjen e participimit qytetar

Promovimi i inkluzivitetit. Inkluziviteti në vullnetarizëm nuk është privilegj vetëm i klasës së mesme apo më të lartë (filantropi). Energjinë kryesore në vullnetarizëm e arrijnë kategoritë e rrezikuara qytetare, të cilat në atë mënyrë bëhen të dukshme dhe e promovojnë parimin e solidaritetit – edhe në rrezikun edhe në fitoren e atyre problemeve. Ndjesia që kanë të barabartët në rrethanat në të cilat janë gjendur është e pazëvendësueshme në fuqinë e aksionit vullnetar.

Transformimi i afiniteteve dhe njohjeve personale – Ndryshimet që arrihen në sjellje, normat, ligjet, besimet, shkaktojnë ndryshime edhe në rrafshin individual – edhe tek ata që e pranojnë ndihmën e vullnetarëve e të aktivistëve qytetarë, edhe te vetë vullnetarët dhe aktivistët. Në planin kolektiv kjo do të thotë bashkësi më miqësore dhe më të sigurt në çdo pikëpamje (sociale, të mjedisit, të sigurisë në komunikacion...). Lidhjet mes njerëzve në bashkësi bëhen më konstruktive dhe me respekt më të madh të ndërsjellë.

Arritja e njohurive –Puna në terren dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me jetën e bashkësisë siguron njohuri dhe shkathtësi të paçmueshme, që janë potencial për kontribute të reja. Ato mund të shkojnë në drejtim të krijimit të iniciativave dhe aksioneve qytetare të reja.

Përvoja dhe shkathtësi në përfaqësimin, realizimin e fushatave, në ngritjen e vetëdijes – Një pjesë e njohurive dhe shkathtësive të arritura bëhen të përdorshme në aktivitetet që përbëjnë përfaqësimin e iniciativave të caktuara për krijimin e agjendave për zhvillimin e bashkësive. Kontakti me problemet në terren e lehtëson argumentimin e tyre para lojtarëve kyç që marrin vendime për bashkësinë. Fushata dhe aksione për ngritjen e vetëdijes për arritjen e gjendjeve për ndryshime: vullnetarët me përvojë dhe ata që i prekin drejtpërdrejt çështjet me interes për bashkësinë e kanë më lehtë të organizojnë tubime, marshe, protesta, të llobojnë...

Pjesëmarrje në krijimin e bashkësive më të fuqishme – Vullnetarizmi është njëra nga strategjitë e rëndësishme për krijimin e bashkësive më të fuqishme për shkak të drejtpërdrejtshmërisë së aktiviteteve të tyre. Shikimi dhe prania e vazhdueshme në aksione ndikon në vetëndërgjegjen e bashkësive se mund të bëjnë ndryshime.

Thellimi dhe përkryerja e participimit qytetar – Kur do ta kuptojnë se mund të marrin pjesë në krijimin dhe marrjen e politikave me interes për bashkësinë e tyre, ata fitojnë impuls dhe kapacitet të ri për participim të ri qytetar në çdo kohë.

Këto teza ndihmojnë që ta kuptojmë kulturën politike në Maqedoni në raport me aktivizmin qytetar, përkatësisht na çojnë drejt konkluzioneve se qytetarët nuk janë shumë aktivë, gjë që është karakteristike e kulturave parohiale dhe nënshtetësore, se raportet padron-klient janë shumë të pranishme, ndërkohë që pushtetet “dërgojnë aq demokraci sa kërkohet prej tyre“, me qëllim krijimin e pasqyrës së participacionit.

Situata e tillë nuk është e thënë të shikohet në mënyrë pesimiste. Përkundrazi, kjo është një start dhe motivim i mirë për përhapjen e idesë për domosdoshmëri nga pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në jetën e bashkësisë së tyre.

Zarko Trajanoski

LUFTA PËR TË DREJTAT SEKSUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË: SI U BËNË TË PADUKSHMIT TË DUKSHËM DHE TË ZËSHËM



Lufta për t'i gëzuar njësoj të gjitha të drejtat e njeriut nga ana e të gjithëve është e pamundur pa shoqëri të organizuar qytetare. Në këtë studim rasti do të orvatemi të tregojmë se çfarë rolesh kanë luajtur organizatat civile në luftën për të drejtat e njeriut të njerëzve LGBTI në Republikën e Maqedonisë.

Para 12 vitesh në Republikën e Maqedonisë nuk kishte asnjë organizatë që në mënyrë aktive luftonte për promovimin e të drejtave LGBTI si të drejta të njeriut. Nuk kishte bashkësi të dukshme LGBTI, ndërsa homoseksualiteti dhe të drejtat seksuale ishin ende tabu-temë në shoqërinë postkonfliktuale të Maqedonisë. Sot lirisht mund të themi se ekziston shoqëri e dukshme dhe e organizuar, e cila lufton jo vetëm për promovimin, por edhe për mbrojtjen e të drejtave seksuale të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor.

Shoqëria qytetare për të drejta seksuale ishte iniciuar nga një organizatë tipike „watchdog“ – Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, e cila i realizoi hulumtimet e para që u shfrytëzuan për hapjen e debatit publik për detabuizimin e homoseksualitetit. Hulumtimi e nxiti krijimin e organizatës së parë për të drejta seksuale, e cila kishte rol edhe si furnizues shërbimesh (mbështetje psiko-sociale dhe këshilla ligjore), edhe si promotor i diversitetit seksual, edhe si iniciator i parë për ndryshime ligjore. Sot kemi një shumësi organizatash që janë të bashkuara nën një ombrellë të përbashkët - „Rrjet nacional për luftë kundër homofobisë dhe transfobisë“,¹ që luan rol reprezentativ dhe përfaqësues të LGBTI- shoqërisë në Republikën e Maqedonisë.

Në këtë paraqitje të shkurtër historike do t'i tregojmë sukseset, pengesat, humbjet dhe sfidat kyç të aktivistë(e)ve qytetarë për të drejta LGBTI. Në fillim, lufta bëhej për njohjen dhe promovimin e të drejtave seksuale, dhe ajo luftë ende nuk ka mbaruar. Sot, gaca kryesore e luftës është mbrojtja institucionale nga dhuna, nga diskriminimi dhe nga gjuha e urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor.

Në fillim ishte - hulumtimi

Në verën e vitit 2002 në Republikën e Maqedonisë u bë hulumtimi „Kufijtë e lirisë dhe të zgjedhjes: homoseksualiteti në Republikën e Maqedonisë“ nga ana e Qendrës për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konflikeve dhe Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë. Pikërisht ky hulumtim ishte nxitje jo vetëm për hapjen e debatit publik për homoseksualitetin në Republikën e Maqedonisë,² por edhe për organizimin qytetar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave seksuale si të drejta të njeriut.

¹ Rrjeti nacional për luftë kundër homofobisë dhe transfobisë, <http://www.lgbtimreza.org/>

² „Do të hulumtohen bashkësitë homoseksuale në Maqedoni“, „Dnevnik“, 8.7.2002, „Të stigmatizuar për shkak se janë më ndryshe“, „Kapital“, 28.11.2002. „Homoseksualët maqedonas ëndërojnë të puthen në rrugë“, „Dnevnik“, 22.1.2003.

Në fillim të vitit 2003 homoseksualiteti konsiderohej tabu-temë, ndërsa ende nuk kishte organizatë që do t'i promovojë të drejtat e njeriut për LGBTI-njerëzit. Punët shpejtë ndryshuan me formimin e „Qendrës për të Drejta Qytetare dhe të Njeriut“ në Shkup, e cila hapi këshillimore për ndihmë dhe mbështetje psiko-sociale. Për herë të parë në Maqedoni mediat filluan t'i hapin çështjet rreth stigmatizimit, diskriminimit dhe dhunës familjare të nxitur nga paragjykimet se homoseksualiteti është sëmundje.³ „Qendra për të Drejta Qytetare dhe të Njeriut“ e organizoi konferencën e parë nacionale për të drejtat e homoseksualëve, e paralajmëroi iniciativën e parë qytetare për ndryshime ligjore⁴ dhe debatin e parë publik „Përballu me diversitetin“.⁵ Në media filluan të paraqiten komente që i inkurajuan homoseksualët që „publikisht të flasin për vetveten, sepse vetëm ashtu do ta tregojnë guximin dhe vendosmërinë e tyre për të luftuar për të drejtën e tyre, tani për tani 'të papushtuar'“.⁶

Fushata kontroverze „Përballu me diversitetin“

Fushata e parë publike „billbord“ për promovimin e të drejtave të pakicave seksuale shkaktoi kontroverze të mëdha jo vetëm në Maqedoni, por edhe në SHBA. Disa muaj pasi që u vunë billbordet, revista „National Review“ publikoi një shkrim kritik ku e akuzoi Ambasadën amerikane në Maqedoni se „i shfrytëzon dollarët e tatimpaguesve të SHBA-ve për të ngritur billborde që promovojnë agjendë homoseksuale“.⁷ Në shkrim ishte publikuar edhe reagimi i kryetarit të Republikës së Maqedonisë, i cili pati deklaruar se „U.S. taxpayer funds should not be used to promote alternative lifestyles in my country...“⁸ dhe se fushata është „deeply offensive to most people in Macedonia which represents a very conservative mix of the Orthodox Christian and Muslim faiths“.⁹ Kryetari u akuzua nga Qendra për të Drejta Qytetare dhe të Njeriut (QDQNJ) dhe nga mediat se përhap homofobi dhe se nuk i paraqet interesat e të gjithë qytetarëve.¹⁰

Në vigjilje të zgjedhjeve presidenciale, Qendra për të Drejta Qytetare dhe të Njeriut publikisht i ftoi kandidatët presidencialë që të deklarohen për të drejtat e pakicave seksuale, por një kërkesë e tillë hasi në heshtje nga ana e kandidatëve.¹¹ Lufta institucionale kundër diskriminimit në bazë të orientimit seksual filloi me iniciativën para Gjykatës Kushtetuese, me të cilën u kontestua neni

³ „Homoseksualët maqedonas jetojnë në frikë të vazhdueshme nga gjykimi publik“, „Dnevnik“, 6.8.2003.

⁴ Shihni „Fshirje të dënimeve për homoseksualët maqedonas“, „Dnevnik“, 3.12.2003.

⁵ „Homoseksualët maqedonas e ngritën zërin“, „Dnevnik“, 5.8.2003

⁶ Dragi Jankovski, „Homoseksualët duhet ta udhëheqin betejën e tyre“, „Dnevnik“, 6. 8.2003.

⁷ Diplomatic Missteps, JANUARY 6, 2004, <http://www.nationalreview.com/articles/209033/diplomatic-missteps/kerri-houston>

⁸ „Paratë e tatimpaguesve amerikanë nuk duhet të shfrytëzohen që të promovohen stile jetësore alternative në shtetin tim“

⁹ „Thellë ofenduese për pjesën më të madhe të njerëzve në Maqedoni, që paraqet përbërje shumë konservative të fesë së krishterë ortodokse dhe myslimane.“ Zëdhënësi i Stejt Departamentit deklaroi se ambasada nuk ka dhënë leje që të përdoret vula e saj në bilborde, por dhe se projekti që është përkrahur nga SHBA kundër diskriminimit mbi pakicat ka qenë konzistent me politikën e tyre për përkrahje të tolerancës dhe të dinjitetit njerëzor. „U.S. rebukes gay rights group in Macedonia“, 10.1.2004, <http://www.advocate.com/news/2004/01/10/us-rebukes-gay-rights-group-macedonia-10944>

¹⁰ Shihni: „Trajkovski ka frikë nga homoseksualët“, „Dnevnik“, 19.1.2004, „Kur Trajkovski do të ballafaqohet me realitetin“, „Dnevnik“, 19.1.2004, „Trajkovski i ofendoi homoseksualët“, „Utrinski vesnik“, 20.1.2004.

¹¹ „Kandidatët nuk i komentojnë homoseksualët“, „Vest“, 4.7.2004.

nga Ligji për shërbim në ARM, sipas të cilit pjesëtari i ARM mund të thirret në përgjegjësi disiplinore, me mundësi që ta humbë vendin e punës, vetëm sepse është homoseksual.¹² Edhe pse Gjykata Kushtetuese nuk ngriti procedurë, më vonë Ministria e Mbrojtjes propozoi ndryshime në Ligjin për shërbim në ARM, me qëllim që të sigurojë trajtim të barabartë mes heteroseksualëve dhe homoseksualëve.¹³ Ky ishte ndryshimi ligjor i parë i realizuar.

Qendra për të Drejta Qytetare dhe të Njeriut do të mbahet mend edhe prej organizimit të ngjarjeve të para kulturore, siç është festivali i parë i filmit „Суница“ (Ylberi).¹⁴ Më vonë, kjo organizatë filloi të publikojë edhe magazinën e parë kushtuar bashkësisë LGBTI „Hello“.¹⁵

„Coming out“ i lëvizjes LGBTI

Lufta për të drejta seksuale në Republikën e Maqedonisë kaloi në nivel më të lartë me formimin e „AMOSL“ – Asociacionit Maqedonas për Orientim të Lirë Seksual. Lideri i AMOSL, Koço Andonovski, i pari bëri „coming out“ si gej dhe filloi të jepte intervista për mediat.¹⁶ AMOSL (në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë) bëri anketa dhe hulumtime të reja¹⁷ dhe u dërgoi pyetësor partive politike. Dukja e AMOSL nxiti gjykim publik për homoseksualitetin nga ana e personave kishtarë (si „mëkat vdekjeprurës“ dhe si „mëkat kundër natyrës“¹⁸) dhe nga disa sociologë (si „dukuri sociale deviante“)¹⁹.

Megjithatë, më shumë kontroverse në opinion shkaktoi iniciativa e AMOSL për nxjerrjen e ligjit për regjistrimin e partneriteteve të një gjinie, që fillimisht u përkrah nga disa socialdemokratë dhe liberalë.²⁰ Disa media e paraqitën në mënyrë të gabuar iniciativën ligjore, duke deklaruar se „homoseksualët maqedonas kërkojnë të drejtën për martesë“.²¹

¹² „Homoseksualët të padëshiruar në ARM, pohon OJQ“, „Utrinski Vesnik“, 2.6.2004.

¹³ „Rrënim tabush në Mbrojtje: Edhe homoseksualët me punë në ARM“, „Vest“, 1.12.2005.

¹⁴ „Revistë gej-filmash, më pas dhe zbavitje“, „Vest“, 10.8.2004. Organizimin e festivalit të filmit „Xunica“ (Ylberi) më vonë e ndërmori shoqata „Egal“ (Shih: „Festival i gej-filmave“, „Dnevnik“, 15.5.2006).

¹⁵ „Doli magazina e parë për homo-, bi- dhe transseksualë në Maqedoni“, „Vest“, 8.3.2006.

¹⁶ „Homoseksualët i kërkojnë të drejtat e tyre“, „Vreme“, 12.2.2005.

¹⁷ „Seksualiteti diskriminon 200.000 njerëz në Maqedoni“, „Dnevnik“, 20.4.2005.

¹⁸ „Burracungëria apo siç e quajnë me popullaritet homoseksualizmi është një gjë e kundërnaturshme dhe apostulli i shenjtë Pavle thotë se për burracungët nuk ka shpëtim. Ky është qëndrim i Librit të Shenjtë, i Kishës në përgjithësi. Njerëzit e këtitillë nuk mund të banojnë mbretërinë qiellore, për shkak se janë të dënuar prej Zotit si aktorë të kundërnaturshëm të kurvërisë. Normalisht, Kisha nuk thotë se kurvat nuk janë mëkatore, por ato bëjnë mëkat të natyrshëm, ndërsa burracungët apo gracungtat bëjnë mëkat të kundërnaturshëm, për shkak se natyra nuk i ka krijuar që të komunikojnë njëgjinihëm.“ („KOM nuk guxon t'i ikë ofertës së patriarkut të gjithësisë, intervistë me mitropolitin e Prespës-Pellagonisë, z. Petar“, „Utrinski vesnik“, 30.4.2005).

¹⁹ „Homoseksualët në Maqedoni bëjnë jetë të dyfishtë“, „Utrinski vesnik“, 21.4.2005.

²⁰ „Socialdemokratët, përkrahësit më të mëdhenj të homoseksualëve“, „Vest“, 7.2.2005; „Homoseksualët do të hyjnë në programin zgjedhor të socialdemokratëve“, „Utrinski vesnik“, 7.9.2005.

²¹ „Homoseksualët maqedonas kërkojnë të drejtën për martesë“, „Dnevnik“, 2.7.2005; „MASSO kërkon legalizimin e martesave homoseksuale“, Makfaks, 1.10.2005.

Iniciativa ligjore shkaktoi reagime të vullshme partiake. Iniciativa u vlerësua si “e panatyrshme” dhe “kalë i Trojës”²² nga ana e VMRO-DPMNE, ndërsa martesat homoseksuale u paraqitën si “të rrezikshme”.²³ Edhe përfaqësuesit e BDI-së theksuan se nuk do ta përkrahin ligjin, për shkak se “nuk mund të përkrahin diçka që është në kundërshtim me ligjet e natyrës”.²⁴ VMRO-Popullore paralajmëroi se në rast se propozim-ligji për “bashkësi njëgjimore” kalon në Kuvend, “kjo do të tërheqë hapjen e proceseve për legalizimin e poligamisë, poliandrisë, prostitucionit dhe përdorimit të drogave”.²⁵ Edhe LSDM “jozyrtarisht” u pajtua kundër ligjësismit të martesave homoseksuale dhe adoptimit të fëmijëve.²⁶ Vetëm kryetari i qytetit të Shkupit e vlerësoi iniciativën si hap përpara.²⁷

Edhe iniciativa dhe ngjarje të tjera të AMOSL shpeshherë u paraqitën në mënyrë të gabuar nga ana e mediave. Për shembull, lajmërimi për manifestimin e organizuar nga AMOSL “Dashuria është Dashuri” nga mediat u paralajmërua si “Gej-paradë në Shkup”.²⁸ Në këtë manifestim u promovua edhe iniciativa “në pakon e ndryshimeve kushtetuese të futet edhe dispozita me të cilën do të garantohet jodiskriminimi i çfarëdo lloji”.²⁹ Përpjekja që të organizohet një ngjarje publike në qendër të Shkupit u pengua nga pushtetet lokale.³⁰

²² VMRO-DPMNE kundërshtoi iniciativën për nxjerrjen e ligjit për partneritete të regjistruara. Kjo iniciativë, e cila për fat të keq ishte përkrahur edhe nga LSDM, është kalë troje për qytetarët tanë – sekretari i përgjithshëm i VMRO-DPMNE, Gordana Jankullovska (“VMRO-DPMNE është kundër martesës midis homoseksualëve”, „Utrinski vesnik“, 31.10.2005)

²³ „Si parti demokristere, edhe më shumë jemi të bindur në faktin se kjo iniciativë është e panatyrshme, për shkak se legalizimi i raportit të personave të së njëjtës gjini, duke kështu dhe poligaminë, është aktivitet i pashembullt për racën njerëzore – tha Gordana Jankullovska, sekretare e përgjithshme e partisë, në konferencën e mbërmëshme për shtyp” (“Martesat homoseksuale, të rrezikshme”, „Dnevnik“, 31.10.2005).

²⁴ „Për kishën mëkat, për partitë rejting“, „Dnevnik“, 1.11.2005.

²⁵ „Bashkësitë Fetare ta gjykojnë propozim-ligjin për homoseksualët“, „Utrinski vesnik“, 4.11.2005. MASSO publikisht e gjykoi konferencën homofobike për shtyp dhe kërkoi që sa më shpejt të nxirret legjislacioni kundërdiskriminator. („Reagim i MASSO-s me rastin e konferencës për shtyp të VMRO-PP“, Makfaks, 4.11.2005).

²⁶ „Rreth çështjes së Propozim-ligjit për regjistrim të partneritetit, në LSDM zyrtarisht asnjëherë nuk kanë biseduar organet partiake, ndërsa mendimet jozyrtare në parti janë qartë kundër legalizimit të martesave homoseksuale dhe kundër adoptimit të fëmijëve“, thuhet në komunikatën për shtyp të kësaj partie. („Sa vota sjellin homoseksualët?“, „Veçer“, 1.11.2005).

²⁷ „Ajo që bëjnë tani homoseksualët, është hap përpara në realizimin e të drejtave të tyre“, deklaroi mbërmë kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski, duke komentuar Propozim-ligjin për regjistrimin e partneriteteve, të cilin e propozoi Asociacioni Maqedonas për Orientim të Lirë Seksual (“Propozimi për të drejtat e homoseksualëve është hap përpara”, „Utrinski vesnik“, 2.11.2005).

²⁸ „Gej-‘parada’ e parë në Shkup“, „Veçer“, „Gej-parada në Shkup“, Makfaks, 1.9.2005.

²⁹ „Homoseksualët maqedonas kërkojnë trajtim kushtetues më ndryshe“, „Utrinski vesnik“, 14.10.2005. „Gjatë kohës së debatit publik për ndryshim në Kushtetutë, kërkua që në nenin 9 të futet edhe ndalesa për diskriminim mbi bazë të orientimit seksual. Morëm shpjegimin se Kushtetuta ‘nënkupton’ sanksionim të diskriminimit të tillë dhe se nuk ka nevojë që në të të ketë dispozitë ‘orientim seksual’. Nëse Kushtetuta nënkupton edhe të drejtën për përcaktim seksual, atëherë nënkupton edhe të drejtën për bashkësi martesore të së njëjtës gjini“, thotë Andonovski. Ligji ekzistues për martesë dhe familje njih vetëm bashkësinë martesore heteroseksuale” („Homoseksualët para zyrës së gjendjes civile“, „Dnevnik“, 29.10.2005).

³⁰ Shihni „Allarova është akuzuar se ka penguar zbatimin e MASSO-s“, „Vreme“, 2.10.2007.

AMOSL vazhdoi të kërkojë përkrahje politike³¹ nëpërmjet fushatës për ngritjen e vetëdijes (nën moton “Gej-liritë për të drejtat e njeriut”), me shënimin e datave të rëndësishme,³² por dhe me dokumentimin e rasteve të lëndimit të të drejtave të njeriut. Për shembull, qëkur AMOSL publikoi rastin e trajtimit mjekësor të homoseksualitetit me terapi hormonale, vijoi apeli publik nga përfaqësuesit e Shoqërisë së Psikiatërve “drejtuar gjithë psikiatërve që mos të kyçen në trajtimin e diçkasë që nuk është sëmundje”.³³ Pyetja për përkrahje politike të bashkësisë LGBTI ishte temë e nxehtë mediatike edhe gjatë fushatës parazgjedhore në vitin 2006, e pikëpyetja e AMOSL u keqpërdor nga ana e mediave³⁴ dhe nga ana e partive konservatore për fushatë homofobike.³⁵

Gjithashtu, AMOSL i hyri monitorimit të procesit të afrimit kah BE, në aspektin e obligimeve për luftë kundër diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual.³⁶ AMOSL publikisht ka treguar raste të diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual³⁷ dhe ka bërë apel direkt për nxjerrjen sa më të shpejtë të një ligji gjithëpërfshirës për mbrojtje nga diskriminimi.³⁸

Një nga temat e nxehta që hapi AMOSL ishte diskriminimi në arsim dhe nëpër libra.³⁹ AMOSL filloi të organizojë tribuna publike për studentë në fakultete të caktuara⁴⁰ dhe publikisht tregoi për nevojën e përfshirjes së arsimit për shëndet seksual nëpër shkollat maqedonase.

Lufta për ligj gjithëpërfshirës për mbrojtje nga diskriminimi

Me shuarjen e AMOSL nuk u shua edhe aktivizmi për të drejtat dhe liritë seksuale.

Pas debatit me temë “Pozicioni i faktorëve relevantë rreth diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual”, në organizim të Qendrës për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve para fillimit të fushatës zgjedhore në vitin 2009, u dëgjuan edhe kandidatët për kryetar shteti. Kandidati i VMRO-DPMNE, Gjorge Ivanov, dha deklaratën në vijim: “Sistemi ynë nuk diskriminon askënd. Homoseksualët vetë stigmatizohen dhe mendojnë se janë në pozicion të nënshtuar.”⁴¹

Në këtë periudhë, Koalicioni për të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore për Bashkësitë e Margjinalizuara (në vazhdim: Koalicioni) filloi të publikojë reagime publike dhe raporte për të drejtat

³¹ „Vetëm Petkovski i përkrah homoseksualët“, „Vreme“, 16.5.2006.

³² „Dita kundër homofobisë – shënim edhe në Maqedoni“, Makfaks, 7.5.2006.

³³ „Psikiatrat mos t'i shërojnë homoseksualët me barna“, „Utrinski vesnik“, 3.2.2006.

³⁴ Për shembull, „Partitë e majta i mbështesin gej-martestat“, „Vest“, 13.6.2006.

³⁵ Shihni „Jo! për homoseksualët, prostitucionin dhe drogat e lehta“, „Utrinski vesnik“, 22.3.2006.

³⁶ „Luftëtarët për liri seksuale e 'kallëzuan' Qeverinë te Kjarini“, „Veçer“, 10.3.2005.

³⁷ „Njëzet raste të diskriminimit për shkak të orientimit seksual, prej të cilave vetëm dy kanë regjistruar procedurë ligjore, ka shënuar Asociacioni Maqedonas për Orientim Seksual të Lirë (AMOSL) vitin e kaluar.“ („AMOSL sheh homofobi te Qeveria“, „Dnevnik“, 8.2.2008).

³⁸ „AMOSL kërkon nxjerrjen e ligjit për jodiskriminim“, „Utrinski vesnik“, 8.2.2008.

³⁹ „Profesorë të njohur përhapin homofobi nëpër libra“, „Vreme“, 3.2.2007.

⁴⁰ Në Fakultetin Filozofik u organizua punëtorja me temë “Politika gjinore dhe seksuale”, ndërsa debati dyditor me titullin “Sfidat në implementimin e parimeve të jodiskriminimit” u mbajt në Akademinë e Policisë – Shkup. (Shihni “Transseksuali i mëson policët e ardhshëm që mos të jenë homofobikë”, „Dnevnik“, 17.5.2008).

⁴¹ Petre Ristovski, „Homofobi, stop!“, „Shpic“, 10.2.2009.

seksuale të personave LGBTI. Gjatë promovimit të raportit të parë vjetor, Koalicioni lypj nga kryetari Ivanov që publikisht të kërkonte falje për ofendimin se “homoseksualët vetë stigmatizohen”.⁴²

Ngjarje me rëndësi për aktivizmin LGBTI është organizimi i “Marshit për tolerancë” më 16.11.2009, kur për herë të parë u valëvit flamuri me ylber. Ky marsh, që paraprakisht u paralajmërua në mënyrë sensacionale si “gej-paradë”, u prit me protestë homofobike nga aktivistë partiakë të “Forcave të Majta Titiste”.⁴³ Ky incident tregoi se homofobia nuk është e pranishme vetëm tek e djathta konservatore, por edhe tek e majta konservatore.

Ngjarje mobilizuese me rëndësi për aktivistët për të drejta seksuale ishte fshirja e “orientimit seksual” si bazë për diskriminim nga ana e Qeverisë gjatë nxjerrjes së propozim-ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.⁴⁴ Përfaqësues të Koalicionit menjëherë dëftuan jokonzistencën, për shkak se shprehja “orientim seksual” veç më ekziston në Ligjin për të drejtat e pacientëve dhe në Ligjin për vullnetarizëm, ndërsa te Ligji për marrëdhënie pune ekziston dispozita “drejtimi gjinor”.⁴⁵ Gjithashtu, akti i fshirjes u vlerësua si nxitje të diskriminimit,⁴⁶ ndërsa u zbulua edhe manipulimi mediatik-politik se me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi do të mundësoheshka legalizimi i martesave të një gjinie.⁴⁷ Koalicioni mernte pjesë edhe nëpër dëgjime publike ekspertësh, ku u kërkua përfshirja e orientimit seksual si bazë e diskriminimit.⁴⁸ Koalicioni kërkoi dhe mori përkrahje për përfshirjen e “orientimit seksual” në ligj nga ana e organizatave të shumta joqeveritare të brendshme dhe ndërnacionale.⁴⁹

⁴² „Koalicioni shpreson se presidenti aktual i Republikës së Maqedonisë publikisht do të kërkojë falje për ofendimin – homoseksualët vetë stigmatizohen – dhe se do të angazhohet për ndërtimin e sistemit efikas për mbrojtjen nga stigma dhe diskriminimi i pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara, me të cilën gjë në mënyrën më të mirë do të tregojë se është president *një për të gjithë*”, tha Zharko Trajanovski. (“Ivanovi t’u kërkojë falje homoseksualëve”, A1, 5.11.2009).

⁴³ „Ua, pederë’ dhe ‘ua, lezbike’ – nuk duam gej-paradë – thërrisin Forcat e Majta Titiste, partia e Sllobodan Ugrinovskit, të cilët ende pa filluar, e gjykuan marshin me rastin e Ditës ndërkombëtare të tolerancës. Nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut thonë se marshi i tyre nuk është kurrfarë gej-parade, por një ‘jo’ e madhe për urrejtjen, diskriminimin dhe dhunën.” (“Marshi civil për tolerancën”, A1, 16.11.2009).

⁴⁴ „Fshirjen e ‘orientimit seksual’ si bazë për diskriminim Qeveria e bëri në seancën e fundit, edhe pse ekzistimi i deklaratës së këtyllë aspak nuk ka qenë kontestues në versionet e punës së ligjit, i cili është shumë i rëndësishëm në përmbyshjen e kushteve për eurointegrimin e vendit.” (“Të orientuar kah diskriminimi seksual”, “Dnevnik”, 29.1.2010).

⁴⁵ „Apo është kontradiktore në një ligj të lejohet përdorimi, e në tjetër të fshihet – pyetet Sllavço Dimitrov.” („Të orientuar kah diskriminimi seksual”, “Dnevnik”, 29.1.2010).

⁴⁶ Zharko Trajanovski: „Paradoksale te ky ligj është se në vend që të pengojë diskriminimin dhe homofobinë, ai keqpërdoret si instrument për nxitjen e tyre.” („BE nuk do diskriminator seksual”, “Vreme”, 10.4.2010).

⁴⁷ Sllavço Dimitrov: „Lypet arsyetim se homoseksualët do të kërkojnë martesë, por ky ligj nuk ka lidhje me atë dhe është pafytyrësi të manipulohet me qëndrime të tilla populistike. Ky ligj është qartë i definuar se çfarë do të thotë, çfarë përfaqëson dhe çfarë rregullon.” („Ligj për mbrojtje nga diskriminimi apo për homofobi?”, “Utrinski vesnik”, 2.2.2010).

⁴⁸ „‘Orientimi seksual’ të përfshihet në Ligjin për antidiskriminim, si një nga bazat për diskriminim, përfunduan sot ekspertët e Fakultetit Juridik.” (“Orientimi seksual” të përfshihet në Ligjin për antidiskriminim, Makfaks, 5.3.2010).

⁴⁹ Pas bisedimeve me QMBN (MLQMC), Qendrën për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konfliktëve, Komitetin e Helsinkit etj., bashkë u vendos për „Kërkesë drejtuar Qeverisë së Republikës së Maqedonisë si propozues i Ligjit për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilën e nënshkruan rreth pesëdhjetë shoqata civile. Kërkesa hasi në mbështetje edhe nga “ILGA-Evropa”, “Hjuman rajts voç” dhe grupi i euro-parlamentarëve.

Si rezultat i lobimit të Koalicionit për përfshirjen e orientimit seksual si bazë për diskriminim, një grup nga 28 deputetë të LSDM, PLD, PL, Alternativa e Re dhe Demokracia e Re paraqitën Propozim-ligjin për mbrojtje dhe ndalimin e diskriminimit, që u përfaqësua nga eksperti dr. Mirijana Najçevska. Koalicioni publikisht reagoi edhe kundër gjuhës së urrejtjes homofobike nga ana e deputetëve gjatë debatit në komisione për ligjin në Kuvend.⁵⁰ Fushata homofobike e arriti fundin kur deputeti i partisë në pushtet, “shkencërisht” dhe “sipas medicinës” e diagnostikoi interseksualizmin si “gjendje patologjike” që duhet shëruar, transvesticionin si “formë e butë e shprishjes psikike”, transeksualizmin si “shprishje shumë e rëndë psikike”, që në fund të përfundojë se “homoseksualizmi është sëmundje që duhet shëruar”. Pas debatit homofobik rreth Ligjit për mbrojtje dhe pengim të diskriminimit u pranua amendamenti me të cilin u ridefinua familja si “bashkësi e gjinive të kundërta, përkatësisht të një burri dhe të një gruaje”.

Nxjerrja e Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi pa “orientim seksual” të pranuar, mund të llogaritet si një nga disfatat kryesore të shoqërisë qytetare në Republikën e Maqedonisë. Padrejtësia ende nuk është përmirësuar dhe njohja eksplicite e orientimit seksual si bazë ligjore për diskriminim vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të lëvizjes për të drejta LGBTI.

Lufta kundër homofobisë në arsim

Lufta kundër homofobisë në arsim u bë e dukshme atëherë kur Koalicioni filloi që t’i studiojë dhe t’i rishqyrtojë përmbajtjet homofobike nëpër librat e arsimit të mesëm dhe të lartë.⁵¹ Në vitin 2011 u shpall analiza ekspertore e disa librave, që ishte shkas që në raportin e KE për vitin 2011 të dëftohet se “Librat universitarë dhe të shkollave të mesme e trajtojnë homoseksualitetin si sëmundje”. Pas ankimit nga ana e Koalicionit, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi në vitin 2011 vërtetoi diskriminim në librin e “Pedagogjisë”, në pjesën ku homoseksualiteti ishte numëruar në mesin e “dukurive negative të jetës seksuale të njeriut”, ku “homoseksualiteti dhe lejbekëria” ishin paraqitur si “ligësi”, ndërsa “pjesëmarrësit në atë lloj ligësie ... me jetë seksuale jonatyrale dhe jonormale” ishin përshkruar si “persona me probleme dhe pengesa psikike”.⁵² Këto përmbajtje u përjashtuan në edicionin e ri të librit.

Pas edhe një ankese kundër librave “Psikologjia medicinale” dhe “Psikiatria, vëllimi 1 dhe vëllimi 2”, përkrahur nga Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi në mendimin e vet nga viti 2014 vërtetoi se ekziston shqetësim mbi bazë të orientimit seksual⁵³ dhe rekomandoi të fshihen dhe të largohen nga përdorimi pjesët homofobike nga këto tre libra, për të cilët edhe vetë autorët pranuan se janë bërë gabime.

Këto fitore të vogla kundër autorëve dhe librave homofobikë janë inkurajim për aktivistë(e)t qytetarë që ta vazhdojnë luftën për arsim johomofobik dhe inkudrimin e arsimit seksual gjithëpërfshirës.

⁵⁰ Shihni „Homoseksualët, viktimë e gjuhës së urrejtjes“, “Vreme”, 24.3.2010.

⁵¹ Shihni „Homofobia ka hyrë thellë në sistemin arsimor“, Makfaks, 7.5.2010.

⁵² Zharko Trajanoski: “Në Maqedoni homoseksualiteti ende trajtohet si sëmundje!“, “Plusinfo”, 17.5.2013.

⁵³ „Në tre libra në Fakultetin e Mjekësisë – orientim mbi bazë të orientimit seksual“, Nova, 7.5.2014.

Lufta kundër gjuhës së urrejtjes dhe jotolerancës

Një nga sfidat kryesore në luftën për barazi seksuale është gjuha e urrejtjes mbi bazë të orientimit seksual, e cila është e dukshme në jetën publike dhe politike. Duke e adresuar nevojën për gjykim publik të gjuhës së urrejtjes dhe jotolerancës ndaj grupeve të marginalizuara, më 17.5.2012 Koalicioni mbajti një debat publik në Komisionin kuvendor për mundësi të barabarta. Në kuadër të debatit u tha se mungesa e vullnetit politik për të njohur, për të respektuar dhe për të mbrojtur personat LGBTI është një nga shkaqet përse Maqedonia gjendet në fundin e listës së shteteve në hartën e “ILGA Evropa”. Më 17.7.2012 deputeti Ivon Veliçkovski i dorëzoi Kuvendit “Propozim-deklaratë për gjykimin e gjuhës së urrejtjes” (të përgatitur dhe të promovuar në bashkëpunim me Koalicionin), por kjo kurrë nuk u gjend në rend të ditës.⁵⁴

Në periudhën e njëjtë Qeveria dhe mediat pro-qeveritare filluan fushatën homofobike kundër “martesave të një gjinie”, duke e keqpërdorur iniciativën e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për kontestim kushtetues të nenit nga Ligji për familje, ku “marrëdhënie të afërta personale” definohej si “marrëdhënie personale në mes personave të gjinive të ndryshme”. Një ditë pas dorëzimit të iniciativës, në ditarin qendror të TV Sitel është emetuar kontributi “Me fushatë, homoseksualët kërkojnë martesë të një gjinie”, ku promovohet qëndrimi se “homoseksualëve iu nevojitet ndihmë profesionale, medicinale, e jo ligjore”.⁵⁵ Fushata homofobike me temë “martesa të një gjinie” vazhdoi më 12.10.2012, kur ministri kompetent për luftë kundër diskriminimit (ministri i Punës dhe Politikës Sociale) filloi të japë deklarata diskriminuese për “çështjen që çifteve homoseksuale t’u lejohet të adoptojnë fëmijë”, duke e promovuar konceptin “komb i shëndoshë” dhe “fëmijë të shëndoshë në mjedis të shëndoshë natyror”.

Në pjesëmarrjen në TV Sitel, ministri u pyet se “a ka mundësi që të përfshihen martesë të një gjinie në Republikën e Maqedonisë, t’u jepet mundësia të adoptojnë fëmijë, e në pajtim me këtë, ndoshta, të legalizojmë edhe incestin, edhe pedofilinë, edhe poligaminë, siç është kështu në disa shtete të tjera, apo gjithçka do të jetë ashtu siç ka qenë?”, ku u përgjigj negativisht. Më pas vijoi TV-kontributi “Qytetarët dhe institucionet janë kundër martesave gej”.

Pasi që më shumë shoqata reagues publikisht, duke dëftuar deklarata diskriminuese mbi më shumë baza, kryetari i Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi e mbrojti ministrin e vet duke pohuar se deklarata e tij “nuk ka as gjuhë të urrejtjes, e as që bëhet fjalë për diskriminim”. Në të njëjtën kohë, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi u bë i shurdhër ndaj fushatës homofobike të gazetës “Veçer”, e cila katër ditë me radhë në ballinë publikonte përmbajtje sensacionale diskriminuese, ku homoseksualiteti barazohet me pornografinë, me poligaminë dhe me pedofilinë. Në fushatën sistematike homofobike nuk u kyçën vetëm mediat pro-qeveritare, por edhe persona publik, ekspertë dhe disa shoqata pro-qeveritare qytetarësh. Për shembull, Kongresi Botëror Maqedonas publikisht tha se “i përjashton martesat homoseksuale, incestin, poligaminë dhe

⁵⁴ Me 26 vota PËR, dhe 45 vota KUNDËR, që propozimi të vihet si pikë e rendit të ditës nuk u pranua.

⁵⁵ Nga ankesa nga ana e Koalicionit, Këshilli i Radiodifuzionit shqiptoi vërejtje me shkrim për TV Sitel, me arsyetimin se nëpërmjet stigmatizimit dhe etiketimit kryhet diskriminim dhe përhapet homofobia.

pedofilinë dhe iniciativat që çojnë kah legalizimi i tyre”. Fushata homofobike kulminoi me deklaratat e ministres së Punëve të Brendshme dhe të kryeministrit kundër adoptimit të fëmijëve në “martesa të një gjinie”.⁵⁶

Edhe krahas asaj që disa organizata⁵⁷ bënë parashtrësë kundër ministrit të Punës dhe të Politikës Sociale në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, ato hasën në heshtje të plotë administrative.

Nga gjuha e urrejtjes deri te dhuna eksplicite

Fushata politike kundër martesave homoseksuale, e cila vijoi me gjuhë të urrejtjes dhe të jotolerancës në media dhe nëpër rrjetet sociale, aspak nuk i dekurajoi aktivistët për të drejta-LGBTI. Përkundrazi, fuqia, ashpërsia dhe vazhdimësia e fushatës negative, e udhëhequr nga partia qeverisëse dhe të dëgjueshmit e saj mediatik, kontribuan për mobilizim, vetorganizim dhe dukje më të madhe të aktivistëve për të drejta-LGBTI. Për shembull, në fillim të korrikut të vitit 2012, dhjetëra aktivistë nga organizata e re e formuar, “LGBTI Junajted”, u fotografuan para fontanës “Ushdari mbi kalë” me flamurin e ylberit (simbol i bashkësisë LGBTI) dhe me mbishkrime “gej”, “lezbike”, “biseksuale”, “person trans-gjinor”. Fotografitë, të titulluara “gej-parada e vogël”, u gjetën në më shumë medime dhe shkaktuan gjuhë të urrejtjes dhe kërcënime të hapura për dhunë. Edhe pse kërcënimet për jetë u paraqitën në polici, nuk u ndërmoren kurrfarë masash kundër kërcënuesve.

Sa më shumë që LGBTI-bashkësia bëhej më e organizuar dhe më e dukshme, aq më shumë rriteshin kërcënimet, thirrjet për dhunë dhe aktet aktuale të dhunës fizike mbi aktivistët për të drejta-LGBTI. Ngjarjet më të rëndësishme për dukjen e LGBTI-bashkësisë në vitin 2012 ishin hapja e Qendrës për përkrahje të LGBTI-bashkësisë në Çarshinë e Vjetër (23 dhjetor) dhe Marshi i tolerancës në nëntor. Që të dyja ngjarjet u ndoqën me dhunë fizike. Në orët e mëngjesit, më 24.10.2012, disa orë pas hapjes së Qendrës (dhe pas fjalimit të kryeministrit kundër “martesave të një gjinie”) u thye xhami i qendrës së Komitetit të Helsinkit. Gjatë shënimit të “Ditës ndërkombëtare të tolerancës”, në sheshin qendror në Shkup u sulmuan fizikisht dy aktivistë nga ana e një personi të maskuar. Të njëjtin vit, Qendra për përkrahje të LGBTI-bashkësisë në Çarshinë e Vjetër ishte cak edhe i disa sulmeve të tjera (një përpjekje për ndezjen e Qendrës dhe një demolim të xhamave të dritareve).

Dhuna fizike nga urrejtja mbi bazë të orientimit seksual vazhdon edhe në vitin 2013. Më 20 prill të vitit 2013, disa aktivistë për të drejtat e njeriut të Koalicionit dhe të “LGBTI Junajted” u sulmuan verbalisht dhe fizikisht nga ana e një grupi personash në Manastir gjatë vënies së posterave për përkrahje të të drejtave të njeriut të LGBTI. Dhuna kulminoi në fillim të “Javës së krenarisë” (22.6.2013), kur mediat pro-qeveritare publikuan artikuj sensacional dhe nxitës se “gej-parada do

⁵⁶ „Jetojmë në një kohë kur jo vetëm që ndodh rrallë e më rrallë fëmija i dytë në familje, e ku më i treti e i katërti, por, përkundër kësaj, bëjmë debate për vlerat e shtrembuara, për martesë të një gjinie, po bile dhe adoptim të fëmijëve në ato martesë të një gjinie, për disa lloje të drejtave të grave, e pastaj të burrave, cilat prej tyre janë më të përfaqësuar në politikë apo në biznes, e derisa shpenzohemi në ato tema, neve si shtet na zhduket populli.” („Gruevski: VMRO kod historikisht i njohur i popullit maqedonas“, <http://vlada.mk/node/4747>)

⁵⁷ Nga ana e Koalicionit, HOPS, Komiteti i Helsinkit, ECCE dhe FOOM.

të marshojë nëpër rrugët e Shkupit”. Së pari, pjesëmarrësit e maskuar të të ashtuquajturës “Kontra gej-parada” (e organizuar nëpërmjet rrjeteve sociale) rrahu disa djem në afërsi të përmendores “Ushtari mbi kalë”, në qendër të Shkupit. Të njëjtën ditë, në orën 18 zyrtarisht filloi “Java e krenarisë” me promovimin e doracakut “Të drejta shëndetësore për trans-personat”, të vijuar me debat dhe projeksion të një filmi. Pjesëmarrësit në ngjarje dhe organizatorët e Koalicionit dhe nga LGBTI-qendra u sulmuan fizikisht nga një grup me disa dhjetëra persona të maskuar dhe të armatosur, të cilët në stampedo filluan të hidhnin gurë, thupra hekuri, materiale piroteknike dhe shishe xhami kah pjesëmarrësit, duke lënduar disa pjesëmarrës dhe një polic. Edhe pse policia ishte e paralajmëruar për mundësinë e organizimit të sulmit fizik, nga video-incizimet në derën e hyrjes të LGBTI-qendrës qartë shihet se zyrtarë të policisë e lëshojnë pozicionin shumë pak kohë para sulmit dhe se nuk ndërmarrin masa as për të penguar dhe për të kapur sulmuesit, as për të mbrojtur kolegë e tyre të sulmuar. Disa ditë pasi një aktor dhe aktivist i të drejtave të njeriut publikoi kolumnën ku e zbardhte orientimin e tij seksual, u mbloodhën një grup njerëzish rreth shtëpisë së tij (25.6.2013), duke kërcënuar integritetin e tij fizik dhe duke hedhur gurë kah shtëpia e tij. Aktori paraqiti edhe një hedhje guri drejt shtëpisë më 12.7.2013, e cila gjithashtu nuk është pastruar nga ana e policisë. Më herët, më 5.7.2013 është kryer edhe një sulm ndaj LGBTI-qendrës për përkrahje duke i vënë flakën objektit, kështu që Qendra ka pësuar dëm më të madh material dhe përkohësisht është mbyllur. Më vonë, LGBTI-qendra u shpërngul në një lokacion tjetër, ku i vazhdoi aktivitetet e veta të fokusuara jo vetëm në mbrojtje dhe përfaqësim, por dhe në përkrahje të bashkësisë – nëpërmjet grupit lezbik- feminist për përkrahje, grupit për përkrahjen e personave trans-gjinor, dhe grupit për përkrahjen e prindërve, familjeve dhe shokëve të LGBTI-personave.⁵⁸

Karakteristikë për sulmet fizike, të numëruara më herët, është ajo që policia dhe prokuroria deri më tani nuk kanë zbardhur asnjë rast të vetëm, edhe përkundër fletëparaqitjeve penale të dorëzuara nga viktimat. As edhe publikimi publik i incizimeve nuk kontribuoi për identifikimin dhe dënimin më të shpejtë të autorëve të tyre. As edhe apelet ndërkombëtare për shkak të “Eskalimit të sulmeve anti-LGBTI në Maqedoni”⁵⁹ nuk i nxitën pushtetet të kryejnë hetim dhe të kapin dhe të dënojnë të paktën një nga sulmuesit.

Pushtetet vazhdojnë me fushatën permanente homofobike

Në vend të luftës kundër dhunës nga urrëjtja, pushtetet e vazhduan fushatën permanente kundër martesave homoseksuale, këtë radhë të maskuar si iniciativë për “precizim të martesës” me Kushtetutë. Duke i injoruar apelet për gjykim të sulmeve homofobike, në qershor dhe korrik të vitit 2013 partia në pushtet përgatiti iniciativë kushtetuese, e cila filloi me valën e re të homofobisë në media dhe në Kuvend. Edhe pse VMRO-DPMNE në pushtet nuk mori përkrahje për iniciativën

⁵⁸ Shihni më shumë <http://www.lgbti.mk/>.

⁵⁹ Reagimi i „Amnesti” (“Urgent action, escalation in anti-lgbti attacks in Macedonia”) më 12.7.2013 dhe „Letra për Kryeministrin e Maqedonisë” nga „Human rajts voç” më 10.7.2013, si dhe reagimet e Parlamentit Evropian (për shkak të „akteve të vandalizmit” ndaj LGBTI-qendrës) dhe raporti i KE për dhunë të ritur ndaj LGBTI-personave.

⁶⁰ Në disa raste, deputeti Dragisha Miletiq theksonte se “homoseksualizmi” qenkësh sëmundje dhe insinuate se njohja e homoseksualitetit si orientim seksual çon deri në njohje të pedofilisë si orientim seksual.

kushtetuese as edhe nga partneri i koalicionit BDI, iniciativa nxiti gjuhë të urrejtjes dhe diskriminim,⁶⁰ gjë që ishte publikisht e gjykuar nga ana e LGBTI-aktivistëve.⁶¹ Fushata permanente kundër martesave homoseksuale dhe LGBTI-aktivistëve vazhdoi edhe në vitin 2014, me iniciativë të re kushtetuese për definimin jo vetëm të martesës si “bashkësi jetësore vetëm mes një gruaje dhe vetëm një burri”, por dhe të “regjistrimit të bashkësisë jashtë-martesore, apo cilësodo qoftë forme të regjistruar të partneritetit jetësor”.⁶²

Edhe kjo iniciativë kushtetuese nxiti valë të re të homofobisë në media⁶³ dhe në rrjetet sociale, por dhe rezistencë më të organizuar nga ana e LGBTI-aktivistëve, të cilët ndërkohë formuan LGBTI-rrjetin për luftë kundër homofobisë. Rrjeti u krijua si rezultat i nevojës për përgjigje të përbashkët ndaj retorikave të përforcuara homofobike dhe transfobike në diskursin publik, të cilat rezultuan me disa sulme ndaj LGBTI-qendrës për përkrahje në vitin 2012 dhe 2013, sulme ndaj LGBTI-aktivistëve dhe gjuhë të dukshme të urrejtjes nëpër hapësirë publike, veçanërisht nëpër rrjetet sociale.⁶⁴ Rrjeti u themelua nga 15 organizata, mes të cilave janë Shoqata për qasje kritike ndaj gjinisë dhe seksualitetit – Fronti subverziv Shkup, Koalicioni “Të drejta seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara”, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, LGBTI-qendra për përkrahje, Aleanca femërore, dhe H.E.R.A. – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe për hulumtim. LGBTI-rrjeti inicioi fushatën publike “Neni 3” (për futjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për diskriminim në Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi), inicioi peticion kundër ndryshimeve kushtetuese homofobike dhe u kyç në përfaqësimin aktiv dhe lobimin kundër definimit kushtetues të martesës, regjistrimit të bashkësisë jashtë-martesore dhe partneritetit jetësor.

Me formimin e LGBTI-rrjetit, u bë më intensive edhe lufta kundër dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Prej se LGBTI-aktivistët ishin edhe një herë cak i sulmit huligan nga ana e sulmuesve të maskuar të kafenesë “Damar”, LGBTI-rrjeti organizoi një seri protestash para Prokurorisë, duke kërkuar që të zgjidhen të gjitha ngjarjet e deritanishme të dhunës dhe të gjuhës së urrejtjes që nxisin dhunë.⁶⁵ Disa protesta kundër dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe heshtjes së institucioneve, të cilat as e penguan dhe as e dënuan dhunën dhe gjuhën e urrejtjes, treguan se LGBTI-bashkësia veç më është e dukshme dhe ka kapacitet që të luftojë në mënyrë të organizuar dhe aktive për të drejtat e veta.

⁶¹ Në reagimin publik “Ndërprejini fushatën homofobike që nxit urrejtje, diskriminim dhe dhunë!”, Koalicioni publikisht pyeti: “Si të kuptohet insistimi i vazhdueshëm i partisë qeverisëse që të mbahet debat publik me temë ‘martesa të një gjinie’, kur LGBTI-personat janë të ekspozuar në dhunë jo të dënuar dhe në kërcënime të vazhdueshme dhe diskriminim në të gjitha sferat e shoqërisë, kur policia ende nuk i ka gjetur dhunuesit që kryen sulm të egër ndaj aktivistëve dhe organizatave për të drejtat e njeriut të LGBTI dhe kur asnjë organizatë joqeveritare në Republikën e Maqedonisë nuk e hapi çështjen për ridefinimin e martesës?”

⁶² Shihni amendamentin XXXIII, <http://www.akademik.mk/wp-content/uploads/2014/08/natsrt.pdf>.

⁶³ Shihni „(Mos)respektimi i dallimeve seksuale“, <http://proverkanafakti.mk/nepochituvanje-na-seksualnite-razlichnosti/>.

⁶⁴ Krijimi i Rrjetit ishte aktivitet projektues i Shoqatës për qasje kritike ndaj gjinisë dhe seksualitetit – Fronti subverziv Shkup, ndërsa zbatohet në partneritet me Koalicionin „Të drejta seksuale dhe shëndetësore të grupeve të marginalizuara“.

⁶⁵ Jo shumë vonë para demolit të “Damar”, më 23.10.2014 është publikuar gjuha nxitëse e urrejtjes e dy portaleve në gjuhën shqipe. Pasi që ndodhi sulmi homofobik më 23.10.2014, të njëjtat media që nxisin paragjykimet dhe afshe etnike, fetare dhe homofobike, publikuan kontributin ku arsyetohej dhuna. Edhe në Fejsbuk-faqen e dy gazetarëve pro-qeveritarë u publikuan përmbajtje dhe komente ofenduese dhe nxitëse, të cilat nxisin dhunë mbi bazë të orientimit seksual. Për më shumë, shihni „Gjuha e urrejtjes shkakton dhunë“, <http://okno.mk/node/41926>.

Ata të cilët para dhjetë vitesh ishin të padukshëm dhe të pazëshëm, u bënë luftëtarë të dukshëm dhe të zëshëm kundër dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe formave të tjera të shtypjes heteropatriale. Me hapjen e debatit publik dhe parlamentar, me fillimin e iniciativave ligjdhënëse, me ndryshimin e vetëdijes nëpërmjet fushatave publike dhe iniciativave kulturore, me protestë dhe aksione publike, me solidaritet dhe përkrahje nga organizata ndërkombëtare, shoqëria qytetare hapi front kundër pabarazisë seksuale, kundër dhunës, paragjyqimeve, stereotipeve, diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes mbi bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Pabarazia gjinore vazhdon. Por, edhe lufta kundër saj vazhdon. Më e organizuar dhe më e vendosur.

së Maqedonisë publikisht do të kërkojë falje për ofendimin – homoseksualët vetë stigmatizohen – dhe se do të angazhohet për ndërtimin e sistemit efikas për mbrojtjen nga stigma dhe diskriminimi i pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara, me të cilën gjë në mënyrën më të mirë do të tregojë se është president *një për të gjithë*”, tha Zharko Trajanovski. (“Ivanovi t’u kërkojë falje homoseksualëve”, A1, 5.11.2009).

AKTIVIZMI NË GAZETARINË MAQEDONASE-DAVENIK¹ KUNDËR GOLIATIT



Në vitet pas pavarësisë së Maqedonisë, gazetaria kurrë s'ka mundur të lëvdohet se deri në fund është e pavarur nga ndikimet politike dhe të biznesit, as që zhurnalizmi maqedonas ka qenë i stolisur me standardet profesionale, të cilat parashikojnë që gazetarët të punojnë vetëm e vetëm në shërbim të interesit publik dhe t'i mbrojnë vlerat e shoqërisë civile, të tillë siç e kemi menduar me Kushtetutë.

Më shpesh, në vend të parë kanë qenë interesat partiake dhe të oligarkëve, ndërkohë që deri në fund të dekadës së kaluar kishte një minimum vetëdije se disa informacione patjetër të arrijnë te qytetarët, përkatësisht zgjedhësit. Nuk mund të merrej me mend të mos transmetohej lajmi nga konferenca për shtyp e partisë opozitare dhe nuk kishte spine të përditshme të cilat, nga njëra anë, janë në kufirin e mendjes së shëndoshë dhe të logjikës, ndërsa nga ana tjetër e kalojnë vijën e kuqe të mirësjelljes dhe shndërrohen në linç më të ulët mediatik ndaj jobashkëmendimtarëve.

Kjo nuk ekzistonte kur unë dhe gjenerata ime e gazetarëve, diku kah mesi i vitit 2000, me një dozë naiviteti dhe me shumë entuziazëm hymë në media. Ose, nëse kishte incidente të këtilla mediatike, ato ishin raste të izoluar dhe bashkësia e gazetarëve i dënonte rreptë.

Përpjekjet kryesore të pjesës së madhe të redaktorëve atëherë ishte që të bëhen lajme më të mira, më humane dhe më të pranueshme për publikun, të përkryhej stili i shkrimit dhe i shprehjes së fotografisë dhe përmes kamerës, të futen zhanre të reja në mediat maqedonase, ku pothuajse edhe nuk ka tjetër përveç kolumnave, komenteve dhe lajmeve. Liria elementare e shprehjes në asnjë rast nuk është vënë në pikëpyetje dhe, nëse një informacion për iks shkaqe nuk mund të paraqitej në një media, një tjetër redaksi pa problem e publikonte lajmin.

Gazetarët atëherë kryesisht mundoheshin për çështje sindikale të tipit të sigurimit shëndetësor dhe social të garantuar, për shkak se interesat jomediatike të padronëve të tyre definitivisht ishin problemi më i madh.

Megjithatë, për mungesë të vetëdijes së vërtetë demokratike, veprimi i më shumë qendrave të të fuqishmëve mundësonte që në ato vende ku këto ndikime kundërshtoheshin rreptë, pikërisht prej andej të dalin në publik informacione të rëndësishme për qytetarët.

U paraqit afera "Vatha", e cila në masë të madhe ndikoi që të zvetënohet autoriteti i kryeministrit të atëhershëm Vlado Buçkovski. Ajo që ky skandal në mënyrë konstante ishte në media, më tepër ishte rezultat i konfliktit që kryetari i atëhershëm Branko Cërvenkovski e kishte me Buçkovskin si kryeministër dhe i ndikimit të Cërvenkovskit në media, sesa i vetëdijes demokratike se informacioni i tillë me çdo çmim duhet të dalë në publik. Megjithatë, vendimi skandaloz i gjyqit për dëmshpërblim prej 700.000 eurosh për Isnifaris Xhemailin kështu apo ashtu arriti të veshët e zgjedhësve!

¹ mbyturi - nga: Davidi (shën.)

Sot këto qendra të të fuqishmëve ose nuk ekzistojnë, janë fshirë, ose i janë nënshtruar fuqisë së vetëm një njeriu, i cili përgjigjet në thirrjen e emrit Nikolla Gruevski. Në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe presidenciale, në pranverën e vitit 2014, të gjithë ishim dëshmitarë se 90 për qind e mejnstrim-mediave thjesht e censuruan temën për shitjen e “Makedonska Banka” dhe shkuan deri aty sa nuk publikuan as edhe një sekondë nga konferencat për shtyp të Zoran Zaevit, i cili i prezantonte audio-incizimet famoze. Të njëjtën situatë e kishim edhe gjatë kohës së të ashtuquajturës “E hëna e zezë”, kur servisi publik RTVM dhe agjencia shtetërore e lajmeve MIA nuk transmetuan se policia i nxori jashtë Kuvendit gazetarët dhe deputetët e opozitës. Edhe sot e kësaj dite në sajtin e MIA-s mund të gjendet raporti nga mbledhja e fundit kuvendore e vitit 2012, ku qëndron vetëm ajo se deputetët e kanë votuar buxhetin për vitin në vazhdim. Për MIA-n dhe për mediat proqeveritare 24 dhjetori nuk ka ndodhur asnjëherë!

Sa për krahasim, para një dhjetë viteve, Komisioni Antikorrupsion u inkurajua të kërkonte prishjen e privatizimit në “Fershped”, një lojtar i madh i biznesit i afërt me kreun e pushtetit të atëhershëm, diçka që nga aspekti i sotëm duket e pamundur dhe, para së gjithash, vetëvrasëse. Kjo është e njëjtë sikur antikorrupsionisti i parë Gjorgji Sllamkov t'i përvesh krahët dhe të bëjë kontrollimin e dyshimeve të LSDM-së për skemat zvicerane-panameze në kreun e families në pushtet.

Gazetari pa përmbajtje

Më shumë qytetarë dhe establishmenti e kuptuan se kanë punë me pushtet autoritar, madje, pasi u mbyll Televizioni A1, pas montimit të procesit kundër Lube Boshkoskit, përpjekjes për të mbuluar vrasjen e Martin Neshkoskit dhe rrënimit deri në themel të kompleksit banesor “Kosmos” të Fijat Canoskit – e gjithë kjo pas zgjedhjeve në qershor të vitit 2011. Megjithatë, gazetarët e dinin mirë se me cilin kanë punë shumë kohë para se të ndodhnin këto ngjarje, para 5 qershorit 2011, kur në vepër e pamë Verën maqedonase të thikave të gjata.

VMRO-DPMNE nga viti 2006, e më fort nga zgjedhjet presidenciale dhe lokale të vitit 2009, pasi e grabiti tërë pushtetin në vend, duke marrë mediat dhe duke ngushtuar hapësirën publike, vazhdimisht ia heq gazetarisë përmbajtjen e saj. Mejnstrim-mediat kryesore janë në duart e partnerëve të koalicionit të Gruevskit, të cilat janë shfrytëzuesit kryesorë të reklamave të shtrenjta dhe kryesisht të pakuptimta qeveritare, ndërsa të njëjtat televizione dhe gazeta gjatë kohës së zgjedhjeve janë shumë dorëllira ndaj partisë në pushtet dhe e qerasin me hapësirë reklamuese skajshmërisht të lirë ose, thjesht, paraqiten si donatorë. Është ky një rreth magjik korrupsioni, që është njëri prej gulfeve kryesore të fuqisë së Gruevskit dhe të ministrave të tij. Prandaj, sot në media gjithnjë e më pak ka gazetarë e më shumë mbajtës të mikrofonave dhe propagandistë, dhe ne sot jemi më pak gazetarë se sa ç’kemi qenë para nja dhjetë viteve.

Nesër edhe po të vijë ndokush në pushtet që dëshiron ta rregullojë sferën mediatike sipas një rendi demokratik, për të cilën gjë dyshoj, do t’i duhen vite e vite që të krijojë atmosferë në të cilën do të lindnin kadro profesionale dhe media të vërteta. Gjeneratat e reja të gazetarëve nuk kanë prej kujt të mësojnë, sidomos nëse përfundojnë në mejnstrim-mediat e kontrolluara nga pushteti, gjë që është shumë e besueshme se mund të ndodhë.

Zhurnalizmi te ne është deprofesionalizuar deri në atë shkallë saqë, po të ishin mediat spitale, e gazetarët mjekë, për çdo ditë pacientët do të vdisnin nga flama. Nëse ky “profesionalizëm” në gazetari shpërfaqet tek ELEM, për shembull, neve nga një herë në muaj do të na rënohej nga një pendë hidrocentrali dhe do të mbyteshim si minj.

Katastrofat e masave të këtilla me të vërtetë edhe do të fillojnë të ndodhin. Kështu që, këto nuk janë falle të zeza në pëllëmbë, por e ardhmja të cilën e sjell një shoqëri e partizuar thellë, ku kriter kryesor për punësim është librezja partiake dhe aftësia për të punuar në agjendën politike. Janë apokaliptike fatet e këtyre shoqërive autoritare, ku dëgjoher zëri vetëm i një njeriu, i cili kushedi sa i mençur dhe i aftë të jetë, nuk mund t'i dijë të gjitha. Mediat ishin vetëm pengesa e parë të cilën pushteti i Grueskut që në fund të dekadës së kaluar e fshiu para vetes ose, siç e kam "merak" unë të them, totalisht e zbrazi nga përmbajtja e vet.

Pas këtij apokalipsi mediatik në disa akte, mbeten tri-katër ujëdhesa ku lirisht mund të krijohet, megjithatë edhe puna e tyre u bë pothuajse e pamundur pas fatkeqësisë së komunikacionit ende të pazbuluar deri në fund në të cilën e humbi jetën pronari i gazetës "Fokus", Nikolla Mlladenov, pas aferës "Spiun", në të cilën u arrestua gazetari Zoran Bozhinovski dhe pas burgosjes së kolegut Tomislav Kezharovski. Këto ngjarje unë i quaj Pranverë e thikave të gjata 2013.

Dhe, siç ndodh zakonisht, gjatë përpjekjes së fundit të pushtetit që ta shtyp deri në fund atë çka ka mbetur nga gazetaria, dëshmipërblimi i lartë që mori drejtori i DSK, Sasho Mijalkov, në procesin gjyqësor kundër meje dhe kundër redaktorese së "Fokusit", Jadranka Kostova, pikërisht atëherë u paraqitën gacat e para të shpresës për profesionin. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe kryetari i saj, Naser Selmani, e njohën seriozitetin e këtij precedenti, e kjo ishte-të dënohet gazetari për deklaratën e transmetuar vetëm pse ajo nuk i pëlqen shefit të policisë sekrete.

Ky asociacion gazetarësh në kohë e pa se vendimi i gjykatëses Jovanka Spirovska-Paneva kundër "Fokusit" do të instalojë një praktikë të tmerrshme në media, e ajo është se gazetarët do të detyrohen të kontrollojnë thjesht çdo deklaratë që e transmetojnë e që lidhet me kreun që është në pushtet. Kjo me siguri do ta sjellë tabuizimin e temave dhe të personaliteteve të caktuara në Maqedoni dhe do të kontribuojë në idolizimin e tyre deri në shkallën e perëndisë, gjë që praktikisht edhe po na ndodh. Në rrjetet sociale mund të gjeni shakara të tipit "mos e përmend emrin Mijalkovo për kot", satirë kjo e cila shumë figurativisht e kap gjendjen reale të shpirtit të qytetarit maqedonas.

Pikërisht për këtë SHGM organizoi një aksion disajavor për solidaritet dhe i ndihmoi "Fokusit" që t'i tubojë ato 9.300 euro që dolën nga padia e Mijalkovit. Veprimi i Shoqatës ka rëndësi të veçantë, për shkak se nën udhëheqjen e SHGM-së një pjesë dërmuese e kolegëve punojnë nën kontrollin e pushtetit dhe ata me aksionin i kanë rrezikuar vendet e punës dhe ekzistencën. Pikë tjetër e rezistencës në këtë kohë të zezë është gjithsesi Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe e Punonjësve të Mediave (SPGPM), e udhëhequr nga Tamara Çausidis. Edhe Sindikata përmes koncertit të bendit "Riporters", rok-grup i përbërë nga gazetarët, ndihmoi, edhe atë mjaft, në tubimin e të hollave për dënimin e "Fokusit". Besoj se tregohet që kjo "JO" e gazetarëve do të jetë po aq e rëndësishme për gazetarinë në Maqedoni, sa ishte e rëndësishme për ekzistencën e javores FOKUS dhe për mbijetesën time personale si gazetar, e cila ishte prekur nga dënimi enorm i lartë me të holla.

Përmes solidaritetit që u tregua në rastin me FOKUS. një pjesë e madhe e qytetarëve, një pjesë e biznesmenëve dhe e sektorit OJQ treguan se e kanë të rëndësishme qëndresën e një media të pavarur dhe e njohën rolin e saj. Diçka që nuk ndodhi kur në pyetje ishte Televizioni A1 shumë më i fortë. Ndonjë analizë më serioze ndoshta do të tregojë se përse opinioni publik nuk u vu në anën e televizionit më të shikuar. Ndoshta kjo është për shkak të faktit se pushteti kundër A1-shit i vuri në zgjedhje edhe mediat edhe tërë aparatit shtetëror, bile zëdhënësi i policisë Ivo Kotevski dhe drejtori i DAP, Goran Trajkovski, ende i shërojnë vijat e zeza ndër sy nga mbrëmja kur MPB e mori padronin e A1-shit, Velia Ramkovskin dhe kur ata e kishin patjetër që të jenë mysafir,

thjesht, në të gjitha televizionet, për të shpjeguar se Televizioni nuk është target i aksionit brutal të policisë. Diçka që menjëherë u tregua si e pavërtetë.

Ndoshta, them, A1-shi nuk ia doli nga sulmet e pushtetit dhe nuk mori mbështetje për shkak të imazhit të padronit, Ramkovski dhe për shkak të, në momente, koketimit të tij cirkusant me të gjitha pushtetet. Mbase e vërteta është kombinim i të dy shkaqeve, megjithatë fakt është se as opinioni publik, e më së paku gazetarët dhe shoqatat e gazetarëve, as SHGM, as Sindikata në krijim e sipër nuk e njohën rrezikun e madh të përmbytjes së një media të tillë.

Për sindikatë të fortë duhet punuar, ajo nuk vjen prej Zotit

Me mbylljen e A1-shit, përveç se u shkatërrua një kanal serioz i komunikimit me qytetarët, në rrugë mbetën disa qindra gazetarë dhe për këtë shkak ra çmimi i punës së gazetarëve në treg në nivelin nënçmues. Siç thonë disa prej padronëve sot, për një rrogë seriozisht të ulët, mund të angazhoni një gazetar seriozisht të mirë. Në situatën kur është rrezikuar ekzistenca e gazetarëve, askush prej tyre nuk mund të presë që ata më seriozisht të angazhohen në temën e lirisë së mediave. Varfëria në zhurnalizmin maqedonas është ndoshta edhe më e tmerrshme se presionet, shantazhet dhe censurat, përkatësisht ajo është njëra prej parakushteve që të vihet deri te ky term i plotë mediatik. Prandaj, habit shkurtpamësia e numrit më të madh të gazetarëve në Maqedoni, të cilët refuzojnë të bëhen anëtarë të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe të Punonjësve të Medias (SPGPM).

Plotësisht i kuptoj ata që nuk guxojnë të lidhen me SPGPM për shkak se padronët dhe redaktorët në mënyrë eksplicite ua ndalojnë që të bëhen anëtarë në organizatat “sorosoide”, kështu që kishte raste kur gazetarë të një media njëherësh të heqin dorë “vullnetarisht” nga anëtarësia në SPGPM, e në të vërtetë ekzistojnë redaksi të tëra që vlejnë si media të pavarura nga pushteti, të cilat me ngulm ua ndalojnë gazetarëve që të anëtarësohen në Sindikatë.

Gazetarët e këtyre redaksive disi i kuptoj për shkakun se ende nuk janë pjesë e Sindikatës, megjithatë kurrsesi nuk mund t’i “skontoj” kolegët që nuk kanë pengesa të tilla, e nuk përfshihen, me arsyetimin se “Sindikata kurrjë nuk u ka ofruar”.

Njeriu thjesht nuk mund të mos çuditet kur persona të arsimuar, gazetarë të diplomuar konsiderojnë se organizimi sindikal është dhënë prej Zotit dhe nuk i kuptojnë konceptet e solidaritetit dhe të sindikatave. Sillen sikur udhëheqjen sindikaliste ta kenë zgjedhur në tender, sikur për të të kenë paguar disa miliona euro dhe ajo tani duhet t’ua kryejë shërbimet kur kanë problem me pronarët e mediave, ndërkohë konsiderojnë se nuk ka nevojë që të ndihmojnë në ngritjen e sindikatës së vërtetë e të fortë. Siç thashë, mendojnë me naivitete se Sindikata është dhënë prej Zotit.

Është realitet se nëse nesër, për çfarëdo shkak kryetarja e SPGPM, Tamara Çausidis, vendos që të heqë dorë, ekzistenca e Sindikatës së Gazetarëve do të vihet në pyetje për shkak se, edhe krahas punës së madhe që ishte investuar në sindikatë, ajo ende nuk e ka kapacitetin e nevojshëm për të punuar po s’e pati viktimizimin e njerëzve që e formuan.

E, njëra prej betejave tona gjithsesi se është sigurimi i solidaritetit, për shkak se pa gazetarë me gjendje të fortë ekonomike, nuk mund të prisni liri të mediave; thjesht, kjo është aksiomë.

Kjo rrugë patjetër të ecet dhe askush, as LSDM, e më së paku udhëheqja e VMRO-DPMNE-së nuk do të na ndihmojë në këtë. Ka ardhur koha që nga gazetaria në Maqedoni të krijohet esnaf i fortë, të shpërthejë si feniks nga hiri i mediave të robëruara dhe, nëse nuk më mashtrojnë përshtypjet e mia, mendoj se kjo ngadalë, por sigurt, po ndodh!

Siç thotë filozofia kineze, se në çdo gjë të keqe ka të mira, pas atij parimi jing-jang në këtë vilajet të errët mediatik dua të besoj se lindin shenjat e para të esnafit të vërtetë gazetaresk. Në të vërtetë, një numër i madh i kolegëve që mbetën pa punë dhe ishin margjinalizuar nën urdhrin direkt të pushtetit, u kthyen kah interneti.

Kështu, në këtë moment ka portale pronarë të cilave janë gazetarët. Edhe pse përshtypja e parë është se bëhet fjalë për media me profesionalizëm të ulët, që nuk mund të dërgojnë lajme të vërteta, megjithatë një pjesë e mediave on-lajn seriozisht po profilizohen dhe po bëhen faktorë në opinion. Është me interes të thuhet se shumë prej këtyre kolegëve nuk do të guxonin ta bënin një hap të këtillë, vetë të formojnë media, po të mos kishin shkuar deri te skaji i humnerës dhe prandaj këto redaksi, të drejtuara ekskluzivisht nga gazetarët, janë gjëja më e bukur, si një velore, e vendit në fshirjen e fundit të listës së “Reporterëve pa kufij” dhe të “Freedom Haus”.

“Beteja” është fituar, “lufta” veç sa ka filluar

Nëse okupimi ndaj mediave do të krahasohej me okupimin fashist të Maqedonisë gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, metaforikisht mund të thuhet se lufta aktivistike për gazetarinë është në nivelin e rezistencës partizane të vitit 1941.

Kanë krisur pushkët e para, radhët po ngjishen, gazetarët rinumërohen, organizohen dhe qartë e dinë se cilat i kanë vijat e kuqe, megjithatë ka edhe disa beteja në nivelin e një “Neretve” gazetareske që duhet fituar, që mediat në Maqedoni së paku me dinjitet ta vazhdojnë punën.

Beteja e cila kursesi nuk guxon të humbet është lufta që kolegu Tomislav Kezharovski të lirohet nga të gjitha akuzat në rastin “Likudimi”. Çdo shturje tjetër e rastit do të jetë humbje për punëtorët e medias në Maqedoni. Kezharovski është akuzuar dhe është dënuar në shkallën e parë për gjoja zbulimin e dëshmitarit të mbrojtur, edhe pse nuk e ka zbuluar identitetin e vërtetë të “dëshmitarit”. Nga ana tjetër, tema të cilën e hap me tekstet e veta është me interes publik mundshëm më të lartë, për shkak se ka dëshmi të mjaftueshme që të besojë se policia përgatit dëshmitarë të rrejshëm për të mbështetur akuzën për vrasje.

Rasti “Kezharovski” është bedeni të cilin pushteti nuk guxon ta pushtojë, sidomos nëse dihet se arrestimi i tij erdhi pas serisë së teksteve që ai kishte për fatkeqësinë në komunikacion, ku jetën e humbi pronari i javores “Fokus”, Nikolla Mlladenov.

Në këtë moment Kezharovski është në paraburgim shtëpiak dhe e pret vendimin e shkallës së dytë, megjithatë për rastin e tij reagan edhe OSBE edhe organizata dhe politikanë serioz evropianë.

Edhe pse ndoshta duket që ky presion i fortë i publikut, i bashkësisë ndërkombëtare ndaj pushteteve për Kezharovskin ka ardhur vetvetiu, kjo gjithsesi as nga afër nuk është e vërtetë. Bëhet fjalë për punën e një grupi prej 10 gazetarësh, Këshilli iniciativ për shpëtimin e Kezharovskit, i cili pas burgosjes së kolegut për çdo ditë i informonte të gjitha adresat relevante edhe në Maqedoni edhe në botë për atë se çka i ndodh kolegut. Organizuan dy protesta para Gjykatës Themelore në Shkup, ndërsa ata e iniciuan edhe protestën e madhe të gazetarëve para Muzeut të luftës maqedonase (Muzeut të Dyllit), pikërisht në ditën e festës, Ditën e luftës nacionale maqedonase, 23 tetor të vitit 2013.

Asokohe gazetarët u përballën me forca speciale të policisë në afërsi të Urës së Gurit, për shkak se ata nuk u lejuan që të shkonin te Muzeu i Dyllit. Kjo ngjarje qarkulloi nëpër tërë botën dhe disa ditë më vonë Kezharovski ishte lëshuar në paraburgim shtëpiak.

Të gjitha këto raste tregojnë se aktivizmi në gazetari është më se i nevojshëm, sidomos në shoqëritë ku pushtetmbajtësit me të gjitha forcat i mbajnë mediat për freni. Qëllimi i këtyre krerëve politik autoritar është që nga mediat të bëjnë tabela për shpallje për komunikim të njëanshëm me qytetarët, ndërsa prej gazetarëve njerëz që veç mikrofonat i mbajnë dhe asgjë nuk pyesin, nuk mendojnë dhe nuk i vënë ngjarjet dhe informacionet në kontekst.

Tashmë me vite dhe ndoshta vetëm në Maqedoni ekziston fenomeni i të ashtuquajturave konferenca tematike për shtyp në të cilat kryeministri dhe ministrat nuk përgjigjen në pyetjet jashtë temës për të cilën është thirrur paraqitja.

Gazetaria e vërtetë ka qenë dhe gjithnjë do të jetë e bazuar në dyshim, në rishikim, në pyetje, analizim dhe kontekstualizim të ngjarjeve, me ç'rast gazetarët, megjithatë, patjetër dhe në mënyrë strikte ta respektojnë kodin themelor të profesionit.

Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se nuk ekzistojnë çështje që janë me rëndësi vitale për publikun të cilat gazetarët nuk guxojnë që t'i shtrojnë dhe me këtë rast t'i kërkojnë përgjigjet prej të gjitha palëve të prekura. Kjo do të thotë se shpesh do të duhet të shtrohen pyetje të papërshtatshme, megjithëse shumë moti shkrimtari i njohur anglez dhe, para së gjithash, mendimtari Xhorxh Oruell ka thënë se gazetaria është ajo që dikush nuk do që të publikohet, ndërsa gjithçka tjetër është promocion, pi-ar (PR)!



Nuk do të ndryshojë gjendja e një populli përderisa ai popull nuk e ndryshon vetveten.

A thua popull aq "i mirë" jemi ne, sa pushteti mund të na vjedhë aq sa ne mund të falim? E keqja nuk do të kalojë nëse vazhdojmë vetëm me kthimin e kokës. Patjetër ne, qytetarët, këtë shtet duhet ta bëjmë vend më të mirë për të jetuar dhe duhet t'ia kthejmë perspektivën. A mos mendoni se nuk ishte më lehtë që edhe ne (që gjithnjë ngremë krye për diçka) të heshtim? Por, nëse ne të gjithë heshtim, zhvendoset kufiri, edhe atë gjithnjë në llogarinë tonë! Në llogari të qytetarëve, me leverdi për partitë në pushtet. Pushteti e kupton heshtjen e qytetarëve si shenjë miratimi, kështu që na i mori liritë, na i robëroi mediat, na i harxhoi të hollat për përmendore, me ç'rast na la dhe pa ajër të pastër, pa kanalizim, pa spitale dhe pa shkolla të rregulluara. Kush dëshiron të heshtë edhe më? Gjithnjë kur ne nuk do të merremi me politikë, lëmë një hapësirë të zbrazët në skenën politike, të cilën pushteti e keqpërdor. Prandaj, asnjëherë më tepër mos t'ua lëmë politikën vetëm partive, për shkak se kjo është e drejta jonë, por edhe obligimi ynë moral.

Si pjesëmarrës në organizimin e iniciativës "AMAN", por edhe si iniciatorë për nisjen e iniciativës së "8 Shtatorit" do të përpiqem t'i përndaj përvojat.

AMAN nga shtrenjtimet

Iniciativa civile AMAN u paraqit si rezultat i shtrenjtimit të vazhdueshme të rrymës, të ngrohjes qendrore dhe të benzinave në vitin 2011 dhe 2012. Shtrenjtimet e "goditën" thellë xhepin e qytetarëve që kanë të ardhura mesatare, por edhe të atyre me asistencë sociale dhe të varfrit, kështu që pagesa e faturave u bë mision i pamundshëm. I tërë tregimi i AMAN-it filloi me kreacionin që iu bë ngjarjes në Facebook, përmes së cilës u paralajmërua protesta para Komisionit Rregullator për Energjetikë (KRE), që i lejonte shtrenjtimet, edhe pse gjatë formimit të çmimit të energjenseve është paraparë se duhet pasur kujdes edhe standardin e qytetarëve. Facebook-Inventin e kishte krijuar aktivisti Ilija Najdov dhe për vetëm disa orë disa mijëra njerëz e paralajmëruan praninë e tyre në protestë. Protesta e parë u bë para KRE-së më 16.8.2012, të martën, në orën 18. Në protestë, para rreth 300 qytetarëve, u paralajmërua se do të protestohet çdo të martë, deri sa nuk pranohen kërkesat. Menjëherë të martën në vazhdim, përveç se në Shkup, u organizuan protesta edhe në Manastir dhe në Prilep, ndërsa të martave vijuese filluan protesta në Kumanovë dhe në Tetovë. Protestat e para ishin relativisht masive, në Shkup, Manastir dhe në Prilep kishte më shumë se nga 2.500 njerëz, ndërsa në Kumanovë dhe në Tetovë kishte nga 500 qytetarë. Nëse i mbledh të gjitha, kjo tregon se në një iniciativë civile, pa kurrfarë resursesh financiare dhe pa mbështetjen e askujt, u arrit të nxirreshin mbi 8.000 qytetarë në protestë. Për shkak të këtij fakti, aktivistët u inkurajuan, filluan të organizoheshin rregullisht, të mbahen plenumet më shumë herë gjatë javës. Organizimi ishte mbi bazë "horizontale", që do të thotë se nuk kishim lider, por të gjitha vendimet i miratonte shumica e aktivistëve të pranishëm. Në plenumet e para ishin miratuar këto kërkesa të iniciativës dhe ishin përsëritur në protestat e rregullta të të martave:

- të kthehet tarifa e lirë ditore;
- të kthehet çmimi i rrymës në nivelin e vitit 2008;

- të kthehet çmimi i ngrohjes qendrore në nivelin e vitit 2008;
- çmimi i benzinave të përshtatet me nivelin e standardit të qytetarëve;
- qytetarët që nuk shfrytëzojnë ngrohje qendrore të mos i paguajnë kurrfarë kompensimi ndërmarrjes “Toplifikacija”;
- të ndërpritet kategoria *fuqi e angazhuar* prej 33% në faturat e rrymës;
- të investohet në burime alternative të energjisë;
- të mos shiten „ELEM“ dhe „MEPSO“.

Si funksiononte „AMAN“?

Në çdo qytet (Shkup, Manastir, Prilep, Kumanovë dhe Tetovë) ku u organizuan protestat, aktivistët organizonin plenumet, ku bisedohej për atë se si do të duken protestat, cilat do të jenë marshrutat, cilat do të jenë parullat dhe të gjitha çështjet tjera organizuese. Në vetë fillimin e iniciativës AMAN, në nivelin e të gjitha qyteteve, ishin pranuar kërkesat e iniciativës dhe dita e martë në orën 18 si ditë e protestës, ndërsa të gjitha të tjerat çdo qytet i organizonte veçmas. Në çdo protestë vinin media dhe merrnin deklaratat nga aktivistët, ndërkaq edhe për çdo hap tjetër të iniciativës organizoheshin konferenca për shtyp. Çdo ditë mes të martave ndaheshin trakte dhe ngjiteshin pllakate me përmbajtje informative për kohën dhe vendin e mbajtjes së protestës. Janë organizuar edhe tribuna, në të cilat aktivistët i kanë argumentuar kërkesat e iniciativës.

Bashkëpunimi me Komitetin e Helsinkit

Komiteti i Helsinkit filloi të na ofrojë ndihmë juridike falas, e cila ishte me shumë rëndësi për ne. Pastaj filluan t'i "krehnin" shtrenjtimitet e lejuara të energjenseve nga ana e KRE dhe zbuluan se një pjesë e mirë e shtrenjtimeve të lejuara janë miratuar padrejtësisht. Ky argument, që ishte nxjerrë në një konferencë për shtyp, ndihmoi që të rritet revolta e qytetarëve, si dhe presioni ndaj KRE-së. Komiteti i Helsinkit përgatiti edhe propozim-ndryshimin e Ligjit për energjetikë, me të cilin ishin pranuar dy nga shtatë kërkesat e iniciativës, për të cilën pastaj filluam të mbledhim 10 mijë nënshkrime, që të mund të hynte në procedurë kuvendore.

Kërcënime, shantazhe, etiketime dhe kundërprotesta

Pas protestave fillestare, ndodhën edhe etiketimet e para nga ana e mediave proqeveritare se pas AMAN-it qëndron LSDM dhe se opozita e kontrollon iniciativën, gjë që nuk ishte e saktë. Një mëngjes, kur filloi tubimi i 10 mijë nënshkrimeve, nëpër shtyllat në Shkup ishin ngjitur postera të shtrenjtë, ku aktivistët të AMAN-it, por edhe njerëz që veçmas vinin në protesta, në fotografi ishin paraqitur si kukulla nën kontrollin e kryeministrit dhe kryetarit të mëparshëm të R. së Maqedonisë, si dhe kryetarit të atëhershëm të LSDM-së, Branko Cërvenkovski. Kishte edhe raste kur aktivistëve tanë u dilnin përpara “frajerë” të dyshimtë, të cilët tregonin fotografi të neve aktivistëve dhe thoshin se do të ishte më mirë të mos fillojmë me tubimin e 10 mijë nënshkrimeve. Në majën e fushatës kundër AMAN-it u paraqit edhe “Privatizimi përvëlues” proqeveritar, që përveç se pohonte se opozita është fajtorë për shkak të shtrenjtimit të rrymës, për shkak të shitjes së “EEM” (ESM) së atëhershme (sot EVN private), nuk kishte kurrfarë kërkesë drejtuar institucioneve. Normalisht, të

gjitha ftesat nga mediat e pavarura për debat rreth kërkesës së iniciativës së AMAN-it dhe punës së KRE-së, ELEM dhe MEPSO-s shtetërore, dhe EVN-së së privatizuar, i refuzuan. Kur u ftova si mysafir në emisionin “Analiza”, në Televizionin 24 Vesti te gazetarja Bogdanka Kuzeska, bashkë me Voislav Stojanovskin nga Komiteti i Helsinkit, atëherë përfaqësuesja e “Privatizimit përvëlues” e anuloi pjesëmarrjen e saj në emision.

Institucionet e shurdhëta dhe media joprofesionale

Derisa zgjasnin protestat para KRE-së, asnjëherë askush nuk doli të fliste me qytetarët, thjesht injoronin, sikur gjithçka është normale. Vetëm pranuan një pjesë nga shtrenjtimitet e parregullta, të cilat i zbuloi Komiteti i Helsinkit. Policia asnjëherë nuk i zbuloi ata që i kishin vënë posterat e shtrenjtë, edhe pse ishin ngjitur në vende ku MPB ka kamera. Pas disa javëve të para, pasi filluan etiketimet ndaj AMAN-it, më nuk mund të llogarisnim te RTVM, TV Sitel, TV Kanal 5 dhe mediat tjera proqeveritare. Duhet të theksohet se raportime korrekte për iniciativën kishte gjatë tërë periudhës nga TV Telma, TV Alfa, TV 24 Vesti dhe një pjesë e internet-portaleve të pavarura. Të revoltuar për shkak të raportit të servisit radiodifuziv publik, për të cilin paguajnë të gjithë qytetarët, vendosëm që të organizojmë edhe një protestë para RTVM-së.

Tubimi i 10.000 nënshkrimeve për ndryshimin e Ligjit për energjetikë

Komiteti i Helsinkit përgatiti edhe propozim-ndryshimet në Ligjin për energjetikë, me të cilat kërkohet:

- të kthehet tarifa e lirë ditore;
- qytetarët që nuk shfrytëzojnë ngrohjen qendrore të mos paguajnë kurrfarë kompensimi për ndërmarrjen “Toplifikacija”.

Për shkak se institucionet dolën të shurdhëta, por edhe për shkak të nevojës që të tregojmë se një numër i madh qytetarësh qëndrojnë pas iniciativës sonë, vendosëm që propozimin për ndryshimin e Ligjit ta fusim në debatin e obligueshëm kuvendor përmes Ligjit për referendum, me tubimin e 10 mijë nënshkrimeve në njësitë rajonale të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). Pas tubimit të 100 nënshkrimeve të para dhe lejes nga Kuvendi, pritëm pothuajse një muaj që Qeveria ta njoftojë KSHZ-në që të na i hapë njësitë rajonale dhe të fillojmë t'i mbledhim nënshkrimet. Ne u detyruam të shtypnim formularë në të cilët qytetarët do të nënshkruhen dhe t'i dërgojmë në të gjitha njësitë rajonale të KSHZ-së. Në disa vende dërguam formularë në dy gjuhë, e në disa dhe në tri, varësisht nga struktura etnike e rajonit që është përfshirë në njësinë rajonale. U detyruam të shtypnim formularë në të cilët do të mund të nënshkruhej numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Listën zgjedhore, të gjitha t'i dërgojmë para fillimit dhe t'i mbledhim pas mbarimit të nënshkrimit, të gjitha këto me shpenzimet tona. Propozues të autorizuar të Ligjit e zgjedhëm Zorica Dimovskën. Zorica duhej që në Kuvend ta arsyetonte nevojën për ligjin e propozuar dhe kur do të vinte në radhë, deputetët ta pranonin ose jo. Kur filloi tubimi i nënshkrimeve, mbajtëm disa takime nëpër disa qytete nëpër Maqedoni, për t'i informuar qytetarët përse të nënshkrueshin dhe ku të nënshkrueshin. I mbledhëm nënshkrimet, e shpeshherë qytetarët kur vinin në njësitë rajonale, ato ishin të mbyllura në kohën kur duhej të ishin të hapura. Me të gjitha këto ndër këmbëza arritëm që të tubojmë më shumë se 13 mijë nënshkrime, gjë që për ne paraqiste një fitore të madhe morale. Fitore në të cilën e dëshmuam legjitimitetin tonë, i cili ishte kontestuar nga mediat proqeveritare, fitore në të cilën dëshmuam se dy kërkesat tona kanë mbështetje të madhe nga qytetarët, përkundër gjithë arrogancës së institucioneve. Kur i dorëzuam

nënshkrimet në Kuvend, tashmë kishte ndodhur 24 dhjetori, datë kjo në të cilën sigurimi dhe pjesëtarët e MPB-së i hodhën jashtë Kuvendit pjesën më të madhe të deputetëve të opozitës, të cilët për këtë shkak e bojkotuan atë. Kur propozuesi i autorizuar, Zorica, në Kuvend e ka arsyetuar nevojën për të bërë ndryshimet në Ligjin për energjetikë, është provokuar dhe ofenduar nga një pjesë e deputetëve të DPMNE-së. Deputetët e PDSH-së dhe të RDK-së i mbështetën propozim-ndryshimet e Ligjit, deputetët e BDI-së votuan të përmbajtur, ndërsa shumica e deputetëve rreth koalicionit të DPMNE-së votuan kundër propozim-ndryshimit të Ligjit, përkatësisht “për” refuzimin e tyre.

Gabimet tona

Krahas asaj që patëm sukses të mblidhnim më shumë se 13.000 nënshkrime, krahas asaj që zbuluam parregullsi në punën e KRE-së, krahas asaj se nga kjo betejë e jonë dolëm si fitues moral, duhet të pranohet se bënim gabime në rrugën e iniciativës. Një energji të madhe harxhuam në debate të brendshme, se ç’qëndrim të mbanim ndaj partive politike që na etiketonin dhe partive me të cilat kishim potencial të ndërtonim partneritete. Prandaj, më lejoni që t’ju tregoj se është plotësisht legjitim bashkëpunimi me partitë politike që janë të gatshme ta mbështesin iniciativën tuaj. Madje, jo vetëm që është legjitime, por është e dëshirueshme dhe më e mençur që të bashkëpunoni, por, gjithsesi, me **raporte partneriteti qartë të definuara** më parë. Kërkoni partner për iniciativat tuaja edhe te partitë politike, edhe tek organizatat joqeveritare, edhe te grupet joformale, edhe tek intelektualët dhe artistët e njohur. Krijoni partneritete mbi bazë barabarësie dhe qëndrimi fer. “Horizontalja” është e nevojshme në ngritjen e iniciativës, por gjithnjë duhet të krijoni trupa (trup juridik, marrëdhënie me publikun, trup për mobilizim, trup për koordinim ...) që do të funksionojnë. Po që se trupat e tillë nuk funksionojnë, atëherë “horizontalja” bëhet fren për realizimin efikas të aksioneve. Në AMAN, për fat të keq, nuk funksionuan trupa të tillë, kështu që pamë shumë mund derisa e shtymë iniciativën deri në Kuvend. Të gjitha vendimet për hapat në vazhdim të iniciativës është me rëndësi që me kujdes t’i komentoni me opinionin publik. Ne në AMAN, sa për bllokadat mediatike, sa për joshkathtësinë tonë, nuk arritëm që me sukses ta ndryshojmë terminin për protesta nga e marta në orën 18, në të shtunën në orën 13, gjë që dukshëm e dobësoi shkallën e vizitës së protestës.

Suksesi i “AMAN-it”

Edhe krahas asaj që iniciativa nuk kaloi në Kuvend, “AMAN” është shembull i iniciativës së suksesshme që e theu akullin dhe e tregoi rrugën se si të mblidhen 10 mijë nënshkrime dhe si një temë të zë vendin më të lartë të vëmendjes së publikut, krahas të gjitha bllokadave dhe etiketave mediatike. “AMAN” bëri gjithçka që është në mundësitë e një iniciative që të jetë e pranueshme nga institucionet, por për shkak se ato u paraqitën të shurdhëta, ajo ishte refuzuar. Po të mos ishte “AMAN” dhe Komiteti i Helsinkit, kurrë nuk do të zbuloheshin shtrenjtimet e parregullta të lejuara nga ana e KRE-së. Duhet të përmendet se pasi u paraqit “AMAN”, një periudhë të gjatë nuk kishte shtrenjtime të mëdha të rrymës, të ngrohjes qendrore dhe të benzinave, siç ishin ato në vitin 2011 dhe 2012.

„Ushqim, ujë, tesa dhe rrymë për çdo familje“ që Maqedonia të jetë shtet social

Grupi jo formal “8 Shtatori” është formuar me iniciativën time, ku anëtarë ishin edhe Vlladimir Vangellov, Aleksandar Goçev, Ollgica Stankovska, Ana Malqevska dhe bashkë me dhjetëra

aktivistë, intelektualë dhe artistë të tjerë e realizuam projektin “Ushqim, ujë, tesha dhe rrymë për çdo familje”.

Nevoja për një iniciativë të këtillë

Republika e Maqedonisë sipas Kushtetutës është edhe shtet social, por për fat të keq në praktikë është vend i padrejtësisë sociale. Grupi joformal “8 Shtatori” erdhi në idenë se duhet të propozojë ndryshime në Ligjin për mbrojtje sociale dhe propozim-masa të cilat do t’ia dërgojë Kuvendit, Qeverisë dhe BNJVL (Bashkësisë së Komunave-shën.), e me të cilat do të sigurohej një jetë me dinjitet minimal për çdo familje dhe për çdo qytetar. Një familje katëranëtarëshe e rrezikuar nga aspekti social pranon 5.173 denarë ndihmë për një muaj dhe me këto të holla duhet t’i mbulojë të gjitha nevojat. Subvencionet për rrymë vonojnë edhe nga 7-8 muaj dhe shuma e tyre shkon deri në 700 denarë. Ndërkohë, vetëm faturat për rrymë në muajt e dimrit janë më të larta nga tërë ndihma sociale. Nëse familjet e rrezikuara nga aspekti social nuk i paguajnë faturat, atëherë u dërgohen përmbarues. Paradoks është se të gjitha familjeve që janë pranues të ndihmës sociale më shumë vite, pas vitit të tretë ndihma sociale u zvogëlohet për 50%! Kjo do të thotë se një familje katëranëtarëshe duhet të mbijetojë me 2.586 denarë. Nëse këtë e ndani në katër anëtarë dhe në tridhjetë ditë për çdo ditë, atëherë matematika tregon se ky shtet “social” kujdeset për ata që janë me gjendje të rrezikuar sociale me 21,55 denarë në ditë! Kush mund të mbijetojë me 21,55 denarë në ditë, e me këtë rast të vishet, të paguajë komunaliet dhe faturat, t’i paguajë barnat, të paguajë transportin?! Dhe, derisa shpenzimet reale të jetesës rriten me marramendje, Qeveria nga njëra anë minimalisht e rrit ndihmën sociale, ndërsa nga ana tjetër pothuajse për gjysmë e shkurton numrin e familjeve të rrezikuara nga aspekti social.

Në vitin 2006 - 64.517 amvisëri kanë pranuar ndihmë sociale

Në vitin 2009 - 49.515 amvisëri kanë pranuar ndihmë sociale

Në vitin 2011 - 36.991 amvisëri kanë pranuar ndihmë sociale

